



UNIVERSITETI I EVROPES JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE
ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES

PROGRAMI I DOKTORATËS - CIKLI I TRETË

TEMA

**PJESËMARRJA E STRUKTURUAR NË POLITIKËBËRJE SI
MJET I RËNDËSISHËM PËR ZHVILLIMIN E DEMOKRACISË
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

KANDIDATE:

Florentina Hajdari Hajra

MENTOR:

Prof. Dr. Agron Rustemi

Tetovë, Mars 2024

© COPYRIGHT. FLORENTINA HAJDARI HAJRA
TË GJITHA TË DREJTAT TË REZERVUARA 2024

DEDIKIM

*Prindërve të mi për mbështetjen, besimin dhe ëndrrën e realizuar bashkë me mua.
Vëllezërve të mi, tre krahët e mi të padukshëm në të cilët mbështetem çdoherë.
Bashkëshortit tim, për shtytjen e madhe, shpesh edhe përtej besimit tim mbi kufijtë e mi
të mundshëm. Fëmijëve të mi, për motivimin që më japin që çdo gjë që bëjë t'ua pasoj
atyre si shembull për t'u ndjekur.*

Epik dhe Maltina, ju premtoj që verën nuk do ta kalojmë më mbyllur duke shkruar në PC. 😊

Faleminderit, jam shumë me fat!

FALËNDERIM

Falënderoj thellësisht mentorin tim Prof. Agron Rustemi, për udhëzimet dhe përkushtimin e paepur ndaj zhvillimit tim shkencor. Stafin e profesorëve të Universitetit, për ligjërimet cilësore e frymëzuese, dijes dhe mundësive të cilat padyshim më ofruan një platformë të shkëlqyeshme për zhvillimin tim akademik. Stafin administrativ të SEEU, për mbështetjen teknike të pashoq gjatë gjithë rrugëtimit.

Gjithashtu, falënderoj të gjithë ata që morën pjesë në intervista dhe biseda, duke kontribuar në pasurimin e këtij disertacioni. Institucionet që hapën dyert e tyre për hulumtimin tim, ju falënderoj për mundësinë dhe resurset e ofruara.

Në fund, faleminderit të gjithë atyre që më mbështetën dhe inkurajuan gjatë kësaj rruge, sepse çdo ndihmë dhe fjalë inkurajuese kanë bërë dallim në këtë udhëtim.

DEKLARATË

Me anë të kësaj deklarate, unë FLORENTINA HAJDARI HAJRA, duke ditur përkufizimin dhe format e plagjiaturës në botën akademike dhe duke iu referuar dokumenteve në fuqi në Universitetin e Evropës Juglindore, më tutje UEJL, deklaroj që:

- punimi i paraqitur këtu është origjinal dhe është kryer personalisht nga unë;
- punimi nuk është marrë nga studentë të tjerë apo punime të tjera në UEJL ose nga ndonjë universitet tjetër;
- punimi nuk është kopje e ndonjë punimi të marrë në internet apo bibliotekë;
- punimi nuk përmban modifikim të dhënash, duke i paraqitur ato si personale;
- punimi respekton të gjitha kërkesat për të drejtat e autorit, duke saktësuar dhe cituar të gjitha kontributet nga burimet e tjera.

Punimi i tezës së disertacionit vlen për nivelin e tretë të studimeve, pra për Studimet e Doktoratës dhe mban titullin: “PJESËMARRJA E STRUKTURUAR NË POLITIKËBËRJE SI MJET I RËNDËSISHËM PËR ZHVILLIMIN E DEMOKRACISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”.

Me nënshkrimin e kësaj deklarate, vërtetoj, se çfarë u tha më sipër është e vërtetë dhe për çdo gjë të vërtetuar ndryshe mbaj përgjegjësi personalisht.

Florentina Hajdari Hajra



PËRMBAJTJA

DEDIKIM	III
FALËNDERIM.....	IV
DEKLARATË	V
LISTA E TABELAVE	X
LISTA E FIGURAVE	XI
SHKURTESAT	XIII
ABSTRAKT.....	XIV
ABSTRACT	XV
SKICA E TEZËS	XVI
KAPITULLI I: HYRJE	19
1.1. Rëndësia e problemit	21
1.2. Pyetja hulumtuese dhe hipotezat	26
1.3. Hipotezat kryesore të tezës	26
1.4. Variablat	27
1.5. Konceptet themelore	28
1.5.1. Përmirësimi i cilësisë së vendimeve	31
1.5.2. Minimizimi i kostos dhe vonesës	31
KAPITULLI II: KONCEPTET THEMELORE DHE LITERATURA	33
2.1. Përkufizimet	35
2.2. Pjesëmarrja e ekspertëve dhe grupeve të interesit në planifikim.....	38
2.3. Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes	39
2.4. Organizimi për pjesëmarrje	42
2.5. Identifikimi dhe njohja e palëve të interesit.....	43
2.6. Qasjet e reja në pjesëmarrjen e publikut	47
2.7. Bashkërendimi i politikave publike dhe përfshirjes së shoqërisë civile dhe ekspertëve.....	48
KAPITULLI III: METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	51

3.1. Burimet e provave.....	52
3.2. Analiza e të dhënave	53
3.3. Kredibiliteti.....	55
3.4. Modeli për analizën e të dhënave	55
3.5. Kufizimet	57
KAPITULLI IV: KUADRI LIGJOR DHE MEKANIZMAT E PJESËMARRJES	59
4.1. Kuadri ligjor ndërkombëtar.....	59
4.1.1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ).....	60
4.1.2. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP)	61
4.1.3. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (KEFDR) 62	
4.1.4. Konventa për Zhdukjen e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KZHGFJFDG)	62
KZHGFJFDG	62
4.1.5. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEMDNJ).....	63
4.1.6. Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale (KEVL)	64
4.1.7. CM / Rekomandimi (2007) për statusin juridik të OJQ-ve.....	65
4.1.8. Kodi i praktikës së mirë për pjesëmarrjen civile në procesin e vendimmarrjes (2009)	65
4.2. Kuadri ligjor për pjesëmarrjen e qytetarëve në Kosovë	66
4.2.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.....	66
4.2.2. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë	67
4.2.3. Ligji për Qasje në Dokumentet Publike.....	68
4.2.4. Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë	68
4.2.5. Udhëzimi Administrativ mbi Standardet Minimale të Konsultimeve Publike në Komuna	69
4.2.6. Udhëzimi Administrativ për Transparencën në Komuna	70
4.2.7. Ligji për krijimin, organizimin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në nivele të komunave	71

4.2.8. Udhëzimi Administrativ për Ueb faqet e Institucioneve Publike	72
4.2.9. Udhëzimi Administrativ mbi Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Hapësinor	73
4.2.10. Statuti i Komunës	74
KAPITULLI V: RASTET E STUDIMIT DHE ANALIZA E TË DHËNAVE	75
5.1. Rast studimi I: Rëndësia e pjesëmarrjes publike në ndërtimin e demokracive në shtetet e ish-Jugosllavisë. Rast studimor: Kosova dhe Kroacia	76
5.1.1. Prezantim i rastit	76
5.1.2. Pjesëmarrja publike dhe demokracia	77
5.1.3. Rënia e Jugosllavisë ka ndikuar në zhvillimin e demokracisë në Kosovë dhe Kroaci	78
5.1.4. Situata aktuale e zhvillimit të demokracisë nëpërmjet pjesëmarrjes publike	79
5.1.5. Konkluzion dhe rekomandime	86
5.2. Rast studimi II: Rritja e Pjesëmarrjes Publike Gjimore në Demokracitë e Reja: Ndikimi i Normave Sociale në Proaktivitetin e Grave në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut	87
5.2.1. Teoria e pjesëmarrjes gjimore	88
5.2.2. Mobilizimi i Grave, Angazhimet Qytetare dhe Sfidat shoqëruese	93
5.2.3. Konkluzion	95
5.3. Rast studimi III: Procesi i konsultimit në nivel qendror: Konsultimet e MINT mbi projektligjet: për Sigurinë së Përgjithshme të Produkteve, për Inspektoratin e Tregut, si dhe për Metrologji	97
5.3.1. Analiza e përgjithshme 2019 – 2022	98
5.3.2. Pjesëmarrja në proces të konsultimit dhe komentet	102
5.3.3. Komentet direkt në platformën online dhe metodat e përdorura të konsultimit	103
5.3.4. Konsultimet Publike në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - MINT	108

5.4. Rast studimi IV: Avancimi i pjesëmarrjes pro aktive të qytetarëve dhe palëve të interesit në politikëbërje në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj përmes zbatimit të Planit Komunal për Pjesëmarrje Qytetare	124
5.4.1. Analiza e situatës	127
5.5. Përfundime	150
KAPITULLI VI: TESTIMI I HIPOTEZAVE DHE PËRFUNDIMET	153
6.1. Përfundim dhe rekomandime.....	160
6.2. Mundësia për studime të mëtejme	162
BURIMET DHE LITERATURA	164
SHTOJCAT I	178
Intervistat e ndara në kategori	178

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Teknikat e përbashkëta të pjesëmarrjes së palëve të interesit përfshirë grupet e ekspertëve.....	44
Tabela 2. Kriteret e përfshirjes së palëve të interesit/ekspertëve/ modifikuar nga (Zakharova, 2014)	53
Tabela 3. Roli dhe numri i të intervistuarve.....	54
Tabela 4. Renditja e Indeksit Global të Hendekut Gjinor sipas rajonit, 2021	91
Tabela 5. Kriteret e vlerësimit sipas Rregullores për Standarde Minimale	97
Tabela 6. Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat e hapur gjatë periudhës - Data: 01.01.2022 - 31.12.2022	104
Tabela 7. Metodat e përdorura të konsultimit të pasqyruar në raportin final, MINT 2022	113
Tabela 8. Metodat e përdorura të konsultimit publik, raporti final i konsultimit, MINT 2022	119
Tabela 9. Analiza SUOT e Komunës së Mitrovicës, PPQ Mitrovicë.....	128
Tabela 10. Analiza SUOT e komunës së Vushtrrisë dhe Skenderaj	129

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Aspekti kohor i vendimit të njëanshëm vs me pjesëmarrje	31
Figura 2. Nivelet e pjesëmarrjes publike, Burimi British Columbia 2008	36
Figura 3. Format e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në varësi të potencialit për ndikim publik në një vendim.....	37
Figura 4. Shkallët e pjesëmarrjes. Burimi: Sherry Arnstajn (Arnstein)	40
Figura 5. Hapa kyçë në procesin e planifikimit	42
Figura 6. Fazat e planifikimit dhe pjesëmarrjes së ekspertëve në kohë (Burimi: modifikuar nga (Creighton, 2005).....	48
Figura 7. Indeksi i participimit të shoqërisë civile, V-Dem 2022.....	79
Figura 8. Indeksi i pjesëmarrjes demokratike, V-Dem 2023	80
Figura 9. Indeksi i pjesëmarrjes demokratike, Kroaci. V-Dem 2023.....	81
Figura 10. Dalja në zgjedhje në Kosovë dhe Kroaci, V-Dem 2020	82
Figura 11. Ambienti i pjesëmarrjes së Shoqërisë Civile, V-Dem 2023	83
Figura 12. Kroacia: Statusi i demokracisë sipas Atlasit të Transformimit.....	84
Figura 13. Statusi i Demokracisë në Kosovë, sipas BTI 2023	85
Figura 14. Indeksi i Transformimit Kosova Vs. Maqedonisë së Veriut 2022	92
Figura 15. Pjesëmarrja e grave në shoqërinë civile, raporti V-Dem 2022	94
Figura 16. % e konsultave publike me/pa raporte finale 2019. Burimi: Platforma online e konsultimeve.....	99
Figura 17. % e konsultave publike me/pa raporte finale 2020. Burimi: Platforma online e konsultimeve.....	99
Figura 18. % e konsultave publike me/pa raporte finale 2021. Burimi: Platforma online e konsultimeve.....	101
Figura 19. Statistika e dokumente të publikuara sipas institucioneve (qendrore). Burimi: Platforma e konsultimeve publike	106
Figura 20. % e konsultave publike me raportet finale 2022. Burimi: Platformë e konsultimit publik	107

Figura 21. Numri i të ftuarve vs. kontributet	112
Figura 22. Të ftuarit vs kontributdhënësit. Ligji për Metrologji	117
Figura 23. Të ftuarit vs. kontributdhënësit. Ligji për Inspektoriatin e Tregut	118
Figura 24. Konsultimet komunale mbi dokumentet publike	131
Figura 25. Teknikat e konsultimit publik në komuna.....	132
Figura 26. Formimi i komiteteve konsultative për pjesëmarrje të qytetarëve	133
Figura 27. Konsultimet mbi projektplanin për Transparencë komunale 2023 -2027 komuna e Mitrovicës	135
Figura 28. Konsultimet mbi projektplanin për Transparencë komunale 2023 -2027 komuna e Skenderaj	137
Figura 29. Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike 2020 - 2022 komuna e Mitrovicës	139
Figura 30. Pjesëmarrja në takimin e parë publik të Kryetarit të Skenderaj (Korrik 2023)	140
Figura 31. Pjesëmarrja në takimin e parë publik të Kryetarit të Mitrovicës (Dhjetor 2022)	143
Figura 32. Statistikat nga dëgjimet buxhetore për planbuxhetin 2023-25 komuna e Mitrovicës	149
Figura 33. Zhvillimi i demokracisë, pjesëmarrja e grave dhe shoqërisë civile në Kosovë, 2010 - 2023, sipas raportit vjetor V-Dem 2023	155
Figura 34. Kërkesat për qasje në dokumente, sipas KDI 2022.....	156
Figura 35. Pjesëmarrja e publikut në komuna, KDI 2022	156
Figura 36. Transparemotri komunal sipas KDI, modifikuar nga autorja (2019 - 2022) ..	158
Figura 37. Përmbushja e përgjithshme e treguesve nga ministritë, D+ 2022	159

SHKURTESAT

BTI	-	Indeksi i Transformimit Bertelsmann
DUDNJ	-	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
EULEX	-	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
INDEP	-	Instituti për Politika Zhvillimore
IPA	-	Instrumenti për Asistencën e Para-anëtarësimit
KEFDR	-	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor
KEMDNJ	-	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
KEVL	-	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale
KFOR	-	Forcat e Kosovës (NATO)
KVR	-	Këshillin e Veprimit Rinor Lokal
KZHGJFDG	-	Konventa për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
MAP	-	Ministria e Administratës Publike
MAPL	-	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MINT	-	Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MMPH	-	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor
MSA	-	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OKB	-	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PNDGP	-	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
PPQ	-	Plani Komunal për Pjesëmarrje Qytetare
V-DEM	-	Varieties of Democracy
ZKM	-	Zyra e Kryeministrit

ABSTRAKT

Ky disertacion i doktoratës eksploron rolin e shoqërisë civile, grupeve të interesit, ekspertëve dhe publikut të gjerë në proceset e vendimmarrjes publike në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor, me një theks të veçantë mbi ndikimin e tyre në demokratizim dhe përmirësimin e politikave publike. Përmes një analize të thelluar të literaturës dhe katër rasteve të studimit, ky disertacion analizon temat e ndërtimit të demokracive në shtetet post-jugosllave, pjesëmarrjen gjinore në demokracitë e reja, proceset e konsultimit në nivel qendror në Kosovë, dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në politikëbërje lokale.

Rezultatet tregojnë se pjesëmarrja e strukturuar e publikut dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe publikun e gjerë, përfshirë ekspertët mund të kontribuojnë në ndërtimin e strukturave demokratike dhe optimizimin e politikave. Studimi i rasteve ofron një pasqyrë empirike të mënyrës se si këto procese ndodhin në praktikë, dhe identifikon rekomandime për përmirësimin e proceseve vendimmarrëse në një kontekst ku demokracia është në zhvillim.

Ky hulumtim disertacioni përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në fushën e studimeve të demokracisë dhe vendimmarrjes, dhe ofron një orientim të ri për praktikën e pjesëmarrjes publike në një kontekst rajonal që mbetet i pazbuluar mjaftueshëm. Disertacioni mund të shërbejë si një referencë e dobishme për akademikë, praktikues dhe vendimmarrës që janë të angazhuar në përmirësimin e proceseve demokratike në Kosovë dhe rajon.

Fjalë kyçe: *pjesëmarrje e strukturuar, politikëbërje, shoqëri civile, ekspert, zhvillim i demokracisë, Republika e Kosovës.*

ABSTRACT

This doctoral dissertation explores the role of civil society, interest groups, experts and the general public in public decision-making processes in Kosovo and the Eastern Balkans, with a special emphasis on their impact on democratization and the improvement of public policies. Through an in-depth literature review and four case studies, the study analyzes the themes of democracy building in post-Yugoslav states, gender participation in new democracies, central level consultation processes in Kosovo, and civil society participation in local policymaking.

The results show that structured public participation and cooperation with civil society and wider public including experts can contribute to building democratic structures and optimizing policies. The case studies provide an empirical overview of how these processes occur in practice, and identifies recommendations for improving decision-making processes in a context where democracy is developing.

This dissertation represents an important contribution to the field of democracy and decision-making studies, and offers a new orientation to public participation practices in a regional context that remains underexplored. The dissertation can serve as a useful reference for academics, practitioners and decision makers who are engaged in improving democratic processes in Kosovo and the region.

Keywords: *structured participation, policymaking, civil society, experts, democratization, Republic of Kosovo.*

SKICA E TEZËS

Kapitulli i parë, "Hyrja" fillon me një përshkrim të kontekstit dhe rëndësisë së hulumtimit, si dhe me elaboratin e qëllimit dhe pyetjeve kryesore të këtij studimi. Pasi vjen një shpjegim i detajuar i konceptit të shoqërisë civile dhe marrëdhënieve të saj me procesin vendimmarrës, pasohet me rëndësinë e hulumtimit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në vendimmarrje dhe bashkëpunimin me ekspertët e fushave të ndryshme në avancimin e politikave publike në Kosovë, si dhe përfshirjen e komuniteteve pakicë në vendimmarrje. Ky kapitull shpjegon shkurtimisht katër rastet e studimit të cilat në mënyrë të detajuar analizohen në kapitujt vijues.

Kapitulli i dytë, "Konceptet Themelore dhe Literatura", shpjegon disa koncepte themelore që janë të rëndësishme për të kuptuar temën e hulumtimit, si pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin vendimmarrës, politikat publike, dhe ekspertiza e fushave të ndryshme. Pastaj, paraqitet një shqyrtim i literaturës, duke analizuar studimet e mëparshme në lidhje me temën dhe duke vënë në dukje nevojën për një hulumtim të tillë në kontekstin e Kosovës. Në fund të kapitullit 2, paraqesim një sintezë të përgjithshme të koncepteve dhe literaturës, duke vendosur theksin në nevojën e një hulumtimi të hollësishëm dhe të detajuar.

Kapitulli i tretë "Metodologjia e Hulumtimit" trajton metodologjinë e përdorur në këtë hulumtim. Në këtë kapitull përfshihen detaje rreth metodave të përdorura për të grumbulluar dhe analizuar të dhënat. Përveç kësaj, diskutohet rreth përfitimeve dhe kufizimeve të metodologjisë së përdorur. Kapitulli fillon me një përshkrim të metodës së studimit të rasteve, observimit dhe intervistave si metodat kryesore të përdorura për grumbullimin e të dhënave. Pastaj, do të diskutohet rreth procesit të zgjedhjes së respondentëve dhe si u realizuan intervistat. Në vijim, do të paraqiten detajet rreth analizës së të dhënave dhe si u arritën përfundimet e hulumtimit. Përveç kësaj, kapitulli përmbledh kufizimet e metodologjisë së përdorur dhe si këto kufizime kanë ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e përfundimeve të arritura.

Kapitulli i katërt “Kuatridheor ligjor” dhe mekanizmat aktualë të pjesëmarrjes” përmban një analizë të hollësishme të kuadrit ligjor dhe mekanizmave aktualë të pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës në fushën ndërkombëtare e veçanërisht me fokus në Kosovë. Në këtë kapitull, është bërë një shqyrtim i gjerë i legjislacionit relevant në fushën e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin vendimmarrës, është analizuar se si ky kuadër ligjor është zbatuar në praktikë. Në këtë kapitull, është diskutuar rëndësia e një kuadri ligjor të përshtatshëm për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës dhe kemi shqyrtuar legjislacionin aktual në Kosovë që mbështet këtë qëllim.

Kapitulli i pestë “Analiza e rasteve studimore” trajton katër studime të veçanta lidhur me rolin e shoqërisë civile dhe publikut të gjerë në proceset e vendimmarrjes publike. Dy rastet e para të studimit kanë arritur të publikohen në revista shkencore, dhe dy rastet të tjera janë në përpunim e sipër për publikim. Këto studime përqendrohen te përvojat nga praktika e vendimmarrjes duke ofruar një kuptim më të thellë të temave të nisura në fillim. Elementët kyçë të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje janë eksploruar përmes këtyre rasteve studimore.

1. Studimi i parë analizon rëndësinë e pjesëmarrjes publike në formimin e demokracive në shtetet post-jugosllave, me theks të veçantë në Kosovë dhe Kroaci.
2. Studimi i dytë i dedikohet rritjes së pjesëmarrjes gjinore në demokracitë e reja, duke u përqendruar tek ndikimi i normave sociale mbi aktivizimin e grave në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.
3. Studimi i tretë shqyrton procesin e konsultimit në nivel qendror, duke analizuar si rast specifik konsultimet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - MINT mbi disa projektligje.
4. Studimi i katërt ka për qëllim të theksojë rritjen e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe grupimeve të ndryshme të interesit në formimin e politikave në

nivel lokal (Komunat: Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj), përmes implementimit të Planit Komunal për Pjesëmarrje Qytetare.

Kapitulli i gjashtë “Diskutimi dhe Përfundimet” analizon përgjigjet e arritura nga pyetjet kryesore të hulumtimit dhe rreth secilit prej objektivave specifike të hulumtimit. Në këtë kapitull diskutohet rreth vlerësimit të përgjigjeve të arritura dhe se nëse ato janë në përputhje me objektivat e hulumtimit. Përveç kësaj, diskutohet rreth rëndësisë dhe ndikimit të përgjigjeve të arritura në kontekstin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në vendimarrjen dhe bashkëpunimin me ekspertë.

KAPITULLI I: HYRJE

Ky disertacion fokusohet në temën e pjesëmarrjes së strukturuar në politikëbërje të shoqërisë civile, ekspertëve dhe publikut si një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e demokracisë në Republikën e Kosovës. Qëllimi kryesor i studimit është të vlerësojë se si pjesëmarrja e strukturuar e publikut mund të ndikojë në politikat dhe vendimet e marra në nivel lokal dhe qendror në Kosovë. Kjo tezë do të analizojë mekanizmat, rolin e strukturave të shoqërisë civile dhe ekspertëve në ciklin e politikës publike. Hulumtimi synon të paraqesë një pasqyrë të rëndësishme praktike dhe teorike të mekanizmave të pjesëmarrjes së ekspertëve dhe shoqërisë civile duke përfshirë dhe grupet e marginalizuara (komunitetet pakicë, personat me aftësi të kufizuara, gratë, etj.) në procesin e vendimmarrjes publike.

Qëllimi i studimit është dyfishtë:

1. **Të kuptojë:** Përmes analizës së rasteve specifike, të kuptojë më mirë mënyrën se si shoqëria civile dhe grupet e ndryshme qytetare mund të luajnë një rol në formimin dhe zbatimin e politikave publike, dhe si kjo lidhet me ndërtimin dhe forcimin e demokracive të reja.
2. **Të ndihmojë:** Të ofrojë rekomandime dhe udhëzime për praktikuesit dhe vendimmarrësit, duke ndihmuar në përmirësimin dhe zgjerimin e praktikave demokratike të pjesëmarrjes.

Tema e këtij disertacioni përqendrohet te analiza e rolit të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë në proceset e vendimmarrjes publike në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Studimi synon të zbulojë mënyrat se si pjesëmarrja e qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë mund të ndikojë në zhvillimin e politikave demokratike, dhe si kjo pjesëmarrje ka evoluar dhe ndryshuar në kontekstin e shteteve post-jugosllave.

Objektivi kryesor i hulumtimit është të thellojë kuptimin e dinamikave, sfidave dhe mundësive që lidhen me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen publike. Kjo do të arrihet përmes një analize të hollësishme të katër rasteve studimore, të cilat janë

përfshirë në kapitullin e pestë, si dhe të një vlerësimi gjithëpërfshirës të ndikimit dhe pasojave të këtyre dinamikave.

Roli i shoqërisë civile, publikut, grupeve të interesit dhe ekspertëve në vendimmarrjen publike është një çështje thelbësore që ka një ndikim të madh në zhvillimin dhe funksionimin e shteteve demokratike. Në kontekstin e Kosovës dhe rajonit më të gjerë, kjo bëhet edhe më e rëndësishme, pasi proceset demokratike janë ende në zhvillim dhe mund të jenë të ndikuar nga dinamikat e brendshme dhe ndërkombëtare. Kuptimi dhe përmirësimi i këtyre proceseve mund të ndihmojë në ndërtimin e strukturave më të qëndrueshme dhe të përfshirjes demokratike.

Pjesëmarrja publike është një proces i dyanshëm i komunikimit dhe ndërveprimit midis organizatës që merr vendimin dhe publikut të përfshirë, me qëllim që vendimet të mbështeten në vlerat, nevojat dhe shqetësimet e publikut. Për të përfshirë publikun në procesin e vendimmarrjes, është e rëndësishme që procesi të jetë i organizuar dhe të ketë një nivel të përshtatshëm të ndikimit të pjesëmarrësve në vendim. Një nga faktorët kryesorë që thekson rolin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen publike është natyra politike e shumicës së vendimeve publike, ku pjesëmarrja aktive e komunitetit mund të ndihmojë në parandalimin e vendimeve që do të dëmtonin interesat e tyre.

Megjithatë, një pyetje që ngritet në lidhje me pjesëmarrjen e publikut është se si një publik "laik" mund të japë një kontribut domethënës në një vendim përfundimtar që bazohet në argumente teknike, shkencore dhe prova. Në këtë rast, ekspertët luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes publike, pasi ata mund të ndihmojnë në ndërtimin e një planifikimi të pavarur, objektiv dhe racional, si dhe të ndihmojnë në mbrojtjen e interesave të secilës palë.

Për të pasur një proces të pjesëmarrjes publike të suksesshëm, është e rëndësishme që organizatat publike të kenë një dialog të strukturuar me komunitetin dhe të kategorizojnë linjat e ekspertëve me të cilët do të kenë marrëdhënie profesionale dhe gjithëpërfshirëse. Kjo do të ndihmonte në sigurimin e një pjesëmarrje aktive dhe efektive të publikut në procesin e vendimmarrjes publike.

Disertacioni përdorë një kombinim të metodave kualitative për të zbërthyer çështjet e lartpërmendura. Përmes intervistave, vëzhgimeve, analizës së të dhënave dhe studimeve të rasteve, do të synohet një kuptim i thellë dhe i shumanshëm i temës. Kapitulli i pestë, i cili përfshin katër raste studimore, do të jetë pjesa kryesore e kësaj analize dhe do të shërbejë si pikë qendrore për reflektimin dhe vlerësimin e gjetjeve. Për të arritur qëllimet e këtij studimi, do të përdorë metodën e intervistave të thelluara me përfaqësues të institucioneve, tek rastet e studimit në nivel qeverisës, strukturave të shoqërisë civile dhe ekspertëve të përfshirë në procesin e politikës publike në nivel lokal dhe qendror në Kosovë. Gjithashtu, do të bëhet një analizë e dokumenteve si politikat publike, raportet e monitorimit dhe materiale të tjera relevante që kanë të bëjnë me politikat dhe vendimet në fushat e ndryshme në linjë me rastet e studimit.

Burimet që do të përdoren në këtë studim përfshijnë dokumente zyrtare të qeverisë, organizata të shoqërisë civile, si dhe burime të ndryshme shkencore që kanë të bëjnë me fushën e politikës publike dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në procesin politik. Ky studim synon të kontribuojë në zhvillimin e një debati më të thellë dhe më të qartë në lidhje me mekanizmat praktikë të pjesëmarrjes së strukturuar të shoqërisë civile dhe ekspertëve në zhvillimin e demokracisë në Republikën e Kosovës.

Disertacioni ndërtohet mbi një bazë të gjerë të literaturës ekzistuese dhe synon të zgjerojë kufijtë e kuptimit të rolit të shoqërisë civile në vendimmarrjen publike. Nëpërmjet një analize të detajuar dhe të orientuar drejt rasteve, ky hulumtim ofron një kontribut të rëndësishëm për fushën dhe mund të shërbejë si një burim për akademikë, praktikues dhe vendimmarrës në Kosovë dhe më gjerë.

1.1. Rëndësia e problemit

Ky seksion synon të ofrojë një pasqyrë të rëndësisë praktike dhe teorike të tezës. Historia e pjesëmarrjes në vendimmarrje ka ndryshuar gjatë historisë së njerëzimit. Në Greqinë e lashtë, pjesëmarrja në vendimmarrje kishte një karakter elitist dhe kufizohej në shtresat e larta të shoqërisë (Hanson, 1993, p. 540). Megjithatë, me ardhjen e demokracisë në

Athinë në shekullin e 5 p.e.s., qytetarët e përgjithshëm u lejuan të marrin pjesë në debatet publike dhe votimet për vendimet politike (Ober, 2008, p. 39).

Në mesjetë, pjesëmarrja në vendimmarrje u kufizua përsëri në shtresat e larta të shoqërisë dhe ishte e lidhur ngushtësisht me pushtetin klerikal dhe aristokratik. Gjatë Rilindjes, idealet e demokracisë dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje filluan të ndërtohen përsëri, veçanërisht në Itali (Grendi, 2022). Në shekullin e 18, revolucioni francez shënoi një ndryshim radikal në marrëdhëniet midis shtetit dhe qytetarëve. Për herë të parë, koncepti i sovranitetit popullor zëvendësoi sovranitetin e mbretërisë, duke bërë që pjesëmarrja në vendimmarrje të bëhej një prej parimeve themelore të demokracisë moderne (Rosanvallon, 2008, p. 348).

Në kohën moderne, pjesëmarrja në vendimmarrje ka ndryshuar përsëri. Me ardhjen e teknologjisë dhe zhvillimin e internetit, pjesëmarrja elektronike dhe votimet janë bërë të mundshme, duke lejuar një gamë më të gjerë të qytetarëve të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes (Bimber, 2003, pp. 53-66). Në këtë kontekst, konceptet e demokracisë direkte dhe të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje janë rritur në rëndësi dhe janë bërë subjekt i diskutimit në mënyra të ndryshme (Warren, 2017, pp. 39-53).



Figura 1 Vazhdimësia e pjesëmarrjes

Në këtë aspekt, problemi studimor i "Pjesëmarrja e strukturuar në politikëbërje si një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e demokracisë në Republikën e Kosovës" është i rëndësishëm për shkak të disa arsyeve të rëndësishme: Pjesëmarrja kuptohet më së miri si një vazhdimësi. Meqenëse është një vazhdimësi, ka vërtet një numër të pafund pikash përgjatë shkallës, por për qëllimet tona ekzistojnë katër kategoritë kryesore të paraqitura në Figurën 1.¹

Programet e informimit publik janë në thelb komunikimi i njëanshëm me publikun. Por megjithëse informacioni publik në vetvete nuk përbën pjesëmarrje publike, ai mbetet një komponent thelbësor i një programi efektiv të pjesëmarrjes publike. Njerëzit nuk mund të marrin pjesë nëse nuk marrin informacion të plotë dhe objektiv mbi të cilin bazojnë gjykimet e tyre (Creighton, 2005, p. 89).

Agjencitë qeveritare kanë pasur sukses shumë më të madh duke punuar në bashkëpunim me publikun për të gjetur një zgjidhje që do të gëzojë mbështetje të gjerë. Kjo qasje nuk rezulton gjithmonë në marrëveshje. Ndonjëherë gjithçka që ndodh është se pozicionet qartësohen përmes ndërveprimit dhe të gjithë e kuptojnë arsyen që qëndron pas vendimit. Ndonjëherë ndërtohet një marrëveshje e mjaftueshme që agjencia të jetë në gjendje të vazhdojë me legjitimitet të mjaftueshëm që të ketë pranim të heshtur edhe nga ata që nuk e mbështesin veprimin (Creighton, 2005, p. 45).

Kur procesi përfundon, publiku zakonisht ka ndikuar në vendim edhe nëse nuk ka marrëveshje përfundimtare dhe agjencia ruan autoritetin përfundimtar për të vepruar. Ndikimi i publikut mund të ketë ndihmuar se si u përcaktua problemi, gamën e alternativave që u morën parasysh, kriteret e vlerësimit që u aplikuan dhe procesin me të cilin u mor vendimi, edhe nëse nuk ka marrëveshje për rezultatin përfundimtar.

Është në interes të veçantë, dhe shumë e rëndësishme që mbi politika publike “politikisht korrekte” që nxisin pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje në shoqërinë tonë, me

¹ Shënim: Për një përshkrim më të detajuar të një vazhdimësie të tillë, shihni Spektrin e Pjesëmarrjes Publike të Shoqatës Ndërkombëtare për Pjesëmarrje Publike, që mund të shkarkohet në <http://iap2.org/practitionertools/index.shtml>.

qëllimin kryesor avancimin e demokracisë në vend, të analizohen edhe format e pjesëmarrjes. Ky dialog shkencor duhet të zhvendos qendrën e gravitetit të vendimmarrjes tek pyetjet e hulumtimit nga lloji "a duhet të kemi pjesëmarrjen e publikut në gravitet të vendimmarrjes?" në "si duhet të trajtohet pjesëmarrja e publikut në gravitet të vendimmarrjes?".

Natyrisht, ka shumë pikëpamje mbi objektivat dhe rolin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit. Në këtë studim mëtoj që shkurtimisht të rishikojmë dhe të diskutojmë mbi gjendjen në këtë fushë. Diskutimi mbi tendencat aktuale drejt pjesëmarrjes së publikut dhe marrëdhëniet e tij me zhvillimet globale, format dhe llojet e pjesëmarrjes në politikëbërje. Cilat mekanizma institucionalë dhe legjislativë ekzistojnë për pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe si ndikojnë ato në proceset e politikëbërjes?

Në Kosovë, procesi i konsultimit me palët joqeveritare kryhet në përputhje me Udhëzimin për Procesin e Konsultimeve Publike. Ky udhëzim specifikon se ministria e origjinës do të publikojë thelbin e propozimit për komentim publik dhe do të kërkojë në mënyrë specifike komentet e organizatave joqeveritare që do të prekeshin ndjeshëm nga propozimi. Në kryerjen e këtij konsultimi, organi fillestar duhet të sigurojë informacion të mjaftueshëm në një formë të kuptueshme publike për të lejuar publikun të kuptojë natyrën dhe pasojat e propozimit. Institucioni i origjinës së propozimit gjithashtu duhet të shpallë publikisht fillimin e konsultimit dhe të lejojë kohë të mjaftueshme për publikun dhe organizatat joqeveritare të komentojnë dhe të marrin parasysh rekomandimet dhe të ofrojnë përgjigje.

Strukturat e zhvillimit të politikave në ministri dhe institucione lokale janë të vogla, por ato kanë rezultuar të jenë efektive dhe janë përdorur në mënyrë fleksibël, veçanërisht përmes grupeve të punës, për të mobilizuar burimet për punë të veçanta analitike ose përgatitore të nevojshme përpara përpunimit të politikave të reja (Kasemets, 2015, p. 45). Konsultimet ndërministrore dhe publike funksionojnë në mënyrë rutinore, por shpesh janë të pjesshme dhe në një fazë mjaft të vonshme në procesin e hartimit. Nga studime

të shumta, ky konstatim është valid edhe për Republikën e Kosovës, i cili do të shtjellohet më gjerësisht në kapitullin IV të kësaj teze.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe ekspertëve në politikëbërje është thelbësore për zhvillimin e demokracisë në Republikën e Kosovës. Kjo do të thotë se një ‘marrëveshje e përbashkët’ duhet të arrihet midis tyre dhe shtetit në çështje të rëndësishme politike për të krijuar një platformë të përbashkët për të bërë që vendimmarrja të jetë sa më e përgjegjshme dhe efikase. Për shkak të përmirësimit të legjitimitetit të vendimmarrjes dhe implementimit të vendimeve, pjesëmarrja e strukturuar në politikëbërje të shoqërisë civile dhe ekspertëve është e rëndësishme në Republikën e Kosovës. Me këtë, përfshirja e palëve, sipas një plani të strukturuar, në procesin e politikëbërjes do të ndihmojë për të përmirësuar përkrahjen publike dhe besueshmërinë në institucionet e shtetit. Të bëhesh pjesë e procesit të politikëbërjes është një nga mënyrat më të mira për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe zbatimin e vendimeve. Shoqëria civile dhe ekspertët kanë një rol të rëndësishëm në identifikimin e problemeve të rëndësishme dhe në ofrimin e zgjidhjeve më efektive.

Studimi i pjesëmarrjes së strukturuar të shoqërisë civile dhe ekspertëve në politikëbërje në Kosovë është i rëndësishëm për zhvillimin e demokracisë në vend. Për të pasur një demokraci funksionale, është e rëndësishme që shoqëria civile dhe ekspertët të jenë të përfshirë në procesin politik, pasi ata ndjehen të përgjegjshëm dhe të përkushtuar ndaj zhvillimit të vendit. Gjithashtu, një studim i tillë mund të ndihmojë në identifikimin e sfidave që përballen shoqëria civile dhe ekspertët në pjesëmarrjen e tyre në politikëbërje. Duke pasur një kuptim të qartë të këtyre sfidave, mund të zhvillohen strategji për të adresuar dhe tejkaluar këto sfida.

Studimi i pjesëmarrjes së strukturuar të shoqërisë civile dhe ekspertëve në politikëbërje mund të ndihmojë në identifikimin e mënyrave se si politikanët dhe institucionet publike mund të ndihmojnë në përmirësimin e pjesëmarrjes së tyre në proceset politike. Duke kuptuar nevojat e tyre dhe sfidat që hasin, politikanët mund të krijojnë mjediset e

nevojshme për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre dhe për të siguruar se ata kanë ndikim në vendimmarrje.

Për më tepër, një studim i tillë mund të ndihmojë në thellimin e diskutimeve për rolin e shoqërisë civile dhe ekspertëve në përmirësimin e zhvillimit të demokracisë në Kosovë dhe në nivel global. Duke përdorur rezultatet e studimit, mund të bëhet debat më i gjerë dhe më i informuar rreth mënyrave se si pjesëmarrja strukturore e shoqërisë civile dhe ekspertëve mund të ndihmojë në zhvillimin e demokracisë në vendet e tjera.

1.2. Pyetja hulumtuese dhe hipotezat

Pyetja kryesore kërkimore e punimit është:

Si ndikojnë mekanizmat e pjesëmarrjes së publikut dhe shoqërisë civile, duke përfshirë grupet e marginalizuara, në procesin e vendimmarrjes publike dhe në zhvillimin e demokracisë?

1.3. Hipotezat kryesore të tezës

Hipoteza I: Pjesëmarrja e publikut dhe e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes është e rëndësishme për avancimin e demokracisë në Republikën e Kosovës.

- Intervistat me aktivistë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucioneve qeveritare mund të demonstrojnë se pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes është e nevojshme për të rritur transparencën dhe legjitimitetin e procesit vendimmarrës.
- Studimet e rasteve të politikave publike të ndryshme mund të tregojnë se politikat publike që janë hartuar dhe zbatuar duke u konsultuar me shoqërinë civile kanë pasur më shumë sukses në adresimin e nevojave dhe në arritjen e qëllimeve të vendosura.

Hipoteza II: Bashkëpunimi i strukturuar me shoqërinë civile, ekspertët e fushave të ndryshme dhe grupet e magjinalizuara në procesin e vendimmarrjes dhe implementimit të politikave publike ndikon në avancimin e demokracisë në Republikën e Kosovës.

- Intervistat me përfaqësues të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushave të ndryshme mund të tregojnë se bashkëpunimi i strukturuar i tyre në procesin e vendimmarrjes dhe implementimit të politikave publike ka pasur një ndikim pozitiv në rritjen e transparencës, legjitimitetit dhe përgjegjshmërisë në procesin vendimmarrës.
- Studimet e rasteve të politikave publike të ndryshme mund të demonstrojnë se politikat publike që janë hartuar dhe zbatuar duke u konsultuar me shoqërinë civile dhe ekspertë kanë pasur një ndikim pozitiv në rritjen e transparencës në procesin vendimmarrës.

1.4. Variablat

Hipoteza 1:

- Variabla e pavarur: Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje.
- Variablat e varura: Ndryshimi në politikat publike; Ngritja e ndërgjegjësimit publik për çështje të rëndësishme shoqërore; rritja e besimit të qytetarëve në demokracinë e vendit.

Hipoteza 2:

- Variabla e pavarur: Avancimi i demokracisë në Republikën e Kosovës.
- Variablat e varura: Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje, bashkëpunimi i strukturuar me ekspertët e fushave të ndryshme në avancimin e planifikimit, draftimit dhe implementimit të politikave publike.

1.5. Konceptet themelore

Shoqëria civile është një koncept i cili lidhet me organizatat joqeveritare të cilat janë themelore për zhvillimin dhe rritjen e demokracisë. Në fushën e studimit të politikës publike, shoqëria civile konsiderohet si një grup i organizatave dhe individëve të cilët kanë interes për një çështje specifike, dhe përpiqen të ndikojnë në vendimmarrjen publike në lidhje me atë çështje.

Marrëdhëniet midis shoqërisë civile dhe procesit vendimmarrës janë shumë të rëndësishme. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin vendimmarrës mund të ndikojë në zgjidhjen e problemeve publike në mënyrë më efektive dhe transparente. Sipas Harris dhe Jones organizatat e shoqërisë civile mund të kenë një rol kritik në përfshirjen e publikut në procesin vendimmarrës. Në këtë kontekst, organizatat e shoqërisë civile mund të ofrojnë informacion dhe ekspertizë për procesin vendimmarrës, si dhe të ndikojnë në opinionin publik në lidhje me një çështje të caktuar (Harris, 2018, pp. 55-72).

Sipas analizës së Abers (1998), shoqëria civile është në gjendje të ndikojë në procesin vendimmarrës në mënyra të ndryshme, duke përfshirë lobimin për ndryshime ligjore dhe politike, organizimin e demonstratave dhe fushatave të ndryshme, monitorimin e veprimtarisë së institucioneve publike, si dhe ndërmarrjen e veprimeve ligjore nëse konsiderohet e nevojshme (Abers, 1998, pp. 511-537). Në këtë kontekst, rasti i parë i studimit që ndërlidhet pikërisht me këto ndryshime i fokusuar në rolin e pjesëmarrjes publike në ndryshimet politike në vendet post jugosllave (Kosovë dhe Kroaci) synon të analizojë në mënyrë të hollësishme rëndësinë e pjesëmarrjes në këtë kontekst, shtjelluar në kapitullin e pestë të rasteve të studimit.

Përfshirja e grupit të marginalizuar: në rrafshin e marrëdhënieve midis shoqërisë civile dhe procesit vendimmarrës, një element i rëndësishëm është përfshirja e grupit të marginalizuar. Organizatat e shoqërisë civile mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përfshirjen e grupit të marginalizuar në procesin vendimmarrës dhe në adresimin e nevojave të tyre. Sipas Fung dhe Wright (2001), përfshirja e grupit të marginalizuar në

procesin vendimmarrës mund të ndihmojë në rritjen e legjitimitetit dhe efektivitetit të vendimeve të marra (Fung, 2001, pp. 5-41). Në këtë kontekst, është rëndësishme që organizatat e shoqërisë civile të kenë një rol aktiv në procesin vendimmarrës dhe të kenë një dialog të hapur dhe konstruktiv me institucionet publike. Siç vë në dukje Abers (1998), në rastet kur organizatat e shoqërisë civile nuk përfshihen në procesin vendimmarrës, ato mund të ndjejnë se nuk janë të dëgjura dhe kjo mund të çojë në humbje të besimit të publikut në institucionet publike.

Organizatat e shoqërisë civile duhet të kenë një rol aktiv në përfshirjen e publikut në procesin vendimmarrës dhe në adresimin e nevojave të grupit të marginalizuar. Kjo mund të ndihmojë në rritjen e legjitimitetit dhe efektivitetit të vendimeve të marra dhe në rritjen e besimit të publikut në institucionet publike.

Bashkëpunimi me ekspertët e fushave të ndryshme në avancimin e politikave publike është një praktikë e vlefshme në nivel global. Ekspertët kanë një rol kyç në përgatitjen dhe zbatimin e politikave publike, pasi ata mund të japin një perspektivë të ndryshme dhe të jenë në gjendje të vlerësojnë ndikimin e mundshëm të një politike të caktuar. Kjo vlen sidomos për politikat komplekse, siç janë ato që lidhen me shëndetësinë publike, mjedisin dhe ekonominë. Libri "The Political Uses of Expert Knowledge: Immigration Policy and Social Research" nga Christina Boswell heton përdorimin e ekspertizës në sferën politike. Boswell thekson se njohuria eksperte shpesh manipulohet për të mbështetur qëllimet politike ekzistuese, në vend të atij që të drejtojë ose të informojë vendimet në një mënyrë objektive dhe të paanshme. Ajo analizon se si ekspertiza mund të përdoret si një vegël për të arritur objektivat politike, duke sfiduar idenë e zakonshme që ka një lidhje të qartë dhe të thjeshtë mes hulumtimit shkencor dhe politikave. Duke u fokusuar në një analizë të detajuar, Boswell zbulon kompleksitetin e marrëdhënies mes ekspertëve dhe vendimmarrësve politikë, duke treguar se si njohuria eksperte mund të jetë njëkohësisht e dobishme dhe jo e dobishme në formimin e politikave. Ky studim ofron një kontribut vital për të kuptuar rolin e ekspertizës në qeverisjen moderne, duke sjellë një perspektivë

të pasur mbi mënyrën se si ekspertiza mund të shprehë, të ndikojë, dhe ndonjëherë edhe të deformojë politikat dhe praktikat qeveritare (Boswell, 2009, pp. 233-251).

Përveç bashkëpunimit me ekspertët, përfshirja e komuniteteve pakicë në vendimmarrjen e politikave publike është gjithashtu një praktikë e rëndësishme. Filozofi politik Will Kymlicka trajton çështjen e të drejtave të pakicave dhe përfshirjes së tyre në politikëbërje brenda një kuadri liberal-demokratik. Ai argumenton për një model të qytetarisë multikulturore, ku të drejtat e grupeve të pakicave janë të mbrojtura dhe të promovuar, në mënyrë që ato të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në jetën politike (Kymlicka, 1996, pp. 255-278). Gjithashtu, përfshirja e komuniteteve të ndryshme mund të ndihmojë në zbulimin e nevojave dhe kërkesave të tyre, si dhe të sigurojë një përgjigje më të mirë ndaj sfidave dhe nevojave të tyre.

Në një kohë kur besimi në institucionet publike po rëndon në shumë vende, bashkëpunimi me ekspertë dhe përfshirja e komuniteteve të ndryshme mund të ndihmojnë në rikthimin e besimit të qytetarëve në procesin vendimmarrës dhe në sigurimin e implementimit të politikave që janë të efektshme dhe i përgjigjen nevojave të tyre.

Përfshirja e publikut në proceset e politikave shpesh përshkruhet si 'angazhim publik' ose 'pjesëmarrje publike' (Arnout R.H. Fischer, 2014, pp. 332–343). Publiku përfaqëson qartë një palë të rëndësishme të interesit në procesin e politikave. Megjithatë, pozicioni i ekspertëve, niveli i njohurive të tyre dhe vlera e vendosur në gjykimin e tyre nga politikëbërësit ndryshon nga ajo e publikut të gjerë. Si pasojë, shumë procese të përfshirjes së palëve të interesit do të fokusohen tek ekspertët dhe jo tek publiku. Përfshirja e palëve të interesit, e cila përfshin individë të përfshirë profesionalisht ose institucionalisht me çështjen në diskutim, shpesh quhet "përfshirja e ekspertëve" në politikëbërje. Në praktikë, përfshirja e ekspertëve ka qenë shpesh e kufizuar tek akademikët, megjithëse ekspertë të tjerë mund të kenë gjithashtu përvojë të gjerë ose ekspertizë me rëndësi të drejtpërdrejtë për çështjen e politikës në shqyrtim.

Sipas (Creighton, 2005, p. 45), pjesëmarrja publike ka këto përfitime:




Figura 1. Aspekti kohor i vendimit të njëanshëm vs me pjesëmarrje

1.5.1. Përmirësimi i cilësisë së vendimeve

Procesi i konsultimit me publikun shpesh ndihmon në qartësimin e objektivave dhe kërkesave të një projekti apo politike. Publiku mund të detyrojë rimendimin e supozimeve të fshehura që mund të pengojnë të shohin zgjidhjen më efektive. Pjesëmarrja publike shpesh rezulton në marrjen në konsideratë të alternativave të reja, përtej qasjeve të njohura dhe ndoshta të konsumuara nga koha, që janë përdorur në të kaluarën. Publiku shpesh posedon informacione thelbësore për kushtet ekzistuese ose për mënyrën se si duhet të zbatohet një vendim, duke bërë dallimin midis një programi të suksesshëm ose të pasuksesshëm.

1.5.2. Minimizimi i kostos dhe vonesës

Pjesëmarrja e publikut kërkon më shumë kohë, siç tregon Figura 2 (edhe pse nëse pjesëmarrja është pjesë integrale e procesit të vendimmarrjes, nuk merr aq shumë kohë sa mund të mendohet). Vendimet e njëanshme janë gjithmonë më të shpejta për t'u marrë, por shpesh janë shumë të shtrenjta për t'u zbatuar. Shpesh ka aq shumë rezistencë

sa që ato nuk zbatohen fare. Efikasiteti i marrjes së një vendimi nuk mund të matet thjesht në terma të kohës dhe kostove, por gjithashtu duhet marrë parasysh çdo vonesë ose kosto të krijuar nga mënyra se si është marrë vendimi (Creighton, 2005, p. 78).

Diskutimi aktual fokusohet në mënyrën se si opinionet dhe ekspertiza e palëve kryesore të interesit mund të përfshihen në mënyrë më efektive në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike (Renn, 2006, pp. 34-43). Këtu, termi 'aktorë' mund të përfshijë individë me ekspertizë në një fushë të caktuar politikash, përfaqësues të grupeve shoqërore me interes në një fushë të prekur nga zhvillimi i politikave ose publikun e gjerë. Termi 'përfshirje e palëve të interesit' përfshin kështu individë ose organizata që perceptojnë se kanë një interes në çështjen e politikës në shqyrtim dhe që mund të ndikohen nga një politikë specifike (Rowe G. &, 2000, pp. 3–29).

Përkufizimi i pasaktë i termave kyçë në fushën e "pjesëmarrjes publike" ka penguar kryerjen e një kërkimi të mirë dhe ka kundërshtuar zhvillimin dhe zbatimin e praktikave efektive të pjesëmarrjes. Përcaktimi i koncepteve kyçe si: komunikimi publik, konsultimi publik dhe pjesëmarrja publike janë kyçe për të kuptuar rolin e ekspertëve në zhvillimin e politikave publike (Rowe G, 2005, pp. 3–29). Këto koncepte janë të diferencuara sipas natyrës dhe rrjedhës së informacionit. Sipas një këndvështrimi të tillë të rrjedhës së informacionit, efektiviteti i një politike mund të konstatohet nga efikasiteti me të cilin informacioni i plotë, përkatës nxirret nga të gjitha burimet e duhura, transferohet (dhe përpunohet) nga të gjithë marrësit e duhur dhe kombinohet për të dhënë një përgjigje agregate/konsensuale.

KAPITULLI II: KONCEPTET THEMELORE DHE LITERATURA

Në këtë kapitull shpjegohen disa koncepte themelore që janë të rëndësishme për të kuptuar temën e disertacionit, si pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin vendimmarrës, politikat publike, dhe ekspertiza e fushave të ndryshme. Pastaj, paraqitet një shqyrtim i literaturës, duke analizuar studimet e mëparshme në lidhje me temën dhe duke vënë në dukje nevojën për një hulumtim të tillë në kontekstin e Kosovës. Në fund të kapitullit 2, paraqitet një sintezë e përgjithshme e koncepteve dhe literaturës, duke vendosur theksin në nevojën e një hulumtimi të hollësishëm dhe të detajuar.

Rishikimi i literaturës i referohet operacionalizimit teorik të koncepteve themelore të temës së hulumtimit: Për të vlerësuar ndikimin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, është thelbësore të përcaktohet se cila është arsyeja që qëndron pas konceptit të pjesëmarrje të publikut. Në teorinë dhe praktikën demokratike, demokracia e drejtpërdrejtë gjithmonë shënon një kontrast themelor me demokracinë përfaqësuese, duke u ofruar qytetarëve mundësi më të mëdha për pjesëmarrje dhe "më shumë demokraci". Si në teori ashtu edhe në praktikë, arsyetimet kryesore për demokracinë e drejtpërdrejtë burojnë nga deficitet në sistemet përfaqësuese dhe nga kufizimet teorike të demokracisë liberale. Kur debati për zgjerimin e pjesëmarrjes demokratike filloi në fund të viteve 1960 dhe në fillim të viteve 1970, shumë kontribute në teorinë e demokracisë pjesëmarrëse nuk e shtjelluan demokracinë direkte si një formë e pjesëmarrjes së zgjeruar (Schiller, 2007, pp. 52-63).

Teoria e demokracisë deliberative: pretendon se vendimet politike duhet të jenë produkt i diskutimit dhe debatit të drejtë dhe të arsyeshëm midis qytetarëve. Në diskutim, qytetarët shkëmbejnë argumente dhe konsiderojnë pretendime të ndryshme që janë krijuar për të siguruar të mirën publike. Përmes dialogut, qytetarët mund të bien dakord se cila procedurë, veprim apo politikë do të prodhojë më së miri të mirën publike. Në vend që të mendojë për vendimet politike si përmbledhjen e preferencave të qytetarëve, demokracia deliberative pretendon se qytetarët duhet të arrijnë në vendime politike përmes arsyes dhe mbledhjes së argumenteve dhe pikëpamjeve konkurruese. Me fjalë të

tjera, preferencat e qytetarëve duhet të formohen nga diskutimi përpara marrjes së vendimeve, sesa nga vetë interesi. Në lidhje me vendimmarrjen e qytetarëve individualë dhe kolektivë, demokracia deliberative zhvendos theksin nga rezultati i vendimit në cilësinë e procesit (Eagan, 2016). Elementi qendror i deliberacionit është diskutimi publik, ku argumenteve u parashtrohet një kërkesë përmbajtjesore e tillë, që nuk është e mjaftueshme të argumentohet nga një perspektivë e ngushtë e interesit individual (Knut Midgard, 2004, p. 177).

Evan Vlachos propozon një model që përqendrohet në nivelet e pjesëmarrjes, në vend të objektivave të pjesëmarrjes. Ai bën një dallim midis ndërgjegjësimit të publikut, përfshirjes së publikut dhe pjesëmarrjes së publikut. "Ndërgjegjësimi publik nënkupton një informacion të njëanshëm dhe paralajmërim për çështjet e komunitetit. Përfshirja e publikut nënkupton komunikim të dyanshëm dhe një mjet për të angazhuar anëtarët e komunitetit në shkëmbimin e informacionit (dialogu). Në fund, pjesëmarrja e publikut është forma më e fortë e ndërveprimit midis autoriteteve, ekspertëve dhe qytetarëve dhe nënkupton më shumë se çdo gjë tjetër me të vërtetë planifikim të përbashkët dhe delegim demokratik të pushtetit dhe udhëheqjes së përbashkët. Vlachos 1993, cituar në (Abreu, 2002, p. 53).

Një çështje që lidhet është dikotomia e përmendur tashmë "Publiku vs Eksperti". Frederick Frankena dokumenton "rolin e dukshëm shoqëror dhe ndikimin politik të ekspertit teknik vullnetar" Frankena 1984 cituar në (Abreu, 2002, p. 53). Në fakt, ka shumë raste kur ky dallim bëhet i parëndësishëm. Përveç argumenteve të Frankena dhe Kennard, qytetarët dhe OJQ-të mund të punësojnë ekspertët e tyre; dhe hyrja në masë eksponenciale në arsim dhe shkencë e rriti mundësinë e gjetjes së ekspertëve të kualifikuar midis qytetarëve individualë në komunitetin e synuar (fizik ose virtual). Sidoqoftë, kjo mbetet një çështje e hapur, për shkak të pabarazive në shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe institucionale, dhe në fushën e projekteve që vlerësohen. Më në fund, James Glass propozon një model që përqendrohet në funksionin e secilit lloj të pjesëmarrjes së publikut. Ai numëron pesë objektiva të pjesëmarrjes së qytetarëve:

shkëmbimi i informacionit, arsimimi, ndërtimi i mbështetjes, shtesa e vendimmarrjes dhe kontributi përfaqësues (Glass, 2007, pp. 180-189).

Megjithatë, shumë autorë rekomandojnë që pjesëmarrja e publikut me ‘ftesë’ nuk guxon të mbetet si ‘opcion’, varet nga preferencat dhe përparësitë personale të politikanëve dhe shërbyesve publikë. Kushtetutat dhe kornizat e tjera legjislative mund ta bëjnë pjesëmarrjen e publikut të detyrueshme. Kjo mund të bëhet përmes një detyrimi të drejtpërdrejtë dhe të shprehur për të promovuar dhe ndjekur pjesëmarrjen dhe gjithashtu të aktivizohet më tej përmes legjislacionit plotësues siç është e drejta e qasjes në informacion (IPAT, 2015, p. 5).

Nga rishikimi i literaturës duket se ka një boshllëk kërkimor për sa i përket studimeve që eksplorojnë pjesëmarrjen e ekspertëve, si niveli më i lartë i përfshirjes së palëve të interesit në politikëbërje. Në të njëjtën kohë, nuk është hetuar në mënyrë shteruese se si pjesëmarrja e palëve të interesit përmirëson transparencën dhe llogaridhënien dhe ndikon në demokraci. Për më tepër, në literaturë sugjerohen disa kritere që duhen ndjekur për pjesëmarrje efektive të palëve të interesit; por nuk është shqyrtuar nëse këto kritere janë relevante për kontekstin e pjesëmarrjes së ekspertëve. Përpjekja jonë kërkimore ka për mision të kontribuojë në plotësimin e këtyre boshllëqeve. Ka rezultuar në objektivat e kërkimit dhe pyetjen kërkimore, që u diskutuan më lart.

2.1. Përkufizimet

Pjesëmarrja e publikut është një proces i cili përbëhet nga një sërë aktiviteteve dhe veprimesh gjatë gjithë jetëgjatësisë së një projekti për të informuar publikun dhe për të marrë të dhëna prej tyre. Pjesëmarrja publike u jep palëve të interesit (ata që kanë një interes në një çështje, si individët, grupet e interesit, komunitetet) mundësinë për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre (EPA U.S. Environmental Protection, 2021).

Publiku përbëhet nga një sërë palësh të interesit që mbajnë një sërë pikëpamjesh dhe shqetësimesh për një çështje. Kur kryen pjesëmarrje domethënëse publike, një agjenci

ose institucion do të mbledhë të dhëna nga një spektër i gjerë interesash të palëve të interesit, duke rezultuar në një gamë të gjerë pikëpamjesh dhe shqetësimesh dhe duke ofruar trajtim të drejtë, përfshirje kuptimplotë dhe përfshirje sociale për të gjithë njerëzit, pavarësisht nga raca, ngjyra, origjina kombëtare, orientimin seksual ose të ardhurat, në lidhje me zhvillimin, zbatimin dhe vendimet e marra përmes procesit të pjesëmarrjes publike.

Në varësi të formës së pjesëmarrjes së kërkuar, pjesëmarrja publike përdor një sërë mjetesh dhe teknikash për të informuar publikun, për të gjeneruar kontribut publik dhe, në disa raste, për të krijuar konsensus dhe për të arritur marrëveshje. Përfshirja e palëve të interesit në vendimmarrje përbën një pjesë thelbësore të qasjes së politikave të integruara. Përfshirja e këtyre palëve të interesit në vendimmarrje pritet të zgjidhë problemet e zbatimit të vendimeve të politikave, të rrisë pranimin social të masave të politikave, të përmbushë idealet demokratike dhe të rrisë transparencën dhe besimin në politika dhe rregullore (Rowe G. &, 2000, pp. 3–29). Në nivelin më të lartë të pjesëmarrjes dhe ndikimit të publikut, konsiston në partneritetin me publikun (siç është paraqitur në figurën e mëposhtme), në zbatimin e vendimeve të ndërmarra së bashku (British Columbia, 2008).




Figura 2. Nivelet e pjesëmarrjes publike, Burimi British Columbia 2008

Një tjetër rezultat madhor i pjesëmarrjes së qëndrueshme të palëve të interesit në vendime dhe zbatimi i tyre është zhvillimi i kapaciteteve për menaxhimin e problemeve

të vështira sociale. Ky kapacitet përfshin përmirësimin e marrëdhënieve dhe besimit ndërmjet vendimmarrësve dhe publikut, si dhe ndërmjet vetë aktorëve të ndryshëm. Gjithashtu, kur bëhet mirë, pjesëmarrja publike ndihmon për t'u mësuar palëve të interesit mënyra kuptimplota dhe bashkëpunuese për t'iu qasur njëri-tjetrit, për të menaxhuar vendime të vështira dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Palët e interesit mësojnë të vlerësojnë pozicionet e njëri-tjetrit, duke mësuar fillimisht për vlerat dhe interesat e njëri-tjetrit.




Figura 3. Format e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në varësi të potencialit për ndikim publik në një vendim

Pasi palët e interesit të ftohen në procesin e vendimmarrjes, bëhet më e vështirë për ta që thjesht të qëndrojnë në anën dhe të thonë "jo". Si pjesëmarrës në proceset e mira të vendimmarrjes, të gjithë palët e interesit duhet të kuptojnë të gjitha anët e një çështjeje,

të peshojnë të mirat dhe të këqijat dhe të marrin vendime më të menduara. Palët e interesit dhe komunitetet në përgjithësi nuk e arrijnë këtë vetë.

Problemet komplekse publike ndahen dhe shpërndahen nëpër institucione dhe fusha të shumta (Kettl, 2002, pp. 160-161). Përgjigjet formale të qeverisë ndaj këtyre nevojave specifike publike trajtohen përmes politikave publike. Politika mund të fokusohet në vendndodhje, procese ose produkte të ndryshme gjeografike, ose mund të specifikojë se si përcaktohen, vëzhgohen dhe vlerësohen disa rezultate. Për më tepër, individët, familjet, komunitetet, industria dhe vetë qeveria janë të gjitha të prekura nga zgjedhjet e politikave dhe të gjithë ata kanë interesa si në procesin e vendimmarrjes, ashtu edhe në vendimet përfundimtare (Bryson J. M., 2003, pp. 21-53).

Në dritën e problemeve sociale në dukje të pazgjidhshme dhe komplekse, administratorët publikë janë zhvendosur drejt aktiviteteve të qeverisjes që lejojnë qytetarët dhe palët e interesit të kenë një përfshirje më të thellë në procesin e krijimit të politikave dhe në punën e qeverisë (Bingham Lisa Blomgren, 2005, p. 554). Modelet e qeverisjes të cilat fokusohen në aktivitete thuajse legislative si buxhetimi me pjesëmarrje, juritë qytetare, grupet e fokusit, tryezat e rrumbullakëta ose takimet e qytetit (Bingham Lisa Blomgren, 2005, p. 555), krijojnë mundësi për qytetarët dhe palët e interesit që të parashikojnë rritjen e tyre në të ardhmen, të qartësojnë preferencat e tyre të politikave, të angazhohen në dialog mbi zgjedhjet e politikave ose të sjellin grupe të ndryshme në konsensus mbi propozimet. Modelet ndryshojnë në bazë të shkallës së përfshirjes nga popullata e përgjithshme, nëse ato ndodhin në hapësira publike, nëse palët e interesit janë aktualisht të fuqizuara dhe nëse ato çojnë në rezultate të prekshme (Bingham Lisa Blomgren, 2005, p. 556).

2.2. Pjesëmarrja e ekspertëve dhe grupeve të interesit në planifikim

Artikujt e gazetave, raportet dhe përmbledhjet e qeverisë nuk janë burimet e vetme të kërkimit që përdoren në zhvillimin e politikave. Politikëbërësit shpesh preferojnë konsultimet ballë për ballë me studiuesit, ose 'ekspertët', në vend të leximit të kërkimit (Ritter, 2009, pp. 70-75), veçanërisht kur politika duhet të formulohet nën kufizime të

ngushta kohore. Politikëbërësit përfitojnë gjithashtu nga studiuesit që shërbejnë në komitetet qeveritare dhe grupet këshillimore, duke kontribuar në forumet publike dhe të palëve të interesit, duke kryer kërkime në partneritet me politikëbërësit dhe duke shpërndarë kërkime përkatëse përmes rrjeteve të politikave të zhvilluara strategjike (Kothari, MacLean, & Edwards, 2009, pp. 33-51).

Marrëdhëniet e mira ndërpersonale ndërmjet studiuesve/ekspertëve dhe politikëbërësve identifikohen vazhdimisht si lehtësuesit kryesorë të zhvillimit të politikave të bazuara në kërkime, megjithatë pak dihet se si krijohen këto marrëdhënie ose për mënyrat sesi politikëbërësit identifikojnë kërkuesit të cilët ata i ftojnë në 'rrethi i brendshëm' i zhvillimit të politikave. Ne e dimë se kërkesat e politikëbërësve për kërkime ndryshojnë sipas llojit të politikës mbi të cilën ata punojnë dhe fazës së zhvillimit të saj. Njohja nëse politikëbërësit përdorin të njëjtat kritere për të përzgjedhur palët (ekspertët, etj.) për dialogun në përcaktim të agjendës siç bëjnë për mbështetjen e ndërtimit të konsensusit të fokusuar në legjislacion ose për vlerësimin e ndërhyrjeve, do t'u mundësonte studiuesve të përdorin ekspertizën e tyre në mënyrë më efektive për të ndjekur qëllimet e tyre për të ndikuar në politika.

2.3. Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes

Demokracia pjesëmarrëse është formë e ndarjes dhe ushtrimit të pushtetit, e bazuar në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në marrjen e vendimit politik. Synimi i pjesëmarrjes qytetare është *“të demokratizohet demokracia”* është shfaqur për herë të parë në vitet 1960, koncepti politik i demokracisë pjesëmarrëse është zhvilluar në kontekstin e shumë pikëpyetjeve të lindura mbi kufijtë e demokracisë përfaqësuese në kushtet e një sistemi mazhoritar zgjedhor, të profesionalizmit të politikës dhe të rritjes së rolit të ekspertëve.

Demokracia pjesëmarrëse frymëzohet gjithashtu edhe prej zhvillimeve të reja teknologjike dhe shkencore. Vendimmarrësit duhet të kenë, në rastin e gabimit, mundësinë e korrigjimit të vendimeve publike dhe të rikonsiderimit të opsioneve që ata nuk kishin konsideruar më parë. Për të evituar të papranueshmen, duhet hequr dorë nga kuadri i vendimeve tradicionale të prera dhe kategorike, duke i zëvendësuar ato me akte

të matshme, të pasuruara edhe prej kontributeve të atyre që nuk kanë njohuritë e duhura, kjo kërkon rivitalizimin e demokracisë (Hood, 2007, pp. 1-23).

Rëndësia e praktikës së planifikimit për llojin dhe natyrën e pjesëmarrjes publike nuk është njohur gjerësisht në literaturë. Nuk është bërë më parë asnjë ekzaminim sistematik i lidhjes ndërmjet epistemologjisë së planifikimit dhe pjesëmarrjes publike. Megjithëse ka pasur njohje se pjesëmarrja publike zakonisht shërben për qëllime të qarta menaxheriale, nuk është njohur shpesh se mundësitë për pjesëmarrje mund të ndryshojnë sipas koncepteve të veçanta të planifikimit.

Në vitin 1969 Sherry Arnstajn (Arnstein) krijoi idenë e “Shkallëve të pjesëmarrjes”, e cila funksionon në vazhdimësi, duke filluar nga më të shfrytëzuarit dhe të pafuqishmit e deri te ata që më së shumti kanë kontroll dhe fuqi. Në shkallën e Arnstajnit propozohen tetë ‘nivele’ të pjesëmarrjes, në kuadër të tri kategorive të gjëra (qytetaria pasive, krijimi i imazhit të qytetarisë aktive dhe qytetaria aktive) (Forrester, 2011, p. 27).

Shkallët e pjesëmarrjes të Arnstein janë një model i ndarjes së niveleve të pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës. Këto shkalla janë:




Figura 4. Shkallët e pjesëmarrjes. Burimi: Sherry Arnstajn (Arnstein)

Manipulimi: Në këtë shkallë, publiku është pjesë e procesit vendimmarrës vetëm në formën e manipulimit. Kjo do të thotë se ata nuk kanë asnjë formë të kontrollit mbi procesin vendimmarrës dhe nuk kanë mundësi për të ndikuar në vendimet e marra.

Informimi: Në këtë shkallë, publiku merr informacion rreth procesit vendimmarrës dhe vendimeve të marra. Megjithatë, ata nuk kanë mundësi për të dhënë kontribut në proces dhe nuk kanë ndonjë formë të kontrollit mbi vendimet e marra.

Konsultimi: Në këtë shkallë, publiku është konsultuar dhe i është kërkuar mendimi i tyre. Megjithatë, ata nuk kanë kontroll në vendimmarrjen dhe mendimet e tyre mund të injorohen.

Bashkëpunimi: Në këtë shkallë, publiku është i përfshirë në procesin vendimmarrës dhe konsultohet në mënyrë të rregullt. Ata kanë mundësinë për të ndikuar në vendimet e marra dhe kanë një formë të kontrollit mbi procesin.

Partneriteti: Në këtë shkallë, publiku është një partner i barabartë në procesin vendimmarrës. Ata kanë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimet e marra dhe kanë një formë të kontrollit mbi procesin.

Delegimi i fuqisë: Në këtë shkallë, publiku ka fuqi të plotë vendimmarrëse dhe fuqinë e deleguar nga entiteti vendimmarrës. Ata kanë një formë të kontrollit të drejtpërdrejtë mbi procesin dhe vendimet e marra.

Kontrolli i plotë: Në këtë shkallë, publiku ka kontroll të plotë mbi procesin vendimmarrës dhe vendimet e marra.

Autonominë: Në këtë shkallë, publiku është autonom dhe i pavarur në procesin vendimmarrës dhe vendimet e marra. Ata kanë fuqi absolute dhe kontroll të plotë mbi procesin dhe vendimet e marra.

Nevoja për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e planifikimit është njohur prej kohësh. Një përfshirje e tillë është thelbësore si për qytetarinë e barabartë demokratike, ashtu

edhe për ndërhyrjet efektive që i përgjigjen realiteteve të përditshme. Planifikimi dhe zhvillimi me pjesëmarrje është veçanërisht i rëndësishëm në komunitetin në nivel lokal.

Suksesi i një programi të pjesëmarrjes së publikut përcaktohet kryesisht nga fakti se sa në mënyrë të plotë dhe të menduar është planifikuar. Takimet dhe ngjarjet e suksesshme përcaktohen nga shkalla në të cilën një agjenci angazhohet në mënyrë efektive dhe përgatitet për të gjithë procesin, veçanërisht krijimin dhe sigurimin e informacionit të nevojshëm nga palët e interesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve efektive me palët kryesore të interesit (EPA U.S. Environmental Protection, 2021).

Ekzistojnë pesë hapa kyçë në procesin e planifikimit (paraqitur në figurën 5), disa nga to do të diskutohen më poshtë:




Figura 5. Hapa kyçë në procesin e planifikimit

2.4. Organizimi për pjesëmarrje

Siç edhe shtjellohet tek Christen dhe Inzeno (Christens, 2014, p. 4635), organizimi është një term që përfshin një shumëllojshmëri procesesh në të cilat njerëzit e zakonshëm (p.sh., vullnetarët, banorët e lagjes dhe anëtarë të institucioneve lokale, sociale ose

fetare) të mbajë një përpjekje afatgjatë bashkëpunuese për të ndërtuar fuqinë dhe kapacitetin për të adresuar çështjet sociale si shqetësim i përbashkët. Termat "projekt", "iniciativë" dhe "komunitet" përdoren ndonjëherë për t'iu referuar organizimeve specifike të komunitetit lokal grupe, ndërsa më shpesh i përdorur është termi "fushata" që i referohet veprimeve të një nisme organizative të caktuar për një çështje specifike. Qëllimi i të gjitha këtyre aktivitetet është për të ndërtuar fuqinë bazë lokale për të adresuar çështjet lokale në përmirësimin e cilësisë së jetës.

2.5. Identifikimi dhe njohja e palëve të interesit

Termi "palë e interesit" përkufizohet ndryshe nga disiplina të ndryshme. Shumica e përkufizimeve përmendin kategori të ngjashme të palëve të interesit si kompanitë dhe punonjësit e tyre ose subjektet e jashtme. Në sektorin publik, përkufizimi i palëve të interesit thekson kategoritë e qytetarëve të përcaktuar nga karakteristikat demografike, fazat e jetës, grupet e interesit ose kufijtë organizativë (Bingham Lisa Blomgren, 2005, p. 556). Palët e interesit mund të jenë të brendshme të qeverisë (p.sh., organizatat qeveritare përgjegjëse për zbatimin e politikave) dhe të jashtme (p.sh., industrinë, komunitetet ose individët që do të preken nga veprimet ose rregullat e qeverisë) (Helbig, 2015).

Identifikimi dhe analiza e palëve të interesit është një fazë e parë e rëndësishme në proceset e angazhimit të palëve të interesit (Freeman, 2001, p. 7). Analiza zakonisht përfshin pesë hapa identifikimi i palëve të interesit (Kennon, 2009, pp. 11-13), kuptimi dhe menaxhimi i palëve të interesit, vendosja e qëllimeve, identifikimi i kostove të angazhimit dhe vlerësimi dhe rishikimi i analizës. Nëpërmjet këtyre hapave të ndryshëm, një analizë ndihmon për të dalluar palët e interesit nga palët jo të interesit dhe për të identifikuar mënyrat se si palët e interesit duhet të angazhohen gjatë pjesëve të ndryshme të ciklit të politikave.

Ka shumë mënyra për të mbledhur të dhëna për një analizë të palëve të interesit. Burimet dytësore të informacionit si faqet e internetit, gazetatat, të dhënat publike, publikimet

organizative, raportet e proceseve të tjera vendimmarrëse dhe një mori materialesh të tjera të shkruara mund të ofrojnë informacione të shumta rreth grupeve dhe individëve.

Tabela 1. Teknikat e përbashkëta të pjesëmarrjes së palëve të interesit përfshirë grupet e ekspertëve

Metoda	Përshkrimi
Grupi këshillues/ task force	Një grup i vogël njerëzish që përfaqësojnë interesa të ndryshme që krijohet për të këshilluar një agjenci mbi programet ose veprimet. Grupet këshillimore mund të jenë marrëveshje shumëvjeçare ose të pacaktuara, ndërsa grupet e punës zakonisht kryejnë një detyrë të vetme dhe më pas shpërndahen.
Charrette (palët e interesit në një projekt përpiqen të zgjidhin konfliktet dhe të hartojnë zgjidhjet)	Përpyekje intensive, shumë-ditore për të hartuar diçka ose për të zgjidhur një problem. Ka versione të shumta të charrette, shumica e të cilave përfshijnë një ekip projektimi që përpiqet të përkthejë të dhënat publike në një formë që mund të zbatohet, për shembull, një politikë e re, rregullore zonash ose dizajne urbanistike.
Udhëtim në terren	Udhëtimi në një vend specifik të organizuar në mënyrë që pjesëmarrësit të mund t'i përshtatin imazhet e tyre mendore me kushtet reale, në terren. Pjesëmarrësve mund t'u kërkohet të shprehin reagimet e tyre verbaliste ose me shkrim.
Fokus grup	Një grup i vogël diskutimi i udhëhequr nga një lehtësues i cili nxjerr të dhëna të thelluara nga palët e interesit për pyetje specifike. Normalisht, mbahen disa fokus grupe dhe pjesëmarrësit mund të zgjidhen në mënyrë të rastësishme ose të përafrojnë një nëngrup të komunitetit.

Linja telefonike	Numër telefonik i reklamuar gjerësisht që i drejton telefonuesit te dikush në një agjenci që mund t'u përgjigjet pyetjeve të telefonuesit dhe të mbledhë të dhëna.
Internet	Dialog midis agjencive dhe palëve të interesit duke përdorur teknologjinë e internetit si dhomat e bisedave, tabelat e buletinit në internet, e-mail dhe konferencat në internet.
Intervistë	Ndërveprimi ballë për ballë ose telefonik me palët e interesit kryhet nga agjencia ose nga një përfaqësues i palës së tretë.
Takimi i grupit të madh/ grupit të vogël	Pas një prezantimi hapës, grupi ndahet në grupe më të vogla për të diskutuar një çështje ose për të përfunduar një detyrë specifike. Përmbledhjet e diskutimeve në grupe të vogla dhe një periudhë e hapur komentesh mund të pasojnë.
Shtëpia e hapur	Ngjarje në të cilën publiku është i ftuar të paraqitet në çdo kohë gjatë një periudhe të shpallur. Ngjarja përfshin kabina ose stacione me personel për tema specifike dhe mund t'i paraprijë një takimi publik.
Sondazhe	Lista e pyetjeve me shkrim ose me gojë për të kërkuar përshtypjet e komunitetit rreth çështjeve në një moment të caktuar kohor. Sondazhet mund të administrohen personalisht, ose nëpërmjet telefonit ose internetit.
Dëgjim publik	Takimi formal dhe i vetëm ku palët e interesit paraqesin deklarata dhe qëndrime zyrtare dhe ato ide regjistrohen në një procesverbal formal për t'ia dorëzuar agjencisë.
Takimi publik	Një takim i madh me komente publike ku pjesëmarrësit qëndrojnë së bashku gjatë gjithë takimit dhe bëjnë komente për të gjithë audiencën. Takimet publike janë më pak formale sesa një dëgjim publik. Takimi publik mund të

	përdoret gjithashtu si një term i përgjithshëm për të përshkruar shumë nga takimet e përshkruara në këtë tabelë.
Referendumi	Një votim i drejtpërdrejtë nga i gjithë elektorati për mbështetjen e tij të propozimeve ose drejtimeve specifike të veprimit. Referendumet duhet të paraprihen nga pjesëmarrja e publikut në mënyrë që opsionet para votuesve të jenë të besueshme.
Tërheqje	Një takim i përqendruar por jozyrtar larg mjedisit tipik të punës që thekson ndërveprimin social si dhe diskutimin e çështjeve.
Takimi i qytetit	Një dëgjim publik më pak formal ku të gjithë palët e interesit kanë mundësinë të flasin dhe mund të votojnë për një çështje.
Punëtori	Mbledhja e vogël e palëve të interesit, zakonisht më pak se 25 persona, e krijuar për të përfunduar një detyrë specifike në një periudhë të shkurtër kohe.

(Burimi: adaptuar nga (Creighton, 2005)

Vëmendja ndaj palëve të interesit është një pjesë thelbësore e përgjigjes ndaj kontekstit. Literatura është mjaft e qartë se palët e duhura të interesit duhet të përfshihen në mënyrat e duhura në një proces pjesëmarrjeje bazuar në kontekstin, detyrën e përgjithshme ose qëllimin e projektit dhe qëllimet e procesit të pjesëmarrjes. Natyrisht, kush janë palët e duhura të interesit dhe si t'i përfshijnë ata janë pyetje që projektuesit e procesit duhet t'u përgjigjen (Bryson J. &., 2013, pp. 23-34). Përfshirja e një game të gjerë pjesëmarrësish në proceset e planifikimit mund të nxisë ndarjen e perspektivave ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm dhe të ndihmojë në mbledhjen e informacionit nga të gjithë pjesëmarrësit në lidhje me qëllimet dhe objektivat e tyre në proces. Literatura mbi bashkëpunimin tregon se kur kërkohen zgjidhje të qëndrueshme dhe konsensusi

është metoda kryesore e vendimmarrjes, është e rëndësishme të përfshihet gama e plotë e palëve të interesit (Monnikhof, 2003, pp. 315-344).

2.6. Qasjet e reja në pjesëmarrjen e publikut

Demokracia është një punë në progres. Kuptimi ynë se çfarë do të thotë demokraci ka evoluar me kalimin e kohës. Nuk ka asnjë formë të vetme të demokracisë, siç e ilustron shumëllojshmëria e formave të qeverisjes në vendet demokratike. Sfida është gjithmonë realizimi i demokracisë në praktikë. Një tjetër eksperiment në demokraci është duke u zhvilluar sot. Gjithnjë e më shumë, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen qeveritare konsiderohet pjesë e vetë përkufizimit të demokracisë. Pjesëmarrja e publikut tani është një kërkesë ose parakusht ligjor për vendimmarrjen qeveritare në pjesën më të madhe të botës perëndimore.

Përfshirja e një sërë këndvështrimesh në vendimmarrje përmes pjesëmarrjes publike shpesh nxit shqetësimet nëse mund të arrihen rezultate thelbësore racionale dhe të legjitimuara. Shumë shqetësime përqendrohen në natyrën dhe vendin e duhur të ekspertizës në qeverisje. Politikëbërja zakonisht privilegjon atë që (Yanow, 2004, p. 11) e karakterizon si njohuri eksperte (d.m.th., e certifikuar, e specializuar, e dekontekstualizuar, e kodifikuar) mbi njohuritë e zakonshme (d.m.th. njohuri lokale specifike, eksperimentale, të bazuara në kontekst.




Figura 6. Fazat e planifikimit dhe pjesëmarrjes së ekspertëve në kohë (Burimi: modifikuar nga (Creighton, 2005)

Në një këndvështrim, dhënia e ndikimit të publikut mbi zgjedhjet që u lihen tradicionalisht atyre me ekspertizë të specializuar mund të prodhojë rezultate të dobëta. Për shembull, përfshirja e banorëve në vendosjen se si të trajtohet një problem i mbingarkesës së trafikut mund t'i japë vlerë opsioneve që (Quick K. &, 2016, p. 6) inxhinierët do ta konsideronin të pasigurt, shumë të kushtueshme ose teknikisht të pamundur. Ndryshime të tjera të bazuara në kontekst që janë të rëndësishme për sa mirë do të funksionojë një qasje e caktuar ndaj pjesëmarrjes përfshijnë: centralizimin relativ dhe autoritetin e njësive qeveritare; shpërndarja e pushtetit ndërmjet palëve të interesit; historia e veçantë dhe lidhjet e njerëzve me një vend të caktuar; cilat terma argumentimi janë bindëse (p.sh., barazia, qëndrueshmëria mjedisore, pa taksa të reja); (Quick K. S., 2016, p. 7) pritshmërinë e qeverisë (p.sh., niveli i besimit në kapacitetin dhe kompetencën e qeverisë, korrupsioni, vlerat për atë që është puna e qeverisë ose subjekteve të tjera); çfarë rrugësh të tjera për ndikim janë të disponueshme, konkurrenca midis prioriteteve dhe dinamika të tjera të shoqërisë civile.

2.7. Bashkërendimi i politikave publike dhe përfshirjes së shoqërisë civile dhe ekspertëve

Politikat publike janë procese të ndryshme të cilat përfshijnë krijimin, vlerësimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në nivele të ndryshme të qeverisjes. Ata përcaktojnë mënyrat e ndërveprimit midis qeverisë dhe shoqërisë civile, dhe janë thelbësore në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të barabartë.

Politikat publike mund të ndryshojnë nga politikat sociale, ekonomike, të mjedisit dhe të tjera. Ato gjithashtu mund të ndikojnë në shumë nivele të qeverisjes, nga vendimmarrja lokale deri në vendimmarrjen kombëtare dhe ndërkombëtare. Politikat publike, në kuptimin e përgjithshëm, shihen si vendime formale e legale të instancave qeveritare. Politikat e tilla janë të lidhura mes synimeve, veprimeve dhe rezultateve (Heywood, 2008).

Sipas Bardach, procesi i krijimit të politikave publike është një proces i cili ndjek një sërë hapa, siç janë identifikimi i problemës, analiza e politikave të tashme, zhvillimi i opsioneve politike, zbatimi dhe monitorimi i politikave (Bardach, 2016). Për më tepër, ndikimi i shoqërisë civile në krijimin e politikave publike është thelbësor. Kjo është e vërtetë sidomos në kontekstin e demokracive të reja dhe të rëndësishme në përfshirjen e të gjithë aktorëve të interesuar dhe të përfshirë në procesin vendimmarrës. Në këtë kontekst, ekspertiza e fushave të ndryshme dhe pjesëmarrja e komuniteteve pakicë në procesin vendimmarrës janë thelbësore.

Sipas Bardach (2012), ekspertiza është një pjesë e rëndësishme e procesit të krijimit të politikave publike. Ekspertët e fushave të ndryshme kanë njohuri dhe aftësi të ndryshme që mund të ndihmojnë në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në shoqëri. Ata janë në gjendje të ofrojnë rekomandime të bazuar në fakte dhe të ndihmojnë në hartimin e politikave efektive dhe efikase. Për më tepër, pjesëmarrja e komuniteteve pakicë në procesin vendimmarrës është e rëndësishme për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë. Pjesëmarrja e tyre mund të sigurojë që politikat publike të reflektojnë interesat dhe nevojat e të gjithë komuniteteve në shoqëri, dhe të ndihmojnë në ndërtimin e një shoqërie të integruar dhe të bashkuar.

Nëse politikat publike nuk janë të dizajnuara dhe të zbatuara me kujdes, ato mund të kenë pasoja negative për shoqërinë dhe mund të ndikojnë në kualitetin e jetës së qytetarëve. Sipas Bardach, politikat publike duhet të jenë të orientuara nga objektivat dhe synimet për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve publike. Ata duhet të jenë të bazuara në prova dhe të mbështetura nga hulumtimi shkencor, duke marrë parasysh koston dhe efektivitetin e tyre.

Në këtë proces, ekspertiza e fushave të ndryshme është e rëndësishme për të garantuar që politikat publike janë të bazuara në dije dhe njohuri të specializuara. Një studim i bërë nga Nielsen et al. (2017) argumenton se përdorimi i ekspertizës së fushave të ndryshme është i rëndësishëm për të zbatuar politika publike në mënyrë efektive dhe efikase. Ata sugjerojnë që ekspertët e fushave të ndryshme duhet të jenë të përfshirë në të gjithë

procesin e zhvillimit dhe zbatimit të politikave publike, duke përfshirë edhe fazën e vlerësimit dhe monitorimit (R Nielsen, 2017, pp. 569-584). Autorët argumentojnë se përdorimi i ekspertizës së fushave të ndryshme është i rëndësishëm për të siguruar që politikat publike të jenë të bazuara në dijen dhe të jenë të efektshme dhe efikase në adresimin e sfidave aktuale. Ata vlerësojnë se, megjithëse është e rëndësishme që ekspertët të jenë të përfshirë në të gjithë fazat e procesit të politikave publike, duke përfshirë fazën e vlerësimit dhe monitorimit, vështirësia është në sigurimin e një koordinimi të mirë midis ekspertëve të ndryshëm dhe përfaqësuesve të politikës.

Për arsyet e tilla, autorët sugjerojnë që institucionet publike duhet të përdorin metodat e reja dhe inovative për të siguruar që ekspertët të jenë të përfshirë në procesin e politikave publike në mënyrë të përshtatshme dhe efikase. Studimi gjithashtu vë në dukje nevojën për të zvogëluar ndarjen midis sektorëve dhe organizatave për të siguruar që ekspertët të jenë të përfshirë në mënyrë të plotë në procesin e politikave publike.

Përveç ekspertizës së fushave të ndryshme, pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin vendimmarrës është e rëndësishme për garantimin e transparencës dhe legjitimitetit të politikave publike. Kjo është në përputhje me teorinë e pjesëmarrjes së qytetarëve të Shereshevsky (1970), e cila sugjeron se pjesëmarrja aktive e qytetarëve në procesin vendimmarrës është e rëndësishme për garantimin e demokracisë dhe legjitimitetit të politikave publike (Shereshevsky, 1970, p. 312).

Në përfundim, politikat publike duhet të jenë të bazuara në dije dhe prova, duke marrë parasysh koston dhe efektivitetin e tyre. Ekspertiza e fushave të ndryshme dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile janë të rëndësishme për të garantuar që politikat publike janë të bazuara në dije dhe janë të përshtatshme për nevojat dhe synimet e qytetarëve.

KAPITULLI III: METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë kapitull trajtohet metodologjia e përdorur në këtë hulumtim, përfshihen detaje rreth metodave të përdorura për të grumbulluar dhe analizuar të dhënat. Përveç kësaj, do të diskutohet rreth përfitimeve dhe kufizimeve të metodologjisë së përdorur. Kapitulli fillon me një përshkrim të metodës së studimit të rasteve dhe intervistave si metodat kryesore të përdorura për grumbullimin e të dhënave. Pastaj, do të diskutohet rreth procesit të zgjedhjes së respondentëve dhe si u kryen intervistat. Në vijim, do të paraqiten detajet rreth analizës së të dhënave dhe si u arritën përfundimet e hulumtimit. Përveç kësaj, kapitulli do të përmbledhë kufizimet e metodologjisë së përdorur dhe si këto kufizime kanë ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e përfundimeve të arritura.

Metodologjia e këtij hulumtimi përfshinë një qasje kualitative dhe induktive. Ky hulumtim përdorë metodën e studimit të rastit dhe analizës së dokumenteve. Për të arritur qëllimet e studimit, janë aplikuar teknikat e intervistimit të thellë, duke përdorur selektimin e rastit. Hulumtimi është kryer në tre faza kryesore: (1) përzgjedhja e pjesëmarrësve, observimi (2) analiza e intervistave dhe dokumenteve, dhe (3) interpretimi i të dhënave.

Faza e parë e përfshin përzgjedhjen e pjesëmarrësve. Në këtë fazë, janë identifikuar palët e interesit në fushat specifike dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë qenë pjesë e proceseve politike në Kosovë. Për të siguruar një selektim të përshtatshëm, është përdorur metoda e selektimit të qëllimshëm.

Faza e dytë përfshin analizën e të dhënave të grumbulluara. Kjo është bërë përmes intervistave me pjesëmarrësit e selektuar dhe analizës së dokumenteve. Intervistat janë realizuar përmes një protokollit të strukturuar, por me hapësira për diskutim dhe shtesë të temave të ndërlidhura. Në këtë fazë, është përdorur analiza e përmbajtjes për të identifikuar temat kryesore dhe trendët e përgjithshme në këtë fushë.

Faza e tretë është fokusuar në interpretimin e të dhënave. Kjo fazë është ekzekutuar duke analizuar të dhënat dhe duke identifikuar trendët kryesore në pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe ekspertëve në politikën në Kosovë. Kjo fazë gjithashtu përmban një analizë të

thellë të ndikimit të pjesëmarrjes së strukturuar të shoqërisë civile dhe ekspertëve në procesin e politikës dhe zhvillimin e demokracisë në Kosovë.

Rezultatet e këtij hulumtimi do të ndihmojnë në përmirësimin e planifikimit dhe implementimit të politikave publike në Kosovë, duke ngritur nivelin e demokratizimit në vend. Gjithashtu, do të ndihmojë në kuptimin e rëndësisë së pjesëmarrjes së strukturuar të shoqërisë civile dhe ekspertëve në politikë.

3.1. Burimet e provave

Studimet e rasteve si shumica e metodave cilësore të kërkimit (Tabela 2) mund të kenë katër funksione kryesore, përkatësisht kontekstuale, eksploruese, vlerësuese dhe gjeneruese. Disa autorë paraqesin kritere parakushte, që do të thotë kritere që duhet të merren parasysh përpara se të takohen realisht me palët e interesit për një diskutim aktiv, duke përfshirë përfaqësimin e palëve të interesit, gatishmërinë e palëve për të bashkëpunuar, përfshirjen e hershme dhe një agjendë të përcaktuar qartë (Rowe G, 2005) të cilat janë bazë e analizimit të dhënave primare për këtë tezë.

Metoda e studimit të rasteve është një metodë cilësore e kërkimit që ndihmon në kuptimin e rasteve të veçanta ose situatave të caktuara duke i analizuar ato në thellësi. Në këtë studim, është përdorur kjo metodë për të kuptuar rëndësinë e pjesëmarrjes së strukturuar të shoqërisë civile dhe ekspertëve në politikë në Kosovë.

Kjo metodë mund të ketë katër funksione kryesore në analizën e një rasti. Funksioni i parë është funksioni kontekstual, i cili synon të kuptojë kontekstin dhe rrethanat që rrethojnë rastin e analizuar. Funksioni i dytë është funksioni eksplorues, i cili synon të kuptojë thellësisht rastin duke i analizuar detajet e tij dhe duke kuptuar ndërveprimet midis faktorëve të ndryshëm. Funksioni i tretë është funksioni vlerësues, i cili synon të vlerësojë përfitimet dhe dëmet e rastit, duke përcaktuar ndryshimet dhe ndikimet që ky rast mund të ketë në kontekstin e kërkimit. Funksioni i katërt është funksioni gjenerues, i cili synon të ndihmojë në zhvillimin e hipotezave dhe modeleve të reja duke analizuar rastin në mënyrë kritike.

Në këtë studim, të dhënat primare do të analizohen duke përdorur metodën e studimit të rasteve dhe duke i aplikuar funksionet e kësaj metode. Në këtë mënyrë, synohet të arrihet një kuptim më i thellë i rëndësisë së pjesëmarrjes së strukturuar në politikëbërje në Kosovë dhe ndikimit të tyre në zhvillimin e demokracisë.

Tabela 2. Kriteret e përfshirjes së palëve të interesit/ekspertëve/ modifikuar nga (Zakharova, 2014)

Parakushtet e kriterëve për pjesëmarrje efektive	Kriteret për procesin pjesëmarrës	Kriteret për rezultatet e pjesëmarrjes
• Përfaqësimi i palëve të interesuara: • Gatishmëria për të bashkëpunuar • Përfshirja e hershme • Axhenda e përcaktuar	• Transparenca • Dizajni i procesit • Lehtësim i pavarur • Vëmendje ndaj asimetrisë së fuqisë • Shqyrtimi • Qasja në informacion	• Kënaqëshmëria e aktorëve • Dëshmia në kontributin në vendimin final • Zbatimi i vendimeve • Të arriturat sociale

3.2. Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave tregon se dizajni i intervistës (gjysmë i strukturuar) ka ofruar fleksibilitet të mjaftueshëm për të fituar thellësi në analizim të rezultateve (Smith, 2018). Udhëzuesi i pyetjeve është i ndarë në tema të veçanta, të organizuara në një rrjedhë logjike për t'iu përgjigjur pyetjeve (Brown, 2015, pp. 123-135). Në këtë analizë, pyetjet kanë të bëjnë me rolin e intervistuesit në politikëbërje, si fasilituesi i procesit, pjesëmarrësit e tjerë në grupet e punës ose forumeve diskutimi, si dhe jopjesëmarrësit në forum (Jones, 2012, p. 710).

Dokumentet e përdorura si të dhëna dytësore mbështetëse janë të përdorura për të shtuar thellësinë e të dhënave të dhëna nga intervistat (Saunders, 2019, p. 282). Burimet e dokumenteve të disponueshme gjatë këtij hulumtimi përfshijnë hulumtime, raporte dhe dokumente zyrtare, mediat masive si artikuj të gazetave në internet (lokale dhe rajonale) dhe hulumtime nga organizata lokale dhe ndërkombëtare (Smith, 2018). Në

mënyrë të veçantë, dokumentet janë marrë në konsideratë në linjë me metodologjinë e përdorur në këtë analizë.

Siç është përcaktuar më lart mbi burimet e provave, dokumentet janë përdorur si të dhëna dytësore mbështetëse për të dhënat parësore nga intervistat, e cila është një praktikë e zakonshme në kërkime (Saunders, 2019, p. 282). Prandaj, kjo pjesë do të përshkruajë se cilat burime janë përdorur, si janë marrë të dhënat nga dokumentet në linjë me metodologjinë e përdorur.

Burimet e të dhënave të dokumenteve të disponueshme gjatë këtij hulumtimi janë nga dy fusha: mediat masive dhe burimet private. E para përfshin artikuj të gazetave në internet (lokale dhe rajonale) si dhe hulumtimeve nga organizata të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare.

Tabela 3. Roli dhe numri i të intervistuarve

Roli	Të ftuar në intervista	Pjesëmarrës
Zyrtarë drejtues institucionesh	20	10
Organizata Joqeveritare/ekspertë	22	15

3.3. Kredibiliteti

Kriteri i parë i cilësisë, kredibiliteti, është shumë i rëndësishëm pasi vlerëson besueshmërinë e burimeve tona të informacionit, që janë themeli i kërkimit. Për të siguruar një standard shkencor të kërkimit, kemi vënë në vend mekanizma të konfirmimit të të dhënave të intervistave, edhe pse e dimë që ato nuk janë të përsosura. Siç mund të ndodhë, të intervistuarit mund të mos japin të vërtetën për shkak të kompleksitetit dhe mungesës së kohës për t'i dhënë informacione të plota (Easterby-Smith, 2008, pp. 677-690). Gjithashtu, ata mund të kenë kujtim të pasaktë ose të paqartë.

Për të zvogëluar këtë rrezik dhe për të përmirësuar cilësinë e analizës sonë, shpjegohet me qartësi për të anketuarit se çfarë pritet prej tyre dhe cilat perspektiva duhet të kenë kur diskutohen për pjesëmarrjen e palëve të interesit dhe ekspertëve në politikë në një mënyrë të strukturuar (Easterby-Smith, 2008, p. 667). Pastaj, transkriptet e intervistave dërgohen për vërtetim.

Së fundi, është përdorur një model i zgjedhjes së rasteve (institucioneve qendrore dhe lokale) që na lejon të përdorim burime të shumta provash, për të krahasuar dhe verifikuar burimet e ndryshme dhe për të reduktuar rrezikun e informacioneve të pasakta dhe të paplotës, siç e parasheh edhe (Easterby-Smith, 2008).

3.4. Modeli për analizën e të dhënave

Në këtë studim është zgjedhur një model analize kualitative induktive për të ndjekur objektivin kryesor, që është të kuptojmë se si intervistat kanë kuptuar dhe vlerësuar rolin e intervistuesit në procesin e politikëbërjes. Për të arritur këtë qëllim, është përdorur një strategji analitike që na lejon të përqendrohemi në kuptimet themelore të një teorie të caktuar dhe të ndërtojmë hipoteza mbi ato kuptime nëpërmjet analizës së të dhënave.

Janë përzgjedhur katër raste të studimit për të pasqyruar perspektivat e ndryshme. Këto raste janë të aspektit historik të zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse, dhe praktikat e institucioneve qendrore dhe lokale të konsultimit publik. Këto raste kanë mundësuar të

përqendrohem në një gamë të gjerë të çështjeve dhe perspektivave në fushën që analizojmë.

Sa i përket procesit të intervistimit, janë kryer intervista me individë të ndryshëm në pozicione të ndryshme dhe me përvoja të ndryshme në procesin e politikëbërjes. Në këto intervista, është përdorur një model i strukturuar i pyetjeve për të siguruar se të gjithë intervistat kanë diskutuar temat e njëjta dhe kanë dhënë perspektivat e tyre të ndryshme mbi rolin e intervistuesit në procesin e politikëbërjes. Në këtë mënyrë, është siguruar një bazë e rëndësishme e të dhënave për t'u analizuar.

Janë përgatitur gjashtë lloje të pyetësorëve për intervista, të cilat përfshijnë:

1. Intervista për zyrtarët publikë në nivel qendror;
2. Intervista për kontributdhënësit në nivel qendror (Shoqëri civile, ekspertë, donatorë);
3. Intervista për administratën komunale;
4. Intervista për stafin politik lokal;
5. Intervista për zyrat e informimit në komuna;
6. Intervista për kontributdhënësit lokalë (OJQ, ekspertë, qytetarë).

Në përfundim, modeli i analizës kualitative induktive na ka lejuar të kuptojmë më mirë kuptimet themelore të teorisë së politikëbërjes dhe të ndërtojmë hipoteza të reja në bazë të të dhënave të grumbulluara. Për më tepër, kemi përdorur një numër të burimeve të ndryshme për të verifikuar dhe vërtetuar hipotezat tona.

Ky model është një mjet për analizën e projekteve specifike në kuadër të ciklit të politikës së vendimmarrjes, duke u fokusuar në përcaktimin e agjendës, hartimin e politikave, nxjerrjen e vendimeve, zbatimin e vendimeve dhe monitorimin e zbatimit.

Struktura e modelit përmban këto elemente

Prezantimi i rastit: Në këtë pjesë paraqitet projekti specifik ose çështja e shtjelluar mbi të cilin do të bëhet analiza e të dhënave.

Pjesëmarrja e palëve të interesit dhe ekspertëve: Kjo pjesë fokusohet se si institucionet kanë bërë identifikimin e palëve të interesit dhe ekspertëve të nevojshëm për të kontribuar në projekt. Zgjedhja e tyre a është bazuar në kushte të paracaktuara dhe sa është përfshirja e tyre në mënyrë aktive dhe në një fazë të hershme.

Përcaktimi i agjendës: Kjo pjesë do të fokusohet në qëllimin e projektit dhe gatishmërinë për bashkëpunim. Do të konsiderohet se si pjesëmarrësit e zgjedhur do të ndërveprojnë dhe do të përcaktojnë agjendën e projektit.

Procesi: Kjo pjesë do të fokusohet në dizajnin e procesit dhe lehtësimin e pavarur të palëve të interesit. Do të përcaktohet se si pjesëmarrësit do të ndërveprojnë dhe do të përcaktojnë procesin e projektit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Ndikimi dhe monitorimi: Kjo pjesë do të fokusohet në rezultatet e konsultimit publik, si dhe në pranimin e komenteve/rekomandimeve të dhëna nga shoqëria civile. Do të vlerësohet se si konsultimi ka ndikuar në avancimin e politikës publike dhe si mund të ndikojë në të ardhmen, si dhe mënyrën se si monitorohet kjo politikë/vendim.

Të mësuarit social dhe demokratizimi; Kjo pjesë do të fokusohet në çështjet themelore të projektit, pritshmëria, transparencën dhe atmosferën në marrjen e vendimeve. Do të analizohet se si projekti ka kontribuar në mënyrë të përgjithshme në demokratizimin.

3.5. Kufizimet

Ky hulumtim disertacioni ka një numër të kufizimeve të cilat mund të ndikojnë në cilësinë dhe saktësinë e përfundimeve të arritura. Në vijim janë disa nga kufizimet kryesore të këtij hulumtimi:

Kufizime të metodologjisë: Hulumtimi bazohet kryesisht në metodën kualitative, përfshirë intervistat dhe studimet e rasteve. Këto metoda janë të dobishme në përfshirjen

e perspektivave të ndryshme dhe në zbulimin e rasteve të rëndësishme, por mund të kenë një problem në kuptimin e një sasi të mjaftueshme të të dhënave dhe në përcaktimin e një përgjigjeje të saktë dhe të përgjithshme për pyetjen kryesore të hulumtimit (Creswell, 2014, p. 71).

Kufizime të objektivit të hulumtimit: Ky hulumtim kufizohet në Kosovë dhe në kontekstin e saj politik dhe kulturor, ndërsa hulumton fare pak fenomene të ngjashme në vende të tjera. Kjo mund të kufizojë ndërhyrjen e mëtejshme dhe aplikimin e përgjithshëm të rezultateve të këtij hulumtimi në vende të tjera ose në situata të ngjashme (Leedy & Ormrod, 2015, p. 45).

Kufizime të disponueshmërisë së informacionit: Hulumtimi mund të ketë vështirësi në gjetjen e informacionit të nevojshëm për të provuar hipotezat dhe për të mbështetur përfundimet. Në disa raste, informacioni mund të jetë i vështirë për të ardhur në kontakt me të, ose mund të jetë i limituar nga burimet e informacionit të disponueshme (Maxwell, 2013, p. 234).

Kufizime të kredibilitetit të respondentëve: Në rastin e intervistave, respondentët mund të kenë kufizime në rrjedhën e mendimeve të tyre, për shembull, nga frika e goditjes politike. Kjo mund të ndikojë në saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të marra nga hulumtuesit (Leedy & Ormrod, 2015, p. 167).

KAPITULLI IV: KUADRI LIGJOR DHE MEKANIZMAT E PJESËMARRJES

Kapitulli i katërt i këtij hulumtimi përmban një analizë të hollësishme të kuadrit ligjor dhe mekanizmave aktualë të pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës fillimisht global dhe pastaj me fokus në Kosovë. Në këtë kapitull, është bërë një shqyrtim të gjerë të legjislacionit relevant në fushën e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin vendimmarrës dhe është analizuar se si ky kuadër ligjor është zbatuar në praktikë. Gjithashtu, është diskutuar rëndësinë e një kuadri ligjor të përshtatshëm për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës dhe kam shqyrtuar legjislacionin aktual në Kosovë që mbështet këtë qëllim. Po ashtu, janë shqyrtuar mekanizmat aktualë të pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës në Kosovë, duke përfshirë procesin e konsultimit publik dhe përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes në nivelet lokale dhe qendrore. Me këtë informacion, lexuesi mund të kuptojë më mirë se si qytetarët dhe shoqëria civile janë të përfshirë në procesin vendimmarrës në Kosovë dhe se si ata mund të ndikojnë në politikat dhe vendimet që kanë ndikim në jetën e tyre të përditshme.

4.1. Kuadri ligjor ndërkombëtar

Pjesëmarrja e publikut në procesin vendimmarrës është thelbësore për një qeverisje të mirë dhe demokratike. Në fakt, ajo është e nevojshme për të promovuar shtetin e së drejtës, përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik, si dhe për të avancuar të gjitha të drejtat e njeriut. E drejta për të marrë pjesë në jetën publike është një e drejtë themelore e njeriut dhe fuqizon individët dhe grupet. Ajo është gjithashtu një element themelor i qasjeve të bazuar në të drejtat e njeriut, që synojnë eliminimin e marginalizimit dhe diskriminimit.

Në dekadat e fundit, disa samite të mëdha të Kombeve të Bashkuara, rezoluta dhe deklarata ndërkombëtare kanë theksuar nevojën për më shumë pjesëmarrje nga publiku në procesin vendimmarrës. Gjithashtu është përqendruar vëmendja në partneritetet midis palëve të interesit në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë qeveritë

kombëtare, organizatat e shoqërisë civile, mediat, bizneset dhe sektorin privat (OKB, Njerëzit kanë rëndësi: Angazhimi civil në qeverisjen publike, 2008).

Këshilli i Evropës në veçanti njih mekanizmat efektivë dhe të qëndrueshëm për dialog, konsultim dhe bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe autoriteteve në të gjitha nivelet si shtytës të rëndësishëm që lejojnë pjesëmarrjen e të gjithë individëve dhe grupeve shoqërore në vendimmarrjen demokratike (Evropian, 2015). Në fakt, ka njohur rritjen në nevojën për të futur mekanizma ligjorë ose modele të ndryshme që do të lehtësojnë pjesëmarrjen civile në vendet e Evropës.

Në nivel ndërkombëtar, dokumente të ndryshme mbështesin të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje. Disa prej tyre kanë ndikuar thellësisht në ligjet e shumë vendeve, përfshirë Kosovën. Një ndër këto dokumente është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e cila ka pasur ndikim në shumë Konventa dhe kushtetuta ndërkombëtare të shumë vendeve demokratike. Kjo deklaratë është e aplikueshme drejtpërdrejt në Kosovë dhe përkrah hapur pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen publike. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike gjithashtu ka ndikuar thellësisht në demokratizimin e shoqërive në vende të ndryshme dhe është i zbatueshëm drejtpërdrejt në Kosovë. Sipas këtij Pakti, secili qytetar ka të drejtë të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, duke votuar ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

4.1.1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)

DUDNJ (Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut) është një dokument monumental në historinë e njerëzimit, miratuar më 10 dhjetor 1948 nga Asambleja Kombëtare e Kombeve të Bashkuara. Ky standard përcakton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si të drejta për liri, barazi, drejtësi dhe paqe, dhe ka lindur nga dëshira për të ndihmuar në ndërtimin e një bote më të drejtë dhe të qetë pas Luftës së Dytë Botërore. Ndikimi i saj ka qenë i jashtëzakonshëm, duke u shfaqur në shumë instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kushtetuta të vendeve demokratike, dhe dispozitat e saj janë

bërë pjesë e shumë Konventa dhe marrëveshjeve ndërkombëtare (UN, Universal Declaration of Human Rights, 2023).

Në Kosovë, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut ka një zbatim të drejtpërdrejtë dhe mbështet pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen publike. Ajo nxit secilin shtet të sigurojë këtë të drejtë, dhe një përparësi e theksuar është të drejta për të marrë pjesë në vendimmarrjen publike, direkt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirshëm. Ky angazhim i drejtpërdrejtë me qytetarët përkon me dispozitat e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe reflekton përpjekjet e Kosovës për të garantuar një qeverisje transparente dhe pjesëmarrëse që respekton të drejtat dhe liritë themelore të njerëzve të saj.

4.1.2. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP)

PNDCP (Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike) është një instrument ndërkombëtar që u miratua në 1966 dhe hyni në fuqi në 1976. Pakti ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në demokratizimin e shoqërive botërore dhe është një nga dy paktet kryesore të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Qëllimi i tij është të mbrojë dhe të promovojë të drejtat civile dhe politike, përfshirë të drejtën për liri, mendim, fjalë, dhe pjesëmarrje në jetën publike. Kjo përfshin të drejtat për të votuar, kandiduar në zgjedhje të lira, dhe për të formuar dhe për t'u bashkuar në parti politike (OKB, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 25).

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike ka zbatim të drejtpërdrejtë në Kosovë, pasi vendi është një shtet i pavarur dhe i pranuar në OKB. Në kuadër të tij, Kosova ka përfshirë dispozita që janë thelbësore për demokracinë, drejtësinë dhe shtetin e së drejtës, duke i ndihmuar qytetarët e saj të gëzojnë të drejta të barabarta dhe liritë themelore. Pakti nënvizon se qytetarët kanë të drejtë të marrin pjesë në drejtimin e punëve publike, direkt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirshëm. Kjo është një pikë thelbësore për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në vend, në

mënyrë që ata të kenë një zë në zgjedhjen e politikave dhe në vendimmarrjen e tyre (Komisioni për të Drejtat e Njeriut, 2020).

4.1.3. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (KEFDR)

KEFDR (Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor) është një instrument ndërkombëtar i adoptuar në 1965 dhe i hyrë në fuqi në 1969. Kjo Konventë përcakton diskriminimin racor dhe angazhon shtetet për të eliminuar të gjitha format e tij në fusha të ndryshme të jetës, duke përfshirë nëpunësinë, arsimin, shëndetësinë, dhe më tej. E ratifikuar nga shumë shtete, përfshirë Kosovën, Konventa ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, promovimin e barazisë dhe pjesëmarrjen qytetare, duke inkurajuar respektin për diversitetin kulturor dhe etnik dhe në rritjen e ndërgjegjësimin të qytetarëve për të drejtat e tyre (OKB, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, 2018).

4.1.4. Konventa për Zhdukjen e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KZHGFJFDG)

KZHGFJFDG ka një rëndësi të veçantë në aspektin e pjesëmarrjes në politikë dhe vendimmarrje. Konventa dha një definicion të diskriminimit kundër grave dhe rregullon se si shtetet anëtare duhet të ndalojnë diskriminimin dhe të mbrojnë të drejtat e grave në fusha të ndryshme, si p.sh. në arsim, punë, shëndetësi, dhe politikë. Për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje, Konventa është thelbësore, pasi ato gjithmonë kanë qenë objekt diskriminimi në këto fusha. Konventa ndalon diskriminimin gjinor në aspektin e pjesëmarrjes në politikë dhe kërkon që gratë të kenë të njëjtat të drejta si burrat për të zgjedhur dhe të zgjidhen në pozicione politike, dhe të jenë të pranishme në proceset vendimmarrëse (Assembly, 1979).

Implementimi i Konventës për Zhdukjen e Të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave ndihmon në përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje nëpër vendet anëtare. Duke u ndaluar diskriminimi kundër grave, ato kanë mundësi të kenë një

ndikim të drejtpërdrejtë në proceset vendimmarrëse dhe në zhvillimin e politikave që janë në interesin e tyre dhe të shoqërisë në tërësi. Kjo konventë vë theksin në nevojën për barazi gjinore në politikë dhe vendimmarrje dhe në zbatimin e saj në praktikë ndihmon në zhvillimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë për gratë. Implementimi i saj është një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një shoqërie më të ndershme dhe më të barabartë për të gjithë.

Rëndësia e KZHGFJFDG për pjesëmarrjen qytetare në Kosovë është shumë e madhe, pasi që konventa inkurajon dhe promovon pjesëmarrjen aktive të grave në jetën politike të vendit. Në këtë mënyrë, KZHGFJFDG kontribuon në ngritjen e nivelit të pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse dhe në politikën vendore në Kosovë (Komisioni për të Drejtat e Njeriut, 2020). Në Kosovë, pjesëmarrja e grave në politikë është ende sfiduese, sidomos në nivelet e larta të vendimmarrjes. Megjithatë, ndërkohë që Kosova po vazhdon procesin e integritimit në BE dhe po bën përpjekje për të avancuar në rrugën e demokracisë, KZHGFJFDG mbetet një instrument i rëndësishëm për të nxitur pjesëmarrjen e grave në proceset vendimmarrëse dhe për të garantuar barazinë gjinore në politikë.

4.1.5. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEMDNJ)

KEMDNJ është një instrument ndërkombëtar në Evropë që mbrojt lirinë e shprehjes dhe të tubimit dhe shoqërimit, siç përcaktohet në Nenet 10 dhe 11. Ky instrument është vital për sigurimin e mjedisit të lirë për debat dhe dialog, duke u bërë bazë e pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile në vendimmarrje. Parakushti i garantimit të këtyre lirive është thelbësor për të mundësuar njerëzit të shprehin dhe të dëgjojnë mendimet në mënyrë të hapur, dhe luan një rol kyç në transparencën dhe llogaridhënien në qeverisjen publike (Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Neni 10 dhe 11).

KEMDNJ ka një zbatueshmëri të drejtpërdrejtë edhe në Kosovë. Si një shtet i pavarur dhe sovran, Kosova është pjesë e Këshillit të Evropës dhe e Konventës Evropiane të të Drejtave

të Njeriut. Kjo do të thotë se, në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe ligjin vendor, Kosova duhet të sigurojë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut siç janë të garantuara në KEMDNJ dhe në Protokollet e saj (KE K. p., 2023).

4.1.6. Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale (KEVL)

KEVL është një dokument i miratuar nga Këshilli i Evropës më 15 tetor 1985, i cili përcakton përgjegjësitë dhe rolin e autoriteteve lokale në vendimmarrje dhe zbatimin e politikave publike (KE, 2023). Në Kosovë, KEVL është një instrument rëndësishëm në promovimin e vetëqeverisjes lokale dhe decentralizimit të qeverisjes. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Kosova filloi të ndërtojë institucionet e veta dhe të zhvillojë një sistem të ri të qeverisjes lokale. Në këtë proces, KEVL dhe rregullatorët e tjera të Këshillit të Evropës kanë qenë burime të rëndësishme të drejtësisë dhe mbështetjes (European Charter of Local Self-Government (ETS No. 122), 2023).

KEVL është transpozuar në ligjin për vetëqeverisjen lokale në Kosovë dhe është bërë pjesë e Kushtetutës së Kosovës. Ky instrument rregullator siguron një bazë ligjore për institucionet lokale në Kosovë dhe u jep atyre përgjegjësi të qarta në zbatimin e politikave lokale (Lirika Koliqi & Vjosa Musliu, 2015). Për shembull, KEVL i jep autoriteteve lokale të drejtën e menaxhimit të buxhetit të tyre dhe të vendosjes së politikave të tyre për zhvillim ekonomik, kulturor dhe social (P Zogaj & H Gashi, 2016).

Ligji për vetëqeverisjen lokale në Kosovë është një instrument juridik që transponon KEVL dhe është bërë pjesë e Kushtetutës së Kosovës. Ky instrument juridik siguron një bazë ligjore për institucionet lokale në Kosovë dhe u jep atyre përgjegjësi të qarta në zbatimin e politikave lokale, duke përfshirë menaxhimin e buxhetit të tyre dhe vendosjen e politikave për zhvillim ekonomik, kulturor dhe social (Kuvendi i Kosovës, Ligji për vetëqeverisjen lokale në Kosovë, 2023). Përveç KEVL, Këshilli i Evropës ka zhvilluar edhe protokolle të ndryshme në lidhje me vetëqeverisjen lokale. Protokollet shtojnë të drejta dhe përgjegjësi të tjera për autoritetet lokale, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në

proceset vendimmarrëse, menaxhimin e burimeve natyrore dhe mjedisore, dhe promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut në nivel lokal (EC, 2009).

Zbatimi i KEVL-së dhe protokolleve të tjera për vetëqeverisjen lokale në Kosovë ende përballlet me sfida të ndryshme, përfshirë mungesën e burimeve financiare dhe kapaciteteve të kufizuara të administratës lokale. Megjithatë, këto instrumente juridike janë ende të rëndësishme në promovimin.

4.1.7. CM / Rekomandimi (2007) për statusin juridik të OJQ-ve

Për të promovuar pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare në procesin e vendimmarrjes demokratike, Këshilli i Evropës ka zhvilluar dy dokumente rregulluese. Instrumenti i parë është CM / Rekomandimi (2007) për statusin juridik të OJQ-ve, i cili kërkon nga shtetet anëtare që të sigurojnë pjesëmarrje efektive të këtyre organizatave në dialogun dhe konsultimin mbi objektivat dhe vendimet e politikës publike. Rekomandimi gjithashtu thekson detyrimet e shteteve për të mbrojtur të drejtat dhe lirinë e OJQ-ve, duke ndihmuar në rritjen e ndikimit të tyre në vendimmarrjen publike (Qendra Evropiane për Ligjin e Jofitimprurësve, 2016).

4.1.8. Kodi i praktikës së mirë për pjesëmarrjen civile në procesin e vendimmarrjes (2009)

Kodi është dokumenti i dytë që promovon pjesëmarrjen e OJQ-ve në procesin e vendimmarrjes, i hartuar nga Konferenca e Organizatave Joqeveritare Ndërkombëtare. Kodi ofron parime të përgjithshme, udhëzime dhe mekanizma për të ndihmuar në pjesëmarrjen aktive të OJQ-ve në procesin e vendimmarrjes. Edhe pse Kodi nuk është ligjërish i detyrueshëm, ai ofron udhëzime të hollësishme për zhvillimin e proceseve vendimmarrëse pjesëmarrëse në të gjitha nivelet. Duke e rritur ndikimin dhe pjesëmarrjen e OJQ-ve në procesin e vendimmarrjes, kodet dhe rekomandimet rregulluese të Këshillit të Evropës ndihmojnë në promovimin e demokracisë dhe

transparencës në qeverisjen publike (Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit, 2022).

4.2. Kuadri ligjor për pjesëmarrjen e qytetarëve në Kosovë

Kosova është një shtet demokratik i ri, por ka një kuadër ligjor të avancuar që është zhvilluar me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare. Shumica e instrumenteve ndërkombëtare që sigurojnë pjesëmarrjen qytetare janë përfshirë brenda këtij kuadri ligjor. Në këtë mënyrë, e drejta për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse është e garantuar në kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore të Kosovës.

4.2.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta është dokumenti kushtetues kryesor i vendit, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2008. Kushtetuta vendos marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të shtetit dhe qytetarëve, si dhe përcakton strukturën e pushtetit dhe të qeverisjes në Kosovë (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 38, 2008). Në këtë analizë do të shpjegojmë dhe do të analizojmë dispozitat kushtetuese që lidhen me të drejtat për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse në Kosovë.

Kushtetuta e Kosovës, e miratuar në 2008, është dokumenti kushtetues që rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve dhe përcakton strukturën e qeverisjes. Neni 23 garanton të drejtat dhe liritë e njeriut, ndërsa Neni 38 mbron lirinë e shprehjes së mendimit. Neni 43 dhe 44 rregullojnë të drejtën për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse, dhe Neni 49 ofron mbrojtje për të drejtat dhe liritë nga autoritetet shtetërore.

Këto dispozita theksojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe lirinë e shprehjes. Ato përcaktojnë se qytetarët kanë të drejtë të ndikojnë në proceset e vendimmarrjes dhe të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre nga institucionet e drejtësisë. Kushtetuta, si dokument ligjor progresiv, është themeli i të drejtave dhe lirive të qytetarëve në Kosovë.

4.2.2. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë ka një rol të rëndësishëm në pjesëmarrjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes. Në këtë ligj, pjesa e parë, quhet "Demokracia Lokale", i cili fokusohet në vlerat dhe parimet e qeverisjes lokale, duke përfshirë pjesëmarrjen dhe transparencën në procesin e vendimmarrjes (Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale i Kosovës, Kreu IX).

Në ligj, kreu i nëntë quhet "Demokracia e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve", thekson rolin e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Ligji thekson se qytetarët kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes lokale, dhe që autoritetet lokale kanë detyrimin të sigurojnë që kjo pjesëmarrje të jetë efektive (Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale i Kosovës, Kreu IX).

Për ta bërë këtë të mundur, ligji përcakton disa mekanizma për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes lokale. Një prej tyre është kërkesa për konsultime publike për çështjet e rëndësishme vendore, siç janë planifikimi urban, buxheti dhe politikat publike të ndryshme. Konsultimet publike duhet të jenë të përfshira dhe të hapura për të gjithë qytetarët dhe shoqërinë civile.

Në të njëjtën kohë, ligji përcakton dhe disa mekanizma të tjera për të lehtësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes lokale. Në këtë kuptim, është e rëndësishme të përmendet "Këshilli Konsultativ i Komunës", i cili është një mekanizëm konsultativ për t'i dhënë zë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes lokale. Këshilli përbëhet nga përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët kanë të drejtë të japin mendime dhe sugjerime mbi çështjet vendore.

Përveç këtyre mekanizmave, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë parashikon edhe zbatimin e proceseve të tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes lokale, siç janë audienat publike dhe referendume lokale. Ky ligj nxit pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes lokale dhe e bën atë të mundur përmes një kornize ligjore dhe institucionale të mirëfilltë.

4.2.3. Ligji për Qasje në Dokumentet Publike

Ligji për Qasje në Dokumentet Publike është një ligj në Kosovë i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2011. Ky ligj synon të sigurojë një qasje të lirë dhe transparente në dokumentet publike të institucioneve shtetërore dhe të tjera organizata publike në Kosovë.

Ligji për Qasje në Dokumentet Publike është rregulluar në përputhje me standardet e bashkësisë ndërkombëtare për të drejtën e njeriut për të marrë informacion dhe është një nga ligjet më të rëndësishme për transparencën dhe llogaridhënien në Kosovë. Ligji parashikon se të gjithë qytetarët kanë të drejtë të kenë qasje në dokumente publike dhe institucionet shtetërore janë të obliguara të japin këto dokumente në dispozicion (Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike).

Ligji për Qasje në Dokumentet Publike ka rëndësi të veçantë për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, pasi siguron transparencë dhe informacion për institucionet dhe vendimet që ato marrin. Përmes këtij ligji, qytetarët kanë mundësi të kërkojnë dhe të marrin informacione mbi çështjet që ata duan të njohin dhe të monitorojnë, duke u bërë në këtë mënyrë pjesëmarrës aktivë në proceset vendimmarrëse.

Në këtë mënyrë, Ligji për Qasje në Dokumentet Publike është një nga mekanizmat kryesorë për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse në Kosovë dhe për të ndihmuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë publike.

4.2.4. Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë

Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë në jetën publike është një instrument ligjor i Kosovës i miratuar më 2016. Qëllimi i tij kryesor është të përmirësojë pjesëmarrjen e rinisë në vendimmarrjen publike dhe të ndihmojë në fuqizimin e roli të tyre në shoqëri (Ligji Nr. 03/L-145 Mbi Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë, Nenet: 7.1.4 & 13., 2023).

Ky ligj përcakton përgjegjësitë e institucioneve publike, organizatave joqeveritare dhe të rinjve vetë për të nxitur dhe lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Ligji përcakton edhe mekanizmat e pjesëmarrjes së rinisë, duke inkurajuar institucionet publike të ofrojnë këshillim dhe mbështetje në zbatimin e projekteve të tyre.

Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë gjithashtu inkurajon zhvillimin e proceseve të pjesëmarrjes së rinisë në nivelin lokal dhe qendror. Në nivelin lokal, ky ligj kërkon që bashkitë të sigurojnë konsultim me të rinjtë në hartimin e planeve dhe strategjive të zhvillimit lokal. Ndërsa në nivelin qendror, ky ligj përcakton përgjegjësitë e Ministrisë së Rinisë për zhvillimin e politikave dhe strategjive për pjesëmarrjen e rinisë në jetën publike.

Në përgjithësi, Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e pjesëmarrjes së rinisë në proceset vendimmarrëse dhe për të inkurajuar rolin e tyre në shoqëri. Ky ligj siguron mekanizma dhe mundësi të ndryshme për të rinjtë në Kosovë për të ndikuar në politikat publike dhe për të kontribuar në zhvillimin e vendit të tyre.

4.2.5. Udhëzimi Administrativ mbi Standardet Minimale të Konsultimeve Publike në Komuna

Udhëzimi Administrativ mbi Standardet Minimale të Konsultimeve Publike në Komuna është një instrument ligjor në Kosovë, i cili ka për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse në nivelin lokal. Udhëzimi u miratua në vitin 2018 dhe është i detyrueshëm për të gjitha komunat në Kosovë.

Ky udhëzim ka si synim të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në procesin vendimmarrës në nivel lokal dhe të përmirësojë dialogun midis autoriteteve publike dhe shoqërisë civile. Sipas këtij udhëzimi, komunat duhet të kryejnë konsultime publike të përshtatshme dhe efektive me qytetarët dhe organizatat joqeveritare në vendimmarrjen që i ndërlidh me ta (Udhëzim Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, 2018).

Udhëzimi përcakton standardet minimale të konsultimeve publike që duhet të respektohen nga komunat, siç janë njoftimi i qartë dhe kohëzgjatja e mjaftueshme e konsultimeve publike, përdorimi i gjuhës së lehtësuar, sigurimi i qasjes të barabartë në informacion dhe konsultim për të gjithë qytetarët dhe organizatat joqeveritare.

Nëse komunat nuk respektojnë këto standarde minimale të konsultimeve publike, ato mund të ballafaqohen me pasojat ligjore dhe administrative për këtë. Kjo përfshin mundësinë e anulimit të vendimeve të marra pa respektuar këto standarde, si dhe dënimet për zyrtarët përgjegjës.

Në këtë mënyrë, Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë, Ligji për Qasje në Dokumente Publike dhe Udhëzimi Administrativ mbi Standardet minimale të Konsultimeve Publike në Komuna, së bashku me Kushtetutën e Kosovës dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare, ofrojnë një kornizë ligjore progresive për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse në Kosovë.

4.2.6. Udhëzimi Administrativ për Transparencën në Komuna

Udhëzimi Administrativ për Transparencën në Komuna është një dokument që ka për qëllim të rregullojë dhe të nxisë transparencën dhe llogaridhënien në administratën komunale të Kosovës, dhe është zbatuar në të gjitha komunat e vendit.

Në këtë udhëzim, janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e administratës komunale në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien. Administrata komunale është e detyruar të publikojë informacione për veprimtarinë e saj, të përfshira në raportet financiare, të dhëna për punën dhe shpenzimet e kryera, si dhe të dhëna për projekte dhe programe që kanë të bëjnë me komunën (MAPL, Udhëzimi Administrativ Nr 03-/2020 për Transparencën në Komuna, 2020).

Gjithashtu, udhëzimi kërkon që të sigurohet një nivel i lartë i transparencës dhe informimit të qytetarëve në lidhje me vendimet dhe aktivitetet e administratës komunale.

Për këtë arsye, është e nevojshme që dokumentet publike të jenë të lehtësisht të qasshme dhe të kuptueshme për publikun.

Udhëzimi përcakton edhe procedurat e përgjigjes së administratës komunale ndaj ankesave dhe kërkesave të qytetarëve për të marrë informacione. Administrata komunale është e detyruar të përgjigjet në kohë të shkurtër dhe në mënyrë korrekte ndaj kërkesave të qytetarëve për të marrë informacione.

Për të siguruar zbatimin e këtij udhëzimi, janë përcaktuar mekanizmat dhe organet që janë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të këtij dokumenti në komunat e Kosovës. Nëse administrata komunale nuk i përmbahet këtyre standardeve minimale, atëherë qytetarët kanë të drejtë të ankimohen dhe të kërkojnë mbrojtjen e tyre nga organet kompetente.

4.2.7. Ligji për krijimin, organizimin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në nivelin e komunave

Ligji për krijimin, organizimin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në nivelin e komunave nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka për qëllim të përmirësojë procesin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, duke krijuar komitete konsultative të përbëra nga përfaqësues të komuniteteve dhe organizatave të shoqërisë civile të cilat do të kenë rolin e të këshilluarit në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal.

Ky udhëzim administrativ përcakton procedurat dhe kriteret e nevojshme për krijimin dhe organizimin e komiteteve konsultative në komuna, si dhe kompetencat e tyre. Ky udhëzim promovon pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivelin lokal dhe siguron se këta qytetarë kanë një rol aktiv në proceset konsultative në komuna (MAPL, Udhëzim Administrativ Nr. 01/2016 për Procedurën e krijimit, organizimin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në nivelin e komunave).

Në këtë udhëzim, përcaktohet që të gjitha komunat në Kosovë duhet të krijojnë komitete konsultative për të adresuar çështje specifike që kanë impakt në komunitetin lokal. Këto komitete duhet të përbëhen nga përfaqësues të qytetarëve, shoqërisë civile dhe organizatave të tjera të ndryshme të komunitetit.

Udhëzimi administrativ gjithashtu përcakton procedurat dhe kriteret për emërimin e anëtarëve të komitetit konsultativ, si dhe rolin dhe funksionimin e tyre. Këta anëtarë duhet të kenë një larmi të gjerë të përvojës dhe ekspertizës në fushat e ndryshme që kanë të bëjnë me komunitetin lokal.

Përveç kësaj, ky udhëzim ka si qëllim të sigurojë se komitetet konsultative në komunat e Kosovës kanë standardet e nevojshme dhe janë në pajtim me praktikën më të mirë ndërkombëtare për të siguruar një pjesëmarrje efektive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal.

4.2.8. Udhëzimi Administrativ për Ueb faqet e Institucioneve Publike

Udhëzimi Administrativ për Ueb faqet e Institucioneve Publike ka për qëllim të sigurojë që informacioni i rëndësishëm dhe dokumentet publike të ndodhen në dispozicion të qytetarëve në mënyrë të lehtë dhe efektive. Kjo do të thotë se të gjitha institucionet publike duhet të kenë një faqe interneti ku të publikohen informacione dhe dokumente të rëndësishme në lidhje me punën dhe aktivitetet e tyre.

Udhëzimi përmban disa kërkesa të caktuara, si për shembull, institucionet publike duhet të publikojnë informacione rreth misionit dhe vizionit të tyre, strukturës organizative, raporteve financiare, procedurave të aplikimit për shërbime publike, dhe të drejtave dhe detyrimeve të qytetarëve në lidhje me këto shërbime. Kjo siguron një nivel të lartë të transparencës dhe mundëson që qytetarët të kenë qasje në informacion të nevojshëm për të marrë vendime të informuara rreth çështjeve që i interesojnë (MAP, 2015).

Udhëzimi Administrativ për faqet e internetit të institucioneve publike është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e transparencës dhe qasjes së qytetarëve në

informacionet dhe dokumentet publike. Ky udhëzim ka si qëllim të sigurojë që qytetarët të kenë qasje të lehtë në informacionin që ata kanë nevojë dhe të përmirësojë bashkëpunimin midis institucioneve publike dhe publikut.

4.2.9. Udhëzimi Administrativ mbi Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Hapësinor

Udhëzimi Administrativ mbi Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Hapësinor është një dokument zyrtar i publikuar nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Kosovës. Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë dhe të ndihmojë në zbatimin e procesit të pjesëmarrjes së publikut në planifikimin hapësinor në Kosovë.

Udhëzimi jep disa parime kryesore për pjesëmarrjen e publikut, siç janë të drejtat dhe obligimet e publikut në procesin e planifikimit hapësinor, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike në organizimin dhe koordinimin e këtij procesi.

Gjithashtu, udhëzimi përmban informacione specifike mbi procedurat dhe kohëzgjatjen e procesit të pjesëmarrjes së publikut, duke përfshirë publikimin e dokumenteve dhe informacionit të rëndësishëm, mbledhjen e mendimeve dhe sugjerimeve nga publiku, dhe konsiderimin e tyre në planifikimin hapësinor (MMPH, 2015).

Përveç kësaj, udhëzimi gjithashtu vë në pah rëndësinë e transparencës dhe informimit të publikut gjatë të gjithë procesit të planifikimit hapësinor, dhe jep udhëzime konkrete për ndërtimin e një faqeje të internetit të specializuar për informacionin e këtij procesi.

Udhëzimi Administrativ mbi Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Hapësinor është një instrument i rëndësishëm që ndihmon në garantimin e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në proceset e planifikimit hapësinor në Kosovë.

4.2.10. Statuti i Komunës

Statuti i komunës është një dokument që përcakton strukturën organizative dhe funksionet e komunës. Ai është një akt normativ që ka fuqi ligjore dhe krijohet nëpërmjet procedurave të përcaktuara në ligj. Statuti i komunës përcakton organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale, duke caktuar kompetencat dhe detyrat e këshillit dhe kryetarit të komunës, si dhe strukturën organizative të institucioneve të komunës. Statuti gjithashtu përcakton mënyrën se si bëhet planifikimi dhe zhvillimi i komunës, si dhe mënyrën se si bëhet menaxhimi i resurseve të komunës.

Statuti i komunës gjithashtu përcakton të drejtat dhe detyrat e qytetarëve në raport me institucionet e qeverisjes lokale. Ai mund të përcaktojë mënyrat e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse të komunës dhe mënyrat e komunikimit me institucionet e saj. Statuti i komunës është një dokument i rëndësishëm për zhvillimin dhe funksionimin e komunës, dhe është një instrument i rëndësishëm për qytetarët për të kuptuar se si funksionon dhe operon qeverisja lokale.

KAPITULLI V: RASTET E STUDIMIT DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

Në një botë të globalizuar dhe shpejt ndryshuese, pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes publike është një përbërës kyç për ndërtimin dhe zhvillimin e demokracive të qëndrueshme. Kjo pjesëmarrje, e cila shpesh manifestohet përmes formave të ndryshme të konsultimit dhe ndërveprimit midis shtetit dhe qytetarëve, përbën një fushë studimi me rëndësi të veçantë, sidomos në kontekstin e shteteve që janë në tranzicion drejt modeleve demokratike.

Ky disertacion ka për qëllim të zgjerojë kuptimin e këtyre proceseve, me një fokus të veçantë në Kosovë dhe disa aspekte krahasuese me shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Kapitulli i pestë i këtij disertacioni, i cili trajton katër raste studimore, është një mundësi unike për të thelluar dhe pasuruar diskursin rreth rolit të shoqërisë civile dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në mënyrë të strukturuar.

Dy nga studimet e para janë prezantuar dhe publikuar në revista ndërkombëtare, ndërsa dy të tjerat janë në proces përpunimi. Përmes një analize të hollësishme dhe të bazuar në të dhëna, këto studime ofrojnë një kuptim më të thellë të temave të nisura në fillim, duke analizuar raste të veçanta që variojnë nga rëndësia e pjesëmarrjes publike në shtetet post-jugosllave, deri te rritja e pjesëmarrjes gjinore dhe procesi i konsultimit në nivel qendror.

Studimi i Parë: Analizon rëndësinë e pjesëmarrjes publike në formimin e demokracive në shtetet post-jugosllave, me theks të veçantë në Kosovë dhe Kroaci.

Studimi i Dytë: I dedikohet rritjes së pjesëmarrjes gjinore, duke u përqendruar tek ndikimi i normave sociale mbi aktivizimin e grave në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Studimi i Tretë: Shqyrton procesin e konsultimit në nivel qendror, duke marrë si rast specifik konsultimet e MINT mbi disa projektligje.

Studimi i Katërt: Ka për qëllim të theksojë rritjen e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe grupimeve të ndryshme të interesit në formimin e politikave në komuna, duke analizuar komunat Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj.

Përmes këtyre rasteve studimore, kapitulli i pestë jo vetëm që zbulon të dhëna të reja dhe perspektiva, por gjithashtu paraqet një analizë dhe vlerësim të të dhënave të mbledhura, duke reflektuar mbi pasojat e tyre për përdorimin e metodave të strukturuar të pjesëmarrjes në vendimmarrjen publike në Kosovë.

5.1. Rast studimi I: Rëndësia e pjesëmarrjes publike në ndërtimin e demokracive në shtetet e ish-Jugosllavisë. Rast studimor: Kosova dhe Kroacia

5.1.1. Prezantim i rastit

Në vendet që dalin nga lufta dhe konflikti, ndërtimi i demokracisë është një proces me shumë faktorë. Por faktori më i rëndësishëm është aktivizim qytetar dhe pjesëmarrja e publikut në ndërtimin e demokracisë. Ka shumë mënyra për ta bërë këtë, të cilat do të shtjellohen më tej, megjithatë, qëllimi i këtij studimi është të nënvizojë se si vendet e ish-Jugosllavisë kanë përparuar në demokraci përmes pjesëmarrjes qytetare në politikë, dhe një veprim i tillë ka pasur efekt në praktikë. Kroacia dhe Kosova kanë një të kaluar që përkon në shumë aspekte, veçanërisht në aspektin historik dhe politik, por si dy vende të dala nga shteti i madh jugosllav; të dyja kanë përparuar në rrugën e tyre drejt integritetit euroatlantik dhe gjithashtu në ndërtimin e demokracisë, pas përfundimit të luftërave.

Është e rëndësishme të analizohet rruga e tyre në këtë proces, për të parë se si politika të caktuara që kanë nxitur pjesëmarrjen e publikut në politikëbërje kanë ndikuar në avancimin e demokracisë në vend. Nëpërmjet këtij rasti studimor, qëllimi kryesor është që të shtjellohen efektet e pjesëmarrjes publike në ndërtimin e demokracive (ngjashmëritë dhe dallimet) në shtetet e ish-Jugosllavisë, Kosovë dhe Kroaci, duke analizuar Indeksin e Transformimit BTI, raportet e Kroacisë dhe Kosovës dhe gjithashtu

Tipet e Demokracisë (Varieties of Democracy) - Variablat Publike mbi Pjesëmarrjen Publike për Kosovën dhe Kroacinë.

Hipotezat e ngritura bazohen në studime transformuese që bëjnë përpjekje për të shpjeguar rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut në ndryshime të ndryshme politike, veçanërisht në ngritjen e vlerave demokratike.

5.1.2. Pjesëmarrja publike dhe demokracia

Ekziston një numër i madh i literaturës shkencore në shkencat shoqërore dhe dokumente qeveritare që trajtojnë normat dhe parimet abstrakte për vlerësimin dhe gjykimin e diskutimit dhe pjesëmarrjes publike. Pjesëmarrja publike nuk është thjesht një karakteristikë e demokracisë, por është themeli mbi të cilin mbështetet dhe krijohet. Pa një pjesëmarrje aktive dhe të informuar nga ana e qytetarëve, ndërveprimi demokratik mund të vuajë. Pjesëmarrja publike jo vetëm që pasuron demokracinë, por gjithashtu kontribuon në sigurimin e një vendimmarrje më të mirë. Kjo do të thotë se përmes diskutimeve dhe debatit të hapur, vendimet politike mund të përmirësohen dhe të përshtaten më mirë me nevojat dhe dëshirat e qytetarëve.

Forcimi i llogaridhënies së politikanëve ndaj qytetarëve është një aspekt tjetër thelbësor i pjesëmarrjes publike. Nëpërmjet kontrolleve dhe balancave, si dhe pjesëmarrjes aktive në proceset politike, qytetarët mund të ndihmojnë në mbikëqyrjen e veprimeve të zyrtarëve të zgjedhur dhe në sigurimin e transparencës dhe integritetit të qeverisjes.

Sot, qytetarët përfshihen gjithnjë e më shumë në veprime politike, jo vetëm në ato konvencionale por edhe jokonvencionale. Veprimet konvencionale, si votimi, petitionet dhe anëtarësimi në parti politike, janë të njohura dhe të pranuara si pjesë e procesit demokratik. Ato janë kanale të rëndësishme të pjesëmarrjes dhe ndikimit në politikë dhe qeverisje. Veprimet konvencionale i referohen mënyrave klasike të veprimit politik, ndërsa veprimet jokonvencionale shtojnë demonstrata, protesta, kritika, marshime proteste dhe forma të tjera të protestës (digjitale) si dhe mbledhje dhe mosbindje civile

(Kamlage, 2017, p. 3). Autoritetet publike kanë përgjegjësi të ofrojnë edukim, informacion dhe inkurajim për pjesëmarrjen e publikut (Union, 2015).

Studimet e transformimit bëjnë përpjekje për të shpjeguar rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut në ndryshime të ndryshme politike, veçanërisht në ngritjen e vlerave demokratike. Ndjekja e faktorëve kyçë për demokratizim të suksesshëm në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, duke përfshirë shtetet e ish-Jugosllavisë se mungesa e një alternative të besueshme ndaj demokracisë liberale; ndryshim i gjerë i elitave nëpërmjet zgjedhjeve demokratike; ngritja relativisht e fortë e shoqërisë civile dhe roli i saj aktiv në ndryshimin e regjimit; dhe perspektiva e anëtarësimit në BE si orientim i përgjithshëm i reformave (Stratulat, 2011, p. 6). Të gjithë këta shembuj kanë ndodhur në Kosovë dhe Kroaci, të cilat do të studiohen në këtë rast studimi, me fokus se si pjesëmarrja publike po ndikon në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të tyre demokratik.

5.1.3. Rënia e Jugosllavisë ka ndikuar në zhvillimin e demokracisë në Kosovë dhe Kroaci

Sa i përket kolapsit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ishte një proces i vazhdueshëm dhe gjithnjë e më i dhunshëm i shpërbërjes së një shteti multi-etnik që krenohej për sjelljen e harmonisë dhe stabilitetit në një rajon tradicionalisht të përçarë. Rënia e Jugosllavisë pati dy modele kryesore të kolapsit. Një model, i parë në Slloveni dhe Maqedoni, ishte kryesisht paqësor, duke çuar në pak konflikt të vazhdueshëm. Modeli tjetër, i parë në Kroaci, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë, ishte ai i luftës etnike, masakrave, krimeve të luftës dhe zgjidhjes së konflikteve të imponuara nga jashtë nga fuqitë e huaja (Langer, 2012, p. 1). Posaçërisht, shembulli i dytë tregon se angazhimi i madh i publikut ishte përcaktues i ndryshimeve historike/politike të ndodhura para/pas ekzistencës së Jugosllavisë. Gjithashtu, ai sjell në plan të parë rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut në iniciimin dhe diferencimin e politikave publike dhe narrativeve politike.

Megjithatë, tre dekada pas shpërbërjes së Jugosllavisë, të gjitha shtetet janë formalisht vende demokratike: veçanërisht në Kosovë dhe Kroaci, ka zgjedhje të rregullta shumë

partiake, ndarje të dukshme të pushteteve, institucione të vendosura demokratike dhe gjuhë demokratike. Megjithatë, ekziston nevoja për të bërë dallimin ndërmjet institucioneve dhe procedurave formale të demokracisë dhe zbatimit aktual. Qeveritë e përgjegjshme, kontrollet dhe balancat, sundimi i ligjit dhe liria e fjalës mungojnë kryesisht në praktikat politike në rajon (Pascal, 2016).

5.1.4. Situata aktuale e zhvillimit të demokracisë nëpërmjet pjesëmarrjes publike

Edhe pse Kosova dhe Kroacia kanë inkorporuar konventat dhe rregullat ndërkombëtare në sistemin e tyre kushtetues, duke përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25 i të cilit thotë se çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike, drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; të votojnë dhe të zgjidhen në zgjedhje të vërteta periodike, të cilat do të jenë me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe do të mbahen me votim të fshehtë, duke garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve; Të ketë qasje, në kushte të përgjithshme të barazisë, në shërbimin publik në vendin e tij. Të dy vendeve u mungon rritja e pjesëmarrjes publike në nivele të ndryshme të qeverisjes.




Figura 7. Indeksi i participimit të shoqërisë civile, V-Dem 2022

Figura 7 paraqet indeksin relativisht të ulët të dy vendeve për sa i përket pjesëmarrjes së shoqërisë civile. Pjesëmarrja civile mund të ndodhë gjatë periudhave të ndryshme të zgjedhjeve dhe ndërmjet zgjedhjeve, gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të politikave dhe ligjeve. Megjithatë, duke krahasuar rezultatet e dhjetë viteve, (2000 – 2022), ka nivele të ulëta të pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse politike, përfshirë zgjedhjet, si dhe interes të ulët për të marrë pjesë, për shkak të besimit të kufizuar në qeveri dhe demokraci.

Megjithatë, niveli i ulët i pjesëmarrjes së qytetarëve dhe OSHC-ve në procesin e vendimmarrjes dhe politikëbërjes nuk lidhet vetëm me qasjen e institucioneve, por edhe me kulturën e pjesëmarrjes dhe kapacitetet e shoqërisë civile (Demi, 2018). Ky nivel i ulët i aktivizimit qytetar ndikon shumë në procesin e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe politikëbërje. Cilësia e një qeverie varet kryesisht nga normat shoqërore dhe angazhimi qytetar. Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi i qytetarëve në një shoqëri njihet edhe si kapital social. Studiuesit kanë gjetur lidhje të shumta midis shoqërive që kanë një nivel të lartë të angazhimit social ose rrjeteve qytetare, me politika publike më të mira dhe qeverisje më efikase (Putnam, 1995).




Figura 8. Indeksi i pjesëmarrjes demokratike, V-Dem 2023

Sipas Indeksit të pjesëmarrjes demokratike të Institutit V-Dem, i cili matë shkallën në të cilën qytetarët marrin pjesë në qeverisjen e tyre përmes institucioneve demokratike lokale, organizatave të shoqërisë civile, demokracisë së drejtpërdrejtë dhe koncepteve të matura në indeksin e demokracisë zgjedhore, Kosova ka shënuar një rritje të lehtë gjatë dhjetë viteve të fundit, paraqitur në Fig. 8. Megjithatë Kosova nuk ka nivel të lartë të pjesëmarrjes demokratike, por shënon rritje të dukshme të përvjetshme.

Parimi pjesëmarrës i demokracisë thekson pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në të gjitha proceset politike, zgjedhore dhe jozgjedhore. Ajo është e motivuar nga shqetësimi për një praktikë themeltare të demokracisë zgjedhore: delegimi i autoritetit të përfaqësuesit. Pra, preferohet sundimi i drejtpërdrejtë nga qytetarët, kudo që është e mundur. Kështu, ky model i demokracisë e merr si të mirëqenë të drejtën e votës, duke theksuar angazhimin në organizatat e shoqërisë civile, demokracinë e drejtpërdrejtë dhe organet e zgjedhura lokale. Për ta bërë atë një masë të demokracisë pjesëmarrëse, indeksi merr gjithashtu parasysh nivelin e demokracisë zgjedhore (V-Dem, Country Graph Kosovo, Participatory Democracy Index, 2023).

Kurse, paraqitur në Fig 9. Kroacia ka një ekuivalencë të pjesëmarrjes demokratike nga viti 2016 e tutje, por ulje në krahasim me vitet 2015 -2022.




Figura 9. Indeksi i pjesëmarrjes demokratike, Kroaci. V-Dem 2023

Sa i përket zgjedhjeve (Fig. 9), si demokraci e drejtpërdrejtë përmes së cilës qytetarët zgjedhin autoritetin për të qeverisur shtetin, si në Kroaci ashtu edhe në Kosovë, pjesëmarrja në zgjedhje është e ulët dhe nuk ka besim në aftësitë e përfaqësuesve të zgjedhur politikë apo vullnet për të vepruar në interes publik në të dy shtetet (Pasic, 2016).




Figura 10. Dalja në zgjedhje në Kosovë dhe Kroaci, V-Dem 2020

Siç është paraqitur në grafënë e Institutit V-dem, ngjashëm me Kroacinë, edhe në Kosovë pjesëmarrja në zgjedhje mbetet ekuivalente ndër vite. Nuk ka analiza të thella pse rezultatet mbeten pothuajse konstante, por pakënaqësia me qeverisjen mbetet shkaku më i përmendur.

Bazuar në Raportin vjetor të Demokracisë (2022) paraqitur në Fig. 11, qytetarët mund të bashkohen lirisht në një gamë të gjerë grupesh qytetare. Kjo garantohet me kushtetutë dhe respektohet në masë të madhe nga të gjithë aktorët politikë dhe shoqërorë. Grupet më të zakonshme qytetare fokusohen në sport, kulturën lokale, fenë dhe mjedisin.

Ndërkohë, ka edhe një sërë grupesh rinore si dhe OJQ mbikëqyrëse dhe avokuese, të cilat përpiqen të ndikojnë në politikën e qeverisë ose të përmirësojnë kushtet e grupeve të veçanta sociale (BTI, BTI 2022 Country Report, 2022).





Figura 11. Ambienti i pjesëmarrjes së Shoqërisë Civile, V-Dem 2023

Përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike kanë një fuqi efektive për të qeverisur, duke qenë se sistemi i partneritetit social i vendosur në Kroaci është vetëm pjesërisht efikas, grupe të forta si sipërmarrësit më të fuqishëm, veteranët e luftës dhe përfaqësuesit e Kishës Katolike ushtrojnë ndikim mbi shumë vendime të rëndësishme politike (BTI, BTI 2022 Country Report, 2022). Qytetarët kroatë nuk përballen me kufizime kur organizohen në iniciativa politike ose civile. Liria e shprehjes është e garantuar me kushtetutë, por herë pas here i nënshtrohet ndërhyrjeve (Indicator, Sustainable Governance, Croatia, Executive Accountability, n.d.). Shih më shumë Fig. 12.

Croatia Democracy Status 8.3



Transformation Atlas 2022


© Bertelsmann Stiftung 2023

Figura 12. Kroacia: Statusi i demokracisë sipas Atlasit të Transformimit

Sa i përket Republikës së Kosovës, krahasuar me Kroacinë, Zhvillimi Demokracisë mbetet në nivel më të ulët. Ndonëse ka pasur përmirësime dhe zhvillime të konsiderueshme sa i përket avancimit të demokracisë pjesëmarrëse, mbetet ende punë për t'u bërë. Statusi i Demokracisë për Kosovë, sipas Atlasit të Transformimit, paraqitet në Fig. 13. Kushtetuta e vitit 2008 jep të drejta dhe liri themelore, në përputhje me Planin e Ahtisaarit. Ai garanton lirinë e asociimit, duke përfshirë "të drejtën e secilit për të krijuar një organizatë pa marrë asnjë leje, për të qenë ose jo anëtar i ndonjë organizate dhe për të marrë pjesë në aktivitetet e një organizate".

Në dhjetor të vitit 2017, Qeveria e Kosovës e miratoi projektligjin e ri për lirinë e asociimit të OJQ-ve, duke liruar kufizimet në aktivitetet e tyre dhe duke vendosur dispozita më të favorshme për lirinë e asociimit në krahasim me ligjin e mëparshëm. Ai u mirëprit si një lëvizje e rëndësishme në fuqizimin e shoqërisë civile dhe demokracisë në Kosovë.

Projektligji erdhi pas gati dy dekadash përpjekjesh për të përmirësuar kuadrin ligjor për organizatat e shoqërisë civile.



Transformation Atlas 2022

© Bertelsmann Stiftung 2023

Figura 13. Statusi i Demokracisë në Kosovë, sipas BTI 2023

Liria e tubimit në përgjithësi është mbrojtur nga qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i, por demonstratat janë kufizuar për arsye sigurie dhe rendit publik. OJQ-të në përgjithësi funksionojnë lirisht, por sipas kushtetutës, gjykatat mund të ndalojnë grupet dhe organizatat që "shkelin rendin kushtetues, shkelin të drejtat dhe liritë e njeriut ose inkurajojnë urrejtjen racore, kombëtare, etnike ose fetare", një dispozitë e cila është përdorur rrallë (BTI, BTI 2022 Country Report Kosovo, 2023).

Sipas kushtetutës garantohej liria e organizimit dhe e tubimit. Më shumë se 7,000 organizata qytetare/OJQ janë aktive në Kosovë, veçanërisht në politikat komunale, korrupsionin dhe çështjet mjedisore. Problemi mbetet se ndërhyrja në aktivitetet e OJQ-ve është ende e zakonshme. Protestat në rrugë janë një mjet i shpeshtë për të ushtruar presion ndaj qeverisë.

Liria e shprehjes dhe e medias garantohet me kushtetutë. Liria e shprehjes mund të kufizohet vetëm me ligj dhe vendim të Komisionit të Pavarur për Media (KPM). Në krahasim me Kosovën, Kroacia sipas raportit të fundit të V-Dem qëndron dukshëm më mirë sa i përket Demokracisë pjesëmarrëse, duke siguruar kështu nivel më të lartë në angazhimin në organizatat e shoqërisë civile, dalje në zgjedhje, demokracinë e drejtpërdrejtë dhe organet e zgjedhura lokale, paraqitur në Figurën 11 më lart.

5.1.5. Konkluzion dhe rekomandime

Nisur nga një histori që në shumë aspekte mund të konsiderohet e ngjashme, Kosova dhe Kroacia, si dy shtete që ndërtuan kornizën ligjore bazuar në parimet e Bashkimit Evropian, duket se kanë dallimet e tyre të ndjeshme në zhvillimin e demokracisë me fokus pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje.

Kroacia ka përparuar jo vetëm në fushën e zgjedhjeve të lira, por edhe në të drejtën e asociimit, duke pasur një demokratizim me një indeksim prej 8.3 nga 10 në total. Megjithatë, ajo ka ende nevojë të zhvillojë politika nxitëse për zgjedhjet dhe aktivizimin qytetar për ta mbajtur qeverinë të përgjegjshme dhe transparente. Ky sukses në ndërtimin e një sistemi demokratik të fortë e bën Kroacinë një shembull të ndritshëm, por ka akoma sfida që duhet të përballohen.

Në anën tjetër, edhe pse sistemi zgjedhor në Kosovë ka avancuar, zgjedhjet e shpeshta dhe të ndërlikuara nuk ndihmojnë në rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje. Shumë çështje politike shpesh kanë provokuar protesta dhe destabilizimin e situatës politike. Gjithashtu, edhe pse liria e asociimit garantohet me ligj, shumë subjekte konsiderohen ende të pavarura për të vepruar, prandaj indeksimi i demokracisë është 6.7, nga 10 gjithsej.

Zhvillimi i Politikave Nxitëse: Qeveria duhet të punojë mbi zhvillimin e strategjive dhe politikave që nxitin pjesëmarrjen e qytetarëve në zgjedhje dhe veprimtarinë civile.

Forcimi i Transparencës: Përmirësimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë qeveritare do të ndihmojë në ndërtimin e besimit ndaj institucioneve dhe do të forcojë demokracinë.

Stabilizimi i Procesit Zgjedhor: Është e rëndësishme që të vendoset një kornizë më e qëndrueshme dhe transparente për zgjedhjet, që do të nxisë pjesëmarrjen dhe do të ndihmojë në konsolidimin e demokracisë.

Mbështetja e Lirive të Asociimit: Garantimi dhe mbështetja e lirive të asociimit, duke eliminuar pengesat administrative dhe ligjore që ndalojnë veprimin e lirë të organizatave civile.

Promovimi i Dialogut dhe Stabilitetit: Është esenciale të fuqizohen mekanizmat për dialog dhe komunikim mes qeverisë dhe qytetarëve për të siguruar një ambient më të qëndrueshëm dhe të ndërtuar mbi parimet e demokracisë.

5.2. Rast studimi II: Rritja e Pjesëmarrjes Publike Gjimore në Demokracitë e Reja: Ndikimi i Normave Sociale në Proaktivitetin e Grave në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut

Studimet bashkëkohore të politikës nxjerrin në pah rëndësinë e aktivizimit publik dhe pjesëmarrjes në qeverisje. Këto mekanizma dhe formulimi i politikave publike nxisin ndërveprimin ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë, duke promovuar demokracinë, transparencën, kohezionin dhe gjithëpërfshirjen. Megjithatë, demokracitë e sapoformuara shpesh përballen me sfida në sigurimin e forumeve të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe në strukturimin e politikave efektive të përfshirjes gjimore. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e grave në politikë dhe sferën publike mbetet e ulët, me rolin gjinor që shpesh anashkalohet.

Ky rast studimi shqyrton ndikimin e pjesëmarrjes së publikut gjinor në demokracitë e sapokrijuara, duke shqyrtuar në mënyrë specifike se si normat sociale ndikojnë në proaktivitetin e grave në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Studimi shqyrton masat e zbatuara nga këto shtete për të siguruar pjesëmarrjen proaktive të grave dhe analizon kontributin e aktivizmit qytetar të grave nëpërmjet shoqërisë civile në ndërtimin e demokracive dhe sfidimin e normave tradicionale shoqërore. Duke pasur parasysh se Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë krijuar korniza ligjore të bazuara në parimet e

Bashkimit Evropian, ato shfaqin ngjashmëri sa i përket pjesëmarrjes gjinore publike dhe sistemeve politike shtetërore.

Përfundimet e nxjerra në këtë studim bazohen në analizën e raporteve ndërkombëtare, duke përfshirë Indeksin e Transformimit BTI, Raportet e Vendeve dhe Varietetet e Demokracive - Variablat Publike mbi Pjesëmarrjen Publike. Duke hedhur dritë mbi ndërveprimin midis pjesëmarrjes publike gjinore, normave sociale dhe zhvillimit të demokracive të sapokrijura, ky hulumtim kontribuon në kuptimin e strategjive efektive për rritjen e angazhimit të grave dhe promovimin e barazisë gjinore në sferat politike dhe publike.

5.2.1. Teoria e pjesëmarrjes gjinore

Shumë autorë argumentojnë nivelin që pjesëmarrja publike ka efektet e saj në shoqërinë e gjerë dhe rëndësia e të qenit gjithëpërfshirëse dhe përfaqësimi i shoqërisë duhet të strukturohet përmes politikave publike që përcaktojnë këtë kriter. Supozimi themelor nga teoricienët politikë, komentuesit socialë dhe madje edhe politikanët është se pjesëmarrja e publikut rrit besimin e publikut tek autoritetet, duke përmirësuar efikasitetin politik të qytetarëve, duke rritur idealet demokratike dhe madje duke përmirësuar cilësinë e vendimeve politike. Studimet e transformimit bëjnë përpjekje për të shpjeguar rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut në ndryshime të ndryshme politike, veçanërisht në ngritjen e vlerave demokratike. Ndjekja e faktorëve kyçë për demokratizim të suksesshëm në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, duke përfshirë shtetet e ish-Jugosllavisë, mungesa e një alternativë të besueshme ndaj demokracisë liberale; ndryshim i gjerë i elitave nëpërmjet zgjedhjeve demokratike; themelimi relativisht i fortë i shoqërisë civile dhe roli i tyre aktiv në ndryshimin e regjimit; dhe perspektiva e anëtarësimit në BE si orientim i përgjithshëm i reformave (Kaldor, 1997, pp. 59-82).

Njerëzit e zakonshëm kanë preferenca për atë që duhet të bëjë qeveria e tyre. Ata zgjedhin liderët që do t'i bëjnë ato gjëra, ose ata miratojnë preferencat e tyre drejtpërdrejt në referendume. Në secilin rast, ajo që dëshiron shumica bëhet politika e

qeverisë – një perspektivë shumë tërheqëse në dritën e shumicës së përvojës njerëzore me qeveritë (Achen, 2017, pp. 1-20).

Përvoja në zhvillimin pjesëmarrës e ka bërë të qartë se, nëse nuk ndërmerren hapa specifikë për të siguruar pjesëmarrjen e plotë të burrave dhe grave, gratë shpesh përjashtohen. Si rezultat, projektet dështojnë të përfitojnë nga kontributet e grave dhe nuk arrijnë të përmbushin nevojat dhe interesat e veçanta të grave. Shkaqet janë të ngulitura thellë në institucionet sociale dhe ligjore (Bank, 1995). Burrat dhe gratë luajnë role të ndryshme, kanë nevoja të ndryshme dhe përballen me kufizime të ndryshme për t'iu përgjigjur ndryshimeve të politikave makroekonomike ose sektoriale, si dhe ndaj mundësive specifike të ofruara nga projektet dhe programet e zhvillimit.

Pjesëmarrja e barabartë e burrave dhe grave varet nga masat strategjike, dhe ndryshimet e politikave institucionale, për të trajtuar shkaqet rrënjësore të pabarazive gjinore dhe për të hequr kufizimet për përfshirjen e grave në jetën publike (UN, United Nations Population Fund , 1994). Shumë vende në zhvillim (me përjashtim të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut) mbledhin dhe raportojnë sistematikisht statistika të ndara sipas gjinisë, ose kryejnë analiza sistematike gjinore. Hapi i parë drejt përfshirjes së çështjeve gjinore në procesin e politikëbërjes dhe përcaktimit të masave të duhura për forcimin e pjesëmarrjes së grave, është marrja e informacionit të mirë – mbi rolet gjinore, institucionet ekzistuese dhe kufizimet që veprojnë kundër pjesëmarrjes së grave – nëpërmjet një kombinimi të anketave sasiore dhe vlerësimeve cilësore sociale. Për të qenë efektive, vlerësimet duhet të hartohen në mënyrë specifike për të nxjerrë pikëpamjet e grave (Bamberger, 1995).

Sa i përket pjesëmarrjes së grave në politikë, Kosova ka bërë përpjekje për promovimin e barazisë gjinore dhe rritjen e përfaqësimit të grave në pozitat vendimmarrëse. Vendi ka zbatuar kuota për të siguruar një nivel minimal të përfaqësimit të grave në parlament dhe pushtetin vendor. Megjithatë, pavarësisht nga këto masa, pjesëmarrja politike dhe përfaqësimi i grave mbetet relativisht i ulët. Faktorë të ndryshëm, duke përfshirë normat

shoqërore, qasjen e kufizuar në burime dhe arsim, dhe barrierat kulturore, vazhdojnë të pengojnë angazhimin e plotë të grave në proceset politike.

Maqedonia e Veriut, si shumë vende në rajon, ka punuar për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë dhe pozita vendimmarrëse. Ndërkohë që ka pasur disa përparime, përfaqësimi i grave në politikë mbetet relativisht i ulët. Përpjekjet për të promovuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave janë në vazhdim, me iniciativa që synojnë rritjen e qasjen të grave në arsim, mundësitë ekonomike dhe pjesëmarrjen politike.

Raporti Global i Hendekut Gjinor 2021 demonstroi pozitën e vendit në fuqizimin politik të grave. Përderisa Maqedonia e Veriut qëndron në vendin e 13-të në krahasim me Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, nuk ka të dhëna të disponueshme për rastin e Kosovës, pasi vendi nuk i ka përmbushur kriteret (Forum, 2021). Për t'u përfshirë, një vend duhet të ketë të dhëna të fundit të disponueshme për të paktën 12 tregues nga 14 që përbëjnë indeksin. Nivelet më të larta të varfërisë së grave, qasja i kufizuar në financa, një pjesë më e madhe e detyrave të kujdesit të papaguar dhe sfidat me të cilat përballen në realizimin e shëndetit dhe të drejtave të tyre seksuale dhe riprodhuese, të kombinuara me rregullat dhe procedurat institucionale përjashtuese, dhe normat sociale diskriminuese gjinore kufizojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë, ndërsa pandemia Covid-19 ka përkeqësuar më tej pjesëmarrjen e tyre në jetën publike.

Tabela 4. Renditja e Indeksit Global të Hendekut Gjinor sipas rajonit, 2021

Eastern Europe and Central Asia

Country	Rank		Score
	Regional	Global	
Lithuania	1	8	0.804
Serbia	2	19	0.780
Latvia	3	20	0.778
Albania	4	25	0.770
Moldova	5	28	0.768
Belarus	6	33	0.758
Bulgaria	7	38	0.746
Slovenia	8	41	0.741
Croatia	9	45	0.733
Estonia	10	46	0.733
Montenegro	11	48	0.732
Georgia	12	49	0.732
North Macedonia	13	73	0.715
Ukraine	14	74	0.714
Poland	15	75	0.713
Bosnia and Herzegovina	16	76	0.713
Slovak Republic	17	77	0.712
Czech Republic	18	78	0.711
Kazakhstan	19	80	0.710

Sipas Bashkimit Evropian (EU, 2021), Kosova ka bërë disa zotime ligjore dhe politike për barazinë gjinore. Në vitin 2020, Kosova zgjeroi zotimet ekzistuese ndaj Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe barazinë gjinore në Kushtetutën e saj, duke përfshirë Konventën e Stambollit. Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë nuk përmendet në mënyrë eksplicite në ligjin e Kosovës, por qëllimet e saj janë të inkuadruara në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, në lidhje me vendimmarrjen, drejtësinë, paqen, sigurinë dhe pjesëmarrjen e barabartë në sektorin e sigurisë. I njëjti raport vlerëson se gratë, veçanërisht gratë e pakicave etnike, mbeten të nënpërfaqësuara në parlament (36.6%), kuvende (35%), qeveri (nën 34% të ministrave në të gjitha zgjedhjet dhe vetëm 20% të zëvendësministrave që nga viti 2008), administrata

publike (44% e nëpunësve civilë në nivel qendror, 33% në nivel lokal, 0 gra kryetare komune në 2017-2021), dhe institucionet e drejtësisë, veçanërisht në pozitë vendimmarrëse.




Figura 14. Indeksi i Transformimit Kosova Vs. Maqedonisë së Veriut 2022

Megjithatë, Indeksi i Transformimit për vitin 2021 e konsideron Kosovën si një vend me demokraci të dëmtuar, kështu që Kosova mbetet në vend më të ulët në krahasim me vendet e tjera evropiane dhe demokracitë e konsoliduara. Gratë kanë më pak përfaqësim si drejtuese publike lokale (BTI, Transformation Atlas, Democracy in Kosovo, 2022).

5.2.2. Mobilizimi i Grave, Angazhimet Qytetare dhe Sfidat shoqëruese

Që nga rënia e Jugosllavisë, shoqëria kosovare ka pësuar ndryshime të jashtëzakonshme. Në rrëfimin që tregon procesin e ngjarjeve që ndodhin në historinë bashkëkohore politike të Kosovës, zërat e grave mungojnë dukshëm. Prania e grave në sferën publike ka qenë tradicionalisht e ulët, por gratë kanë marrë pjesë aktive brenda strukturave gjatë viteve '90, por deri vonë roli i tyre nuk kishte marrë shumë vëmendje. Pavarësisht fokusimit më të madh në çështjet gjinore në Kosovën e pas vitit 1999, dhe futjes së legjislacionit të ri të gjerë që rregullon barazinë gjinore, roli i grave në shoqërinë kosovare ka mbetur marginal dhe sfera publike dhe politike ka vazhduar të dominohet nga burrat (Haug, 2015, f. 147). Vazhdimi i një hendeku serioz gjinor është identifikuar si një nga sfidat kryesore me të cilat përballlet shoqëria bashkëkohore kosovare sot.

Edhe pse Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë inkorporuar konventa dhe rregulla ndërkombëtare në sistemin e tyre kushtetues, duke përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25 (Të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara) i cili thotë se çdo qytetar ka të drejtën dhe mundësinë për të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike, drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; të votojnë dhe të zgjidhen në zgjedhje të vërteta periodike, të cilat do të jenë me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe do të mbahen me votim të fshehtë, duke garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve; Të ketë qasje, në kushte të përgjithshme të barazisë, në shërbimin publik në vendin e tij. Të dy vendeve u mungon pjesëmarrja në rritje e publikut në nivele të ndryshme të qeverisjes. Gratë luajtën një rol aktiv në luftën kombëtare për pavarësi, dhe që nga pavarësia, organizatat e grave, edhe pse të ndryshme në shtrirje dhe ideologji, u mobilizuan rreth çështjeve të ndryshme. Disa nga çështjet që nxitën aktorët e ndryshëm në lëvizjen e grave ishin dhuna ndaj grave dhe reformat e së drejtës fetare-personale. Ka pasur reagime kundër aktivizmit të grave për të drejtat e tyre, duke përfshirë dhunën dhe frikësimin e grave mbrojtëse të të drejtave të njeriut dhe OJQ-ve që mbështesin fuqizimin e grave, siç tregohet në grafikun mbi indeksin e pjesëmarrjes së grave në shoqërinë civile (V-Dem, Variable Graphs on Women Civil Society participation,

2022). Organizatat e themeluara feministe po përballen gjithashtu me sfida në tërheqjen e grave të reja në lëvizjen për të drejtat e grave.

Megjithatë, vetëm përmirësimi i kapitalit social të grave nuk mjafton për të përmbysur pritshmërinë sociale të gjatë për rolin e gruas në një shoqëri patriarkale. Brenda partive, anëtarët ekzistues (burra dhe gra) duhet të mbështesin kandidatet e ardhshme dhe të rejat. Kjo përpjekje mund të përhapet duke përfshirë komunitetin. Investimi i suksesshëm në lëvizjet dhe grupet e grave përmes mbështetjes së shoqërisë civile dhe financimit social do t'i ndihmojë këto organe të shërbejnë si hapësira të sigurta për gratë që të zhvillojnë aftësitë e tyre të avokimit politik, lidërshiptit dhe negocimit.




Figura 15. Pjesëmarrja e grave në shoqërinë civile, raporti V-Dem 2022

Shoqëritë më pak laike (d.m.th., më fetare) kanë pasur një korrelacion negativ me gratë në politikë (Alexander, 1993). Ndërsa shoqëritë sekularizohen, gratë janë më të lira dhe kanë një korrelacion pozitiv me përfaqësueset e zgjedhura femra. Feja është kulturalisht e rëndësishme në Kosovë dhe Maqedoni dhe në mënyrë aktive u jep mbështetje normave shoqërore patriarkale. Gratë që marrin pjesë në forcën e punës ose në politikë mund të

shihen negativisht në shoqëri për shkeljen e normave të pranueshme kulturore (përfshirë ato fetare). Kjo promovon një hierarki patriarkale të pushtetit që dekurajon sërish barazinë femërore dhe pjesëmarrjen politike. Diskriminimi ndër sektorial: Gratë nga grupet e marginalizuara, si grupet etnike të pakicave dhe gratë me aftësi të kufizuara, shpesh përballen me pengesa edhe më të mëdha për pjesëmarrjen nëpërmjet diskriminimit ndërsektorial (Inglehart, 2000). Në Kosovë, gratë nga komunitetet turke, ashkali, egjiptiane, gorane dhe rome mund të përballen me barrierë shtesë për pjesëmarrjen e tyre në politikën lokale (DiLanzo, 2019).

Normat patriarkale dhe tradicionale shoqërore mbizotërojnë në Maqedoninë e Veriut, duke i vendosur përgjegjësitë e grave në radhë të parë në shtëpi. Normat dhe besimet kulturore nuk ndryshojnë shumë sipas rajonit gjeografik, por ato ndryshojnë sipas përkatësisë etnike dhe janë më të theksuara në zonat rurale. Sipas studimeve në këtë fushë ka ende komunitete rurale ku gratë nuk lejohen të largohen nga shtëpitë apo fshatrat e tyre. Të dhënat gjithashtu theksuan se burrat shpesh merrnin pjesë në takime publike, edhe kur tubimet ishin të destinuara për gratë (Rita Boyajian Groh, p. 15).

5.2.3. Konkluzion

Futja e perspektivës gjinore në proceset pjesëmarrëse duhet të konsiderohet si një proces ndryshimi në marrëdhëniet e pushtetit dhe ndikimi në politikat publike në të dy vendet, dhe duhet të nxjerrë në pah karakteristikat specifike të grave dhe të identifikojë mekanizmat që gjenerojnë pabarazi. Pjesëmarrja e qytetarëve, e synuar për transformim social, mund të ketë efekte negative nëse nuk fuqizon gratë. Kështu, arsyetimi demokratik për përfshirjen e pikëpamjeve të grave dhe dëgjimin e njohurive dhe nevojave të tyre specifike është shumë i nevojshëm në demokracitë e sapokrijuara si rastet e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

Pjesëmarrja e fortë politike e grave është kritike për qeverisjen demokratike. Megjithatë, vajzat dhe gratë në mbarë botën vazhdojnë të jenë të marginalizuara nga sfera politike për shkak të ligjeve kufizuese dhe barrierave institucionale; praktikat diskriminuese

kulturore; dhe qasje në mënyrë joproportionale të ulët në arsim cilësor, kujdes shëndetësor dhe burime, dhe kjo situatë është edhe më e pranishme në shtetet e Ballkanit, përfshirë Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut.

Gratë, veçanërisht gratë e pakicave etnike, mbeten të nënpërfaqësuara në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe gjithashtu në sferën e shoqërisë civile, për shkak të normave sociale afatgjata që vendosin pengesë në aktivizmin dhe proaktivitetin e grave. Megjithatë, Indeksi i Transformimit për vitin 2021, e konsideron Kosovën si një vend me demokraci të dëmtuar, kështu që Kosova ende mbetet e ulët në krahasim me vendet e tjera evropiane dhe demokracitë e konsoliduara. Gratë kanë më pak përfaqësim si drejtuese publike lokale. Përfaqësimi ka rëndësi dhe është i një rëndësie të madhe për të frymëzuar gjeneratën e ardhshme të liderëve femra.

Për këtë qëllim, gratë parlamentare duhet të ndajnë përvojat e tyre publikisht për të normalizuar idenë e të pasurit gra në pozitat e pushtetit dhe mentorimin e vajzave dhe grave të reja për t'i ndihmuar ato të kenë qasje në hapësirat vendimmarrëse dhe pozitat e pushtetit. Media luan një rol vendimtar në nxjerrjen në pah të kontributeve pozitive të grave në politikë dhe shmangien e përjetësimit të stereotipave negative të bazuara në gjini. Gratë politike gjithashtu mund të fitojnë dukshmëri përmes mbështetjes nga shoqëria civile dhe udhëheqësve të tjera femra.

Gratë luajtën një rol aktiv në luftën kombëtare për pavarësi, dhe që nga pavarësia, organizatat e grave, megjithëse të ndryshme në shtrirje dhe ideologji, u mobilizuan rreth çështjeve të ndryshme. Varietetet e Demokracisë vlerësojnë se aktivizimi i grave përmes indeksit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile (V-Dem, 2022) mbetet jo në nivelin e kënaqshëm. Organizatat e themeluara feministe po përballen gjithashtu me sfida duke tërhequr gratë e reja në lëvizjen e djathtë të grave për shkak të rikthimit të dhunës dhe normave sociale, veçanërisht në zonat rurale. Kështu, shteti do të ndërtojë politika publike që përcaktojnë aktivizimin e grave në një nivel strukturor, të planifikuar dhe të organizuar mirë, duke ndikuar në arsim, fuqizim ekonomik dhe garanci për të drejtat e njeriut.

5.3. Rast studimi III: Procesi i konsultimit në nivel qendror: Konsultimet e MINT mbi projektligjet: për Sigurinë së Përgjithshme të Produkteve, për Inspektoratin e Tregut, si dhe për Metrologji

Hapja dhe transparenca e institucioneve për publikun janë faktorë kyçë në rritjen e llogaridhënies së institucioneve dhe performancës së administratës publike. Në Republikën e Kosovës, sistemi aktual i konsultimeve publike, i themeluar në vitin 2016, është në fazën e avancimit, përmirësimit dhe stabilitetit të procesit të politikëbërjes dhe hartimit të legjislacionit. Ky proces drejtohet dhe koordinohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe përkrahja vjen nga koordinatorët për konsultimet me publikun në Zyrën e Kryeministrit, si dhe në Ministrinë e Linjës dhe Komunitet e Kosovës.

Standarde të caktuara për konsultime me publikun janë përcaktuar në Rregulloren nr. 05/2016 dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, dhe tani këto standarde janë pjesë e punës së përditshme të institucioneve qeveritare, kurse kriteret janë paraqitur në tabelën nr. 5.

Tabela 5. Kriteret e vlerësimit sipas Rregullores për Standarde Minimale

Kriteret e vlerësimit sipas Rregullores për standardet minimale	–Secili dokument i konsultuar duhet të ketë planin e konsultimit
	Dokumentin e konsultimit duhet të jetë i publikuar në platformën elektronike për konsultimet publike
	–Afati i konsultimit duhet të jetë së paku 15 ditë punë
	–Raporti final i dokumentit të konsultuar dhe versioni i fundit i dokumentit të publikohet bashkë me raportin final

Monitorimi i zbatimit të procesit të konsultimeve është gjithashtu pjesë e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 (ZKM, 2019). Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit, ka arritur të ndajë me organizatat joqeveritare dhe publikun dokumentet që janë hartuar dhe janë përcjellë për aprovim në qeveri në platformën online <https://konsultimet.rks-gov.net/>. Kjo platformë ofron qasje për përfshirje, informim dhe mundësi për të dhënë

kontribut përmes komentimit dhe rekomandimeve për politikat dhe legjislacionin e hartuar nga institucionet publike.

5.3.1. Analiza e përgjithshme 2019 – 2022

2019 - Numri i përgjithshëm i dokumenteve të hartuara dhe të konsultuara: Është raportuar se gjatë procesit të konsultimeve publike gjithsejtë kanë marrë pjesë 3577 pjesëmarrës të cilët kanë bërë 1339 komente qoftë përmes takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim. Llogaritet se 688 ose 61% e tyre janë pranuar nga institucionet hartuese, 97 apo 7.2% prej tyre janë pranuar pjesërisht ndërsa 543 komente apo 4.50% janë refuzuar, ndërsa për 6 komente nuk ka informata nëse janë pranuar apo refuzuar (ZKM, Raporti vjetor për konsultime me publikun, 2020).

Nga Figura 16 më poshtë shihet se një numër relativisht i lartë, që kalon 32% janë konsultime të cilave u mungon raporti final i konsultimit, me që rast komentuesit/kontribuuesit nuk janë mbajtur të informuar në proces, dhe rrjedhimisht nuk dihet se a ka pasur ndryshime/përmirësime si rrjedhojë e komenteve të bëra në platformë, qoftë nga shoqëria civile, ekspertët, grupet e ndryshme të interesit apo qytetarët.

Plotësimi i standardeve: Vlerësohet se 183 dokumente apo 67% e dokumenteve të konsultuara i kanë plotësuar standardet minimale të cilat janë paraparë me rregullore, ndërsa 91 apo 33% të tyre nuk i kanë plotësuar këto standarde.

Metodat e përdorura: Të gjitha dokumentet e konsultuara gjatë vitit 2019 janë publikuar në platformë. Përveç publikimit në platformë, 103 dokumente (apo 37 % të numrit të përgjithshëm të dokumenteve të konsultuara) janë konsultuar edhe përmes punëtorive, ndërsa 99 dokumente apo 36% janë konsultuar përmes e-mailit. Përveç kësaj gjithashtu 35 dokumente apo 12.6% janë konsultuar edhe përmes takimeve publike, 24 dokumente apo 8.6 % janë konsultuar edhe përmes takimit sy më sy dhe 21 dokumente po 7.6% janë konsultuar përmes takimeve me grupe të interesit (ZKM, Raporti vjetor për konsultime me publikun, 2020).




Figura 16. % e konsultave publike me/pa raporte finale 2019. Burimi: Platforma online e konsultimeve

020 - Numri i përgjithshëm i dokumenteve të hartuara dhe të konsultuara: Nga fillimi i vitit 2020 deri në fund të vitit 2020 raportohet se janë hartuar 184 dokumente, ku 181 dokumente kanë qenë për konsultim publik në platformën online dhe tri dokumente që janë aprovuar në qeveri e të cilat nuk kanë qenë të publikuara në platformën për konsultime. Prej 184 dokumenteve janë: 16 koncept dokumente, 44 draft ligje, 2 strategji, 4 programe, 6 plane veprimi, 42 draft rregullore dhe 70 udhëzime administrative (ZKM, Raporti vjetor i konsultimit publik, 2020).




Figura 17. % e konsultave publike me/pa raporte finale 2020. Burimi: Platforma online e konsultimeve

Figura 17 pasqyron se mbi 35% të dokumenteve të konsultuara për vitin 2020 u mungon raporti final i konsultimit, me ç'rast komentuesit/kontribuuesit nuk janë mbajtur të informuar në proces, dhe rrjedhimisht nuk dihet se a ka pasur ndryshime/përmirësime si rrjedhojë e komenteve të bëra në platformë, qoftë nga shoqëria civile, ekspertët, grupet e ndryshme të interesit apo qytetarët.

Plotësimi i standardeve - Prej 181 dokumenteve të publikuara në platformë 115 prej tyre i plotësojnë standardet dhe 66 prej këtyre dokumente nuk i plotësojnë standardet. Tri dokumentet që janë jashtë platforme nuk i plotësojnë standardet për konsultim. Është raportuar se gjatë procesit të konsultimeve publike gjithsejtë kanë marrë pjesë 1021 pjesëmarrës. Nga këta pjesëmarrës gjithsejtë janë bërë 1898 komente qoftë përmes platformës, takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim. Llogaritet se 961 komente janë pranuar plotësisht nga hartuesit e dokumenteve, 463 komente janë pranuar pjesërisht dhe 474 komente janë refuzuar apo nuk janë pranuar nga institucionet hartuese (ZKM, Raporti vjetor i konsultimit publik, 2020).

Metodat e përdorura të konsultimit - Gjatë vitit 2020 në platformën për konsultimet me publikun janë publikuar 181 dokumente. Tri dokumente nuk janë konsultuar përmes platformës për konsultimet me publikun. Prej 181 dokumenteve 98 prej tyre janë konsultuar edhe përmes komunikimit zyrtar dhe 91 dokumente krahas platformës janë konsultuar edhe nëpërmes takimeve të punës, me shkrim, etj. Ndërsa 148 dokumente sipas raporteve kanë marrë kontribut apo janë komentuar nga publiku përmes komunikimit zyrtar dhe platformës (ZKM, Raporti vjetor i konsultimit publik, 2020).

2021 - Numri i përgjithshëm i dokumenteve të hartuara dhe të konsultuara - Nga fillimi i vitit 2021 deri në fund të vitit 2021 raportohet se janë hartuar 220 dokumente. Prej 220 dokumenteve janë: 19 koncept dokumente, 70 draft ligje, 06 strategji, 02 programe, 04 plane veprimi, 31 draft rregullore, 86 udhëzime administrative dhe 02 dokumentet tjera (një draft udhëzues i Zyrës së Kryeministrit dhe një draft statut i Ministrisë së Shëndetësisë) (ZKM, Raporti vjetor i konsultimit publik, 2021).

Figura 18 paraqet shkallën në përqindje të publikimeve të raporteve finale të konsultimit. Është shqetësuese se 32 % të dokumenteve të konsultuara për vitin 2021 u mungon raporti final i konsultimit, me ç'rast komentuesit/kontribuuesit nuk janë mbajtur të informuar në proces, dhe rrjedhimisht nuk dihet se a ka pasur ndryshime/përmirësime si rrjedhojë e komenteve të bëra në platformë, qoftë nga shoqëria civile, ekspertët, grupet e ndryshme të interesit apo qytetarët.




Figura 18. % e konsultave publike me/pa raporte finale 2021. Burimi: Platforma online e konsultimeve

Plotësimi i standardeve – Prej të gjitha dokumenteve të publikuara në platformë, 156 prej tyre ose 69,6% dhe 68 dokumente ose 30,4% prej tyre nuk i plotësojnë standardet minimale për konsultime me publikun. Është raportuar se gjatë procesit të konsultimeve publike gjithsejtë kanë marrë pjesë 2285 pjesëmarrës. Nga këta pjesëmarrës gjithsejtë janë bërë 1898 komente qoftë përmes platformës, takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim. Llogaritet se 961 komente janë pranuar plotësisht nga hartuesit e dokumenteve, 463 komente janë pranuar pjesërisht dhe 474 komente janë refuzuar apo nuk janë pranuar nga institucionet hartuese (ZKM, Raporti vjetor i konsultimit publik, 2021).

Metodat e përdorura të konsultimit - Gjatë vitit 2021 në platformën për konsultimet me publikun janë publikuar 220 dokumente. Shumica e dokumenteve që janë konsultuar në

platformë janë konsultuar edhe përmes komunikimit zyrtar dhe nëpërmes takimeve të punës, me shkrim, etj. (ZKM, Raporti vjetor i konsultimit publik, 2021).

2022 - Gjatë vitit 2022, janë avancuar modalitetet në platformën për konsultime dhe janë zhvilluar fushata informuese përmes ueb faqes dhe rrjeteve sociale për Platformën Online për Konsultimet Publike dhe Standardet Minimale për përfshirjen e qytetarëve në politikëbërje dhe vendimmarrje (Zyra për Qeverisje të Mirë, 2022). Synimi është rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve dhe publikut për përdorimin efektiv të Platformës Online për Konsultimet Publike, si dhe të forcimit, qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të sistemit të konsultimit publik, duke i përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile në politikëbërje dhe vendimmarrje.

Raportimi nga koordinatorët e nivelit qendror bëhet përmes formularëve të dizajnuar për mbledhjen e informatave për hartimin e raportit vjetor sipas Rregullores dhe (ZKM, Metodologjia e Monitorimit dhe Raportimit për zbatimin e standardeve minimale, 2017) të miratuar nga ZKM në vitin 2017 (Zyra e Kryeministrit, 2016). Numri i përgjithshëm i dokumenteve të hartuara dhe të konsultuara - Sipas statistikave të nxjerra për vitin 2022, janë publikuar 251 dokumente. Prej 251 dokumenteve janë: 23 koncept dokumente, 43 draft ligje, 16 strategji, 05 programe, 05 plane veprimi, 47 draft rregullore, 107 udhëzime administrative dhe 05 dokumente të tjera.

Plotësimi i standardeve - Prej 251 dokumenteve të publikuara në platformë janë gjithsejtë 247 dokumente për të cilat konsultimi publik është hapur nga 01/01/2022 dhe është mbyllur me 31/12/2022. Pra në platformë janë 247 dokumente, prej tyre 182 ose 74% i plotësojnë standardet dhe 65 dokumente ose 2 % prej tyre nuk i plotësojnë standardet minimale për konsultime me publikun.

5.3.2. Pjesëmarrja në proces të konsultimit dhe komentet

Është raportuar se gjatë procesit të konsultimeve publike gjithsejtë kanë marrë pjesë 3580 pjesëmarrës. Nga këta pjesëmarrës gjithsejtë janë bërë 3446 komente qoftë përmes platformës, takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim. Llogaritet se 1373 komente

janë pranuar plotësisht nga hartuesit e dokumenteve, 460 komente janë pranuar pjesërisht dhe 1493 komente janë refuzuar apo nuk janë pranuar nga institucionet hartuese.

5.3.3. Komentet direkt në platformën online dhe metodat e përdorura të konsultimit

Numri i komenteve të pranuar direkt në platformë gjatë vitit 2022 është 274. Pra nga 251 dokumentet të publikuara gjatë kësaj periudhe janë 50 dokumente të cilat janë komentuar me gjithsej 274 komente. Shumica e dokumenteve që janë konsultuar në platformë janë konsultuar edhe përmes komunikimit zyrtar, nëpërmes takimeve të punës, takimeve online, konsultimet me shkrim, etj.

Tabela 6. Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat e hapur gjatë periudhës -

Data: 01.01.2022 - 31.12.2022

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e hapura gjatë periudhës (që janë hapur gjatë periudhës) - Data: 01.01.2022-31.12.2022										
Institucioni / Tipi dokumentit	Koncept dokument	Draft ligji	Plan veprimi	Draft rregullore	Udhëzim administrativ	Strategji	Program	Tjetër	Totali	Në %
Zyra e Kryeministrit	2	1	0	1	1	4	3	0	12	4.78 %
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	3	3	0	13	2	0	0	1	22	8.76 %
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	2	5	1	0	20	4	0	1	33	13.15 %
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	0	5	0	4	15	1	0	0	25	9.96 %
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	4	0	1	0	2	1	0	0	8	3.19 %
Ministria e Mbrojtjes	0	4	0	12	0	0	0	0	16	6.37 %
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	1	3	1	1	9	1	0	0	16	6.37 %
Ministria e Shëndetësisë	1	2	0	0	8	0	0	2	13	5.18 %
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	5	2	0	0	20	0	1	0	28	11.16 %
Ministria e Ekonomisë	3	1	0	12	4	1	1	0	22	8.76 %
Ministria e Drejtësisë	2	9	1	0	11	1	0	1	25	9.96 %
Ministria për Kthim dhe Komunitete	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00 %
Ministria e Punëve të Brendshme	0	5	1	3	3	2	0	0	14	5.58 %
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	0	3	0	1	11	1	0	0	16	6.37 %
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00 %
Ministria e Zhvillimit Rajonal	0	0	0	0	1	0	0	0	1	0.40 %
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00 %

Totali	23	43	5	47	107	16	5	5	251	
---------------	-----------	-----------	----------	-----------	------------	-----------	----------	----------	------------	--

Plotësimi i standardeve minimale të konsultimeve publike shprehur në përqindje gjatë vitit 2022 është 74%. Pra, në platformë janë 247 dokumente, prej tyre 182 ose 74% i plotësojnë standardet dhe 65 dokumente ose 26 % prej tyre nuk i plotësojnë standardet minimale për konsultime me publikun. Numri më i madh i dokumenteve të cilat janë hartuar gjatë vitit 2022 i përkasin kategorisë së akteve nënligjore. Prej 247 dokumente janë: 25 koncept dokumente, 46 draft ligje, 16 strategji, 05 programe, 04 plane veprimi, 47 draft rregullore, 100 udhëzime administrative dhe 04 dokumente të tjera.

Pra, llogaritet se gjatë procesit të konsultimeve publike gjithsejtë kanë marrë pjesë 3580 pjesëmarrës. Nga këta pjesëmarrës gjithsejtë janë bërë 3446 komente qoftë përmes platformës, takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim. Llogaritet se 1373 komente janë pranuar plotësisht nga hartuesit e dokumenteve, 460 komente janë pranuar pjesërisht dhe 1493 komente janë refuzuar apo nuk janë pranuar nga institucionet hartuese.

Vlen të theksohet fakti se jo të gjitha dokumentet e konsultuara kanë edhe raport final. Në figurën 20 paraqitur më poshtë, vërehet se 26.7 % të dokumenteve të publikuara nuk kanë publikuar raportin final, rrjedhimisht nuk ka transparencë tek shqyrtimi i komenteve të pranuar ose refuzuara, arsyet/analizat e pranimi/refuzimit si dhe ndryshimet si shkak i konsultimit.




Figura 19. Statistika e dokumente të publikuara sipas institucioneve (qendrore). Burimi: Platforma e konsultimeve publike

“Qeveria e Kosovës, përmes platformës së konsultimit online ka përmirësuar shërbimet e përfshirjes së shoqërisë civile, ekspertëve dhe grupeve të interesit në politikëbërje, megjithatë ka ndryshime shume drastike në disa procese” (Ejupi, 2023). “Një shembull negativ është procesi i konsultimit publik lidhur me Projektligjin për Pagat në sektorin publik në Kosovë. Fokusi kryesor është tek mungesa e transparencës” (Ejupi, 2023).

Procesi i konsultimit publik është një mjet thelbësor për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit në vendimmarrjen ligjore. Fillimi i procesit konsiston në publikimin e Projektligjit për Pagat, duke i lejuar kështu qytetarët dhe organizatat interesante të shprehin komentet e tyre. Projektligji është publikuar për komentim më datën 15.09.2022 (Platforma e Konsultimeve, 2022). Gjatë periudhës konsultative, një numër prej 31 komentesh janë pranuar, pjesëmarrja e këtillë është një shenjë e rëndësishme e përfshirjes së qytetarëve në proces. Komentet e pranuar reflektojnë shqetësime dhe rekomandime të ndryshme nga qytetarët, shoqëria civile dhe zyrtarët e sektorit publik. Megjithatë, edhe pse është mbyllur procesi i konsultimit, ende nuk është publikuar në platformë raporti final i konsultimit, i cili duhet të përmbajë një analizë gjithëpërfshirëse të komenteve të pranuar, si dhe arsyetimet e pranimit ose refuzimit të tyre.




Figura 20. % e konsultave publike me raportet finale 2022. Burimi: Platformë e konsultimit publik

“Mungesa e raportit final ka krijuar një situatë problematike. Qytetarët dhe pjesëmarrësit e tjerë nuk kanë pasur mundësinë të shohin se si janë trajtuar dhe vlerësuar komentet e tyre. Kjo mungesë e transparencës ka ulur besimin dhe angazhimin e tyre në procesin ligjor” (Ejupi, 2023). Si rezultat, procesi i konsultimit publik është i paqartë dhe ka mundur të ketë ndikim negativ në legjitimitetin e Projektligjit për Pagat.

Për të rregulluar këtë situatë dhe për të siguruar një proces më transparent dhe të llogaridhënies, autoritetet përgjegjëse duhet të adresojnë këtë mangësi. Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim është publikimi i raportit final të konsultimit. Ky raport duhet të përmbajë të gjitha komentet e pranuar dhe të ofrojë arsyetimet e plota për pranimin ose refuzimin e tyre. Në këtë mënyrë, pjesëmarrësit do të kenë informacion të plotë dhe të detajuar rreth trajtimit të komenteve të tyre dhe mënyrës se si ato janë vlerësuar. Publikimi i raportit final të konsultimit do të sjellë transparencë dhe llogaridhënie në procesin e konsultimit publik. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të shohin se si janë trajtuar komentet e tyre dhe të kuptojnë arsyetimin për vendimet e marra. Kjo do të rrisë besimin e tyre në procesin ligjor dhe do të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në të ardhmen.

5.3.4. Konsultimet Publike në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - MINT

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, realizon konsultimin publik në përputhje me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara. Megjithatë konsultimi shfaq dallime në mënyrën se si ky proces realizohet për projektligje të ndryshme. Në vitin 2022, Ministria ka publikuar në total 25 dokumente në platformën online të konsultimit, duke arritur një përmbushje prej 100% të dokumenteve të parashikuara për konsultim publik. Megjithatë, mënyra e zbatimit të konsultimit paraqet një aspekt të rëndësishëm për analizën tonë. Nga 25 dokumentet e publikuara për konsultim publik, 24 prej tyre kanë publikuar raportin final të konsultimit (Zyra për Qeverisje të Mirë, 2022).

Njëra nga metodat e përdorura për konsultimin publik është konsultimi me shkrim përmes platformës online. Kjo metodë, megjithëse e përputhur me rregulloret dhe udhëzuesin për konsultimin publik, lë për të dëshiruar në aspektin e pjesëmarrjes së gjerë dhe të barabartë të publikut. Është e rëndësishme të vlerësojmë nëse kjo metodë lejon qytetarët dhe palët e interesit të ndikojnë në procesin vendimmarrës në mënyrë të njëjtë dhe të drejtë. Për të kuptuar këtë, duhet të verifikojmë se sa mirë janë adresuar dhe marrë parasysh rekomandimet dhe mendimet e publikut në dokumentet e finalizuara.

Nëse këto rekomandime dhe mendime nuk janë përcjellë në mënyrë të plotë dhe të saktë, mund të konsiderohet se ka një mangësi në zbatimin e konsultimit publik.

Një dallim tjetër në procesin e konsultimit publik vjen nga shfrytëzimi i metodave të ndryshme. Në disa ligje, përveç konsultimit me shkrim, janë përdorur edhe metoda të tjera si takimet publike, grupet e punës apo konsultime me palët e ndryshme të interesit. Është e rëndësishme të vlerësojmë efektivitetin e këtyre metodave shtesë dhe ndikimin që ato kanë në pjesëmarrjen e publikut dhe shprehjen e opinionit. Nëse metoda të tjera kanë mundësi për përmirësim, atëherë duhet të analizojmë se si ato mund të përdoren dhe të inkorporohen në procesin e konsultimit publik.

Përparësitë e procesit të konsultimit publik në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përfshijnë:

- Publikimi i dokumenteve në platformën online të konsultimit: Publikimi i dokumenteve në një platformë të qasshme online siguron transparencë dhe lejon qytetarët dhe palët e interesit të kenë një qasje të lehtë në informacionet relevante.
- Mundësia e pjesëmarrjes së gjerë: Platforma online e konsultimit ofron mundësinë për qytetarët, organizatat dhe palët e interesit të tjerë të shprehin opinionet dhe sugjerimet e tyre. Kjo ndihmon në inkorporimin e shumë pikëpamjeve dhe kontributit të gjerë të publikut në procesin vendimmarrës.
- Zbatimi i rregulloreve dhe procedurave të përcaktuara: Ministria ka arritur të respektojë rregulloret dhe procedurat për konsultimin publik, duke e bërë procesin më transparent dhe të rregullt. Publikimi i dokumenteve në platformë dhe pranimi i komenteve nga publiku tregon angazhimin për zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik.

Megjithatë, ka disa të meta dhe sfidat që mund të identifikohen në procesin e konsultimit publik:

- Mungesa e pjesëmarrjes së barabartë: Edhe pse platforma online lejon pjesëmarrjen e gjerë, është e rëndësishme të vlerësojmë nëse të gjitha grupet e interesit kanë

mundësinë reale për të marrë pjesë. Është e mundur që disa grupet të jenë më pak të përfshira në proces/në disavantazh në krahasim me grupet e tjera.

- Përcjellja e rekomandimeve të publikut: Është e rëndësishme të vlerësohet nëse rekomandimet dhe mendimet e publikut janë marrë parasysh në mënyrë të plotë dhe të saktë në dokumentet e finalizuara. Nëse ky nuk është rasti, atëherë konsultimi publik mund të ketë vetëm një rol formal dhe të mungojë efektiviteti i tij.
- Përdorimi i metodave të ndryshme: Një dallim në përdorimin e metodave të konsultimit publik mund të krijojë një mungesë të konsistencës në proces.

Është e rëndësishme të përcaktohet nëse përdorimi i metodave të ndryshme është i arsyeshëm dhe i përputhshëm me natyrën e çështjes që po trajtohet. Nëse disa projektligje janë konsultuar vetëm përmes platformës online, ndërsa të tjerat kanë përdorur edhe metoda të tjera si takimet publike, grupet e punës, ose konsultime me grupe të ndryshme interesit, duhet të analizojmë arsyet e këtij dallimi.

Gjithashtu, në të studim rasti vlerësojmë se si këto metoda të ndryshme kanë ndikuar në pjesëmarrjen dhe shprehjen e opinionit të publikut. Nëse një metodë është më efektive për të siguruar pjesëmarrjen e përgjithshme të publikut dhe për të dëgjuar sa më shumë pikëpamje të ndryshme, atëherë mund të konsiderohet si një praktikë më e mirë për t'i dhënë zë publikut.

Për të adresuar këto çështje dhe përmirësuar procesin e konsultimit publik në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, propozohen disa hapa:

1. Rritja e pjesëmarrjes aktive: Në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja më e gjerë e publikut, duhet të përdoren metoda të ndryshme të komunikimit dhe informimit, përveç platformës online. Takimet publike, grupet e punës apo konsultimet me interesantë të ndryshëm mund të jenë mjetet efektive për të inkurajuar pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm dhe për të dëgjuar çështjet specifike që ata përfaqësojnë.
2. Përcjellja e rekomandimeve të publikut: Është e rëndësishme që Ministria të sigurojë një proces të përcaktuar dhe transparent për marrjen e rekomandimeve

dhe mendimeve të publikut. Rekomandimet e bëra nga publiku duhet të jenë të dokumentuara dhe të përdoren për të përmirësuar dokumentet e finalizuara.

3. Rregullimi i konsistencës në metodat e konsultimit publik: Ministria duhet të sigurojë konsistencë në përdorimin e metodave të konsultimit publik. Përdorimi i një përcaktimi të qartë për zgjedhjen e metodave të përdorura mund të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes dhe zhvillimin e transparencës dhe llogaridhënien.

Megjithatë, për të parë më qartë këto dallime, përparësi e dobësi, do të analizojmë më gjerësisht tri procese në draftim të tri projektligjeve nga MINT.

Procesi i konsultimit për Projekt Ligjin për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve

Kjo pjesë paraqet analizën mbi konsultimin për hartimin e "Projektit të Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve" në Kosovë. *"Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Departamenti i Industrisë, ka propozuar hartimin e këtij ligji me qëllim për të përafruar legjislacionin e Kosovës me atë të Bashkimit Evropian dhe për të rritur mbrojtjen e konsumatorëve në përputhje me standardet evropiane"* (Kastrati, 2023).

Arsyeja kryesore për hartimin e këtij ligji është krijimi i një baze ligjore funksionale dhe lehtë të zbatueshme për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore. Ligji synon të sigurojë vendosjen në treg të produkteve të sigurta dhe të parandalojë prodhimin, importin dhe vendosjen në treg të produkteve mashtruese. Këtu përfshihen edhe obligimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe programi kombëtar për zbatimin e saj në Kosovë.

Procesi i konsultimit në hartimin e ligjit

Procesi i konsultimit në hartimin e ligjit është shoqëruar me një proces konsultimi publik për të marrë në konsideratë mendimet dhe rekomandimet e palëve të interesit. *"MINT, si organ propozues i këtij akti ligjor ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike në të cilën periudhë e ka dërguar në Konsultim të gjitha institucionet përkatëse dhe shoqatat relevante, që t'ju ofrojë informata për publikun e në veçanti për grupet e interesit me qëllim të merret mendimi i publikut dhe grupeve të interesit rreth hartimit të*

“Projekt Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve”. Kohëzgjatja e procesit të konsultimit të dokumentit në fjalë, është bërë komfor Rregullores për Punën e Qeverisë nr. 09/2011” (Kastrati, 2023).

Raporti i procesit të konsultimit publik i cili hartohet pasi të përfundojë periudha e konsultimit publik pasqyron në detaje komentet e dhëna dhe adresimin e tyre nga MINT, dokument ky i cili bëhet publik në platformën e konsultimeve. Sipas kryesuesit të grupit punues për draftim të projektligjit, raporti u dërgohet të gjitha palëve të përfshira pjesë e kontakt listës që MINT ka, përveç kësaj, Projektligji është vendosur në platformën e konsultimeve publike së bashku me dokumentin e konsultimit në të cilin është përshkruar rëndësia e hartimit të Projektligjit.




Figura 21. Numri i të ftuarve vs. kontributet

Për shkak të specifikës së fushës në procesin e hartimit të projekt-ligjin MINT ka angazhuar ekspertë të BE-së në kuadër të projekteve të financuara nga fondet e IPA II (Kastrati, 2023). *“Mungesa e ekspertëve vendorë, konsultimi me bizneset të cilat ndikohen, e të cilat kryesisht hezitojnë të përfshihen në draftim apo adresim të komenteve, është sfidë për institucionet, këto palë kryesisht reagojnë në zbatim të një politike publike”* (Kastrati, 2023).

Metodat e konsultimit

Ky proces ka përfshirë vetëm Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike; (MINT, 2022). Ministria ka marrë komente nga Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) gjatë konsultimeve publike. Në tabelën e dhënë në dokument, përfshihen detaje rreth kontribuuesve të konsultimit, përgjigjeve të pranura dhe të refuzuara nga Ministria. Dokumenti i mësipërm pohon se procesi i konsultimit ka përdorur vetëm konsultimin me shkrim/në mënyrë elektronike dhe jo metodat e tjera të konsultimit. *“INDEP po ashtu konfirmon se interesi i tyre për të kontribuar në proces të konsultimit publik në këtë projektligj vjen kryesisht për shkak të punës shumëvjeçare që INDEP zhvillon me MINT, dhe transparencës së procesit”* (Ejupi, 2023).

Tabela 7. Metodat e përdorura të konsultimit të pasqyruar në raportin final, MINT 2022

Metodat e konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i pjesëmarrësve të cilët kanë kontribuar	Numri i komenteve të pranura
1. Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike	Data e fillimit: 22 prill Data e përfundimit: 18 maj 2021 15 ditë pune	19	1	8

Kjo mund të sjellë disa sfida dhe ndikime të mundshme në procesin e konsultimit për mungesën e përdorimit të metodave të tjera të konsultimit.

Mangësitë gjatë konsultimit

Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike: kur kjo metodë nuk përdoret, ka mundësi që informacioni dhe konsultimi i propozimeve të jetë i vështirësuar për një audiencë më të gjerë. Nëse dokumenti i konsultimit është publikuar vetëm në ueb faqe ose platforma elektronike, mund të ketë kufizime në qasjen e pjesëmarrësve potencialë që nuk kanë qasje në internet ose nuk kanë ndjekur procesin në platforma të caktuara.

Takimet publike: Mospërdorimi i takimeve publike mund të kufizojë mundësinë e pjesëmarrësve për të marrë pjesë aktivisht, të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në diskutime të drejtpërdrejta. Kjo mungesë mund të çojë në mungesë të informacionit të rëndësishëm dhe mundësi të kufizuara për pjesëmarrjen e pjesëmarrësve në formimin e vendimeve dhe politikave.

Konferencat: Mungesa e përdorimit të konferencave mund të kufizojë mundësinë për të ndarë informacione të rëndësishme dhe për të diskutuar tema specifike me ekspertët dhe pjesëmarrësit në një ambient të mbledhjes së përbashkët. Kjo mungesë mund të ndikojë në nivelin e detajit dhe cilësinë e diskutimeve të përgjithshme.

Takimet me grupe të interesit: Mospërdorimi i takimeve me grupet e interesit mund të rezultojë në mungesë të perspektivave të rëndësishme dhe informacionit nga këto grupe. Pjesëmarrja e grupeve të interesit mund të sjellë informacion të specializuar dhe të ndihmojë në formimin e politikave të bazuara në nevojat dhe prioritetet e tyre.

Punëtoritë: Mungesa e përdorimit të punëtorive mund të kufizojë angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive të individëve në zhvillimin e ideve dhe propozimeve. Punëtoritë janë mjet efektiv për të lejuar bashkëpunimin dhe krijimin e lidhjeve të reja midis pjesëmarrësve.

Intervistat/takimet sy në sy: Mospërdorimi i intervistave ose takimeve sy në sy mund të kufizojë mundësinë për të zhvilluar njohjen më të thellë me individët, për të marrë informacion të personalizuar dhe për të kuptuar më mirë nevojat dhe pikëpamjet e tyre.

Hulumtimet e opinionit: Mospërdorimi i hulumtimeve të opinionit mund të rezultojë në mungesë të perspektivave të gjera dhe vlerësimeve të pjesëmarrësve potencialë. Hulumtimet e opinionit ofrojnë një mjet të strukturuar për të mbledhur dhe analizuar mendimet dhe preferencat e pjesëmarrësve në mënyrë sistematike.

Panelet me qytetarë: Mospërdorimi i paneleve me qytetarë mund të kufizojë pjesëmarrjen e qytetarëve në diskutimet dhe vendimmarrjen në lidhje me çështjet e

rëndësishme. Panelet me qytetarë ofrojnë një mënyrë për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive dhe për të reflektuar mangësitë e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Duke u nisur nga analiza kritike e mungesës së përdorimit të metodave të konsultimit, projektligji mund të ketë kufizime në pjesëmarrjen dhe përfshirjen e grupeve të interesit dhe ekspertëve, që mund të ndikojnë në nivelin e informacionit dhe cilësinë e tij. Rekomandohet që në të ardhmen të përdoren metodat e tjera të konsultimit për të siguruar një pjesëmarrje më të gjerë dhe një proces më të plotësuar të konsultimit.

Analizë e konsultimit publik për hartimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-037 për Metrologji

Raporti publik i konsultimit fillon me një përshkrim të sfondit dhe qëllimit të projektligjit. Një analizë kritike e kësaj pjese tregon se nuk ka informacion të mjaftueshëm se pse është propozuar kjo ligjshmëri dhe se si do të ndikojë në fushën e metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut. Mungesa e këtij informacioni mund të pengojë pjesëmarrjen dhe kontributin e pjesëmarrësve në procesin e konsultimit.

Ecuria e procesit të konsultimit

Raporti thekson se procesi i konsultimeve është zhvilluar në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet për procesin e konsultimit publik. Megjithatë, raporti nuk jep informacion të mjaftueshëm rreth analizave të kryera për të vlerësuar efektivitetin dhe ndikimin e konsultimit. Mungesa e rezultateve të hulumtimeve mund të vështirësojë përcaktimin e nivelit të pjesëmarrjes dhe kontributit të pjesëmarrësve në proces.

Metodat e konsultimit

Raporti përmend disa metoda të konsultimit, si konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike dhe publikimin në ueb faqe/platforma elektronike. Megjithatë, nuk jepet informacion se si janë përdorur këto metoda dhe cilat janë rezultatet e tyre. Një analizë kritike tregon mungesën e metodave të tjera të konsultimit, si takimet publike, takimet

me grupe të interesit, intervistat, hulumtimet e opinionit, panelet me qytetarë, që mund të kenë ndikuar në nivelin e pjesëmarrjes dhe diversitetin e kontributeve.

Përmbledhje e kontributeve të pranuara

Raporti konstaton se nuk ka pasur kontribute të pranuara gjatë procesit të konsultimit. Ky informacion është i dobishëm për të vlerësuar pjesëmarrjen dhe kontributin e pjesëmarrësve. Megjithatë, nuk jepen shpjegime për arsyen pse nuk ka pasur kontribute dhe nëse kjo është një reflektim i vërtetë i pjesëmarrjes së kufizuar ose një shprehje e mungesës së efektivitetit të metodave të konsultimit.

“Theksohet se sfida mbetet vetëdijesimi por dhe niveli i gatishmërisë për kontribut nga grupet e ekspertëve ose akademia, duke mos pasur interesim që t’i lexojnë dhe t’i kuptojnë projektligjet si dhe të japin komente me qëllim që të përmirësohet cilësia e tyre” (Hajdari, 2023).

Mangësitë e procesit të konsultimit

Në përgjithësi, raporti i konsultimit ka disa mungesa që vështirësojnë vlerësimin e procesit dhe kontributit të pjesëmarrësve. Mungesa e informacionit të mjaftueshëm për qëllimin e projektligjit dhe mungesa e hulumtimeve për të vlerësuar efektivitetin e metodave të konsultimit janë disa nga këto mungesa. Rekomandohet që në të ardhmen të jepen informacione më të plotë dhe të përdoren metoda të ndryshme të konsultimit për të siguruar pjesëmarrjen dhe kontributin e gjerë të interesit në procesin e konsultimit.




Figura 22. Të ftuarit vs kontributdhënësit. Ligji për Metrologji

Procesi i konsultimit të draftit të Projektligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut

Procesi i konsultimit të draftit të Projektligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut është një aspekt kyç në hartimin e politikave dhe legjislacionit të ri. Analiza e procesit të konsultimit është e rëndësishme për të vlerësuar pjesëmarrjen, efektivitetin dhe ndikimin e këtij procesi në krijimin e një ligji të mirëfilltë dhe të pranueshëm nga pjesëmarrësit dhe grupet e interesit. Në vijim, analizohet me gjerësi procesi i konsultimit dhe identifikohen aspektet kritike të tij.

Ecuria e procesit të konsultimit

Raporti i konsultimi i publikuar prezanton ecurinë e procesit të konsultimit. Në bazë të rregullores për Punën e Qeverisë dhe udhëzimeve për procesin e konsultimit publik, Ministria ka zhvilluar procesin e konsultimit në mënyrë komfore. MINT, si organ propozues i këtij akti ligjor ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike në të cilën periudhë e ka dërguar në konsultim të të gjitha institucionet përkatëse dhe shoqatat relevante, që t’ju ofrojë informata për publikun e në veçanti për grupe të

interesit me qëllim të merret mendimi i tyre. Kohëzgjatja e procesit të konsultimit është bërë komfor Rregullores për Punën e Qeverisë nr. 09/2011.




Figura 23. Të ftuarit vs. kontributdhënësit. Ligji për Inspektoriatin e Tregut

Metodat e konsultimit të përdorura

Gjatë procesit të konsultimit të projektligjit, janë përdorur konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike, publikimi në ueb faqe/platforma elektronike, takime me grupe të interesit dhe punëtoritë. Këtë e konfirmon edhe Inspektorati i Tregut se gjatë “procesit të konsultimit publik lidhur me Ligjin për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, MINT ka përdorur katër (4) metoda kryesore të konsultimeve publike” (Zyrtar, 2023):

Tabela 8. Metodat e përdorura të konsultimit publik, raporti final i konsultimit, MINT 2022

Metodat e Konsultimit	Datat/ kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i pjesëmarrësve të cilët kanë kontribuar	Numri i komenteve të pranuar
Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike;	27.10.2022 / 15 dite pune	20	1	5
Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike	03.11.2022 – 25.11.2022		6	33
Takime me grupe të interesit	03.10.2022 – takimi me USAID	4		
Punëtoritë	16 -18.09.2022	7		

Konsultimet me shkrim/ në mënyrë elektronike: - Ekziston një listë me zyrtarët kryesorë administrativë në të gjitha ministritë si dhe disa nga organizatat kryesore joqeveritare, tek të cilët është përcjell projektligji. Zakonshëm kjo metodë nuk prodhon rezultate konkrete meqë rrallë ndodh të pranohen komente. Në rastin konkret janë pranuar 5 komente përmes e-mail.

Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike: - Publikimi në platformën për diskutime publike është metoda më e përdorur aktualisht përmes së cilës zakonisht pranohen komente nga shoqëria civile, të cilët janë aktivë në monitorimin e hartimit të legjislacionit. “Në rastin konkret janë pranuar 33 komente përmes kësaj platforme” (Zyrtar, 2023).

Takime me grupe të interesit: - Takimet me grupet e interesit janë më të theksuara në rastet kur hartohen rregullore teknike të cilat afektojnë drejtpërdrejt një kategori të caktuar të komunitetit/bizneseve/konsumatorëve. Në rastin kur hartohen Ligji funksional për organe të caktuara të administratës shtetërore, kryesisht grupe të interesit konsiderohen OJQ-të, të cilat monitorojnë funksionimin e administratës shtetërore. “Në rastin konkret është realizuar një takim me përfaqësues të USAID, pasi që ata e kanë monitoruar nga afër hartimin e këtij projektligji” (Zyrtar, 2023).

Punëtoritë: - Punëtoritë zakonisht mbahen me grupin punues të përcaktuar për hartimin e aktit të caktuar ligjor. Në rastin konkret është organizuar një punëtori tre ditore me grupin punues për hartimin e Ligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Në përgjithësi, numri i pjesëmarrësve në konsultimet me shkrim është shumë i ulët dhe kjo mund të tregojë mungesë motivimi dhe informacioni të pamjaftueshëm për pjesëmarrjen.

Mangësitë e procesit të konsultimit

Raporti tregon se ka pasur disa komente dhe kontribute nga palët e interesit gjatë procesit të konsultimit. Megjithatë, raporti nuk jep informacion të mjaftueshëm rreth përdorimit të metodave të tjera të konsultimit, si takimet publike, intervistat, hulumtimet e opinionit, etj. Në analizën e procesit të konsultimit është e rëndësishme të përfshihen të gjitha metodat e përdorura dhe të vlerësohet pjesëmarrja dhe ndikimi i tyre në krijimin e ligjit. Edhe kontributdhënësit të cilët janë intervistuar theksojnë nevojën për përdorimin e metodave të tjera *“Përmes publikimit të Projektligjit në platformën e konsultimeve, MINT e ka shfrytëzuar metodën e zakonshme të konsultimit, duke i respektuar afatet dhe procedurat e tjera relevante. Megjithatë, mendoj se të gjitha institucionet, përfshirë MINT-in mund të punojnë ende më shumë për t’i përfshirë të gjitha grupet e interesit në diskutim edhe gjatë hartimit të legjislacionit por edhe pas”* (Begolli, 2023).

Kohëzgjatja e procesit të konsultimit është një aspekt tjetër që duhet të analizohet me kujdes. Raporti nuk jep detaje të mjaftueshme rreth kohëzgjatjes së procesit të konsultimit, si dhe nuk përmendet nëse ka pasur përpjekje për të zgjeruar periudhën e konsultimit për të siguruar një pjesëmarrje më të gjerë dhe kontribut më të madh nga pjesëmarrësit.

Për të përmirësuar procesin e konsultimit, është e rekomandueshme që Ministria të përmirësojë hyrjen duke përfshirë një përshkrim të qartë të problemit dhe qëllimit të ligjit. Gjithashtu, është e rëndësishme të përmirësohet transparenca në përdorimin e

metodave të ndryshme të konsultimit për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe kontributin më të madh të pjesëmarrësve.

Po ashtu, një ndër kontribuuesit e projektligjit thekson se *“duke e rritur transparencën, para, gjatë dhe pas hartimit të projekt ligjit, duke e ngritur numrin e profesionistëve të fushës në grupet punuese, të identifikohen zyrtarë publikë të cilët kanë vullnet dhe dëshirë të kontribuojnë në fushat përkatëse, njoftimet për fazat në të cilat gjendet projekt ligji apo aktet e tjera nënligjore në fuqi të jenë më transparente, të arsyetohen mirë, miratimi apo refuzimi i komenteve të qytetarëve apo kujt do qoftë, t’u ofrohet mundësia më e lehtë dhe më e thjeshtë e të gjithë atyre personave që mund dhe dëshirojnë të japin komente/sugjerime, mund të ndikojë pozitivisht në proces”* (Hoxha, Udhëheqës i Sektorit, Inspektorati i Tregut, komentues i Ligjit, 2023).

Përveç aspekteve kritike të identifikuara më sipër, procesi i konsultimit për draftin e Projektligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut ka edhe disa anë pozitive që vlejnë të theksohen:

Përdorimi i metodave të ndryshme të konsultimit: Ministria e Industrisë, Ndarjes dhe Tregtisë ka përdorur konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike, publikimin në ueb faqe/platforma elektronike, punëtoritë dhe takimet me grupe të interesit. Këto metoda ofrojnë një mundësi për të arritur një audiencë më të gjerë dhe për të mbledhur kontribute nga individët dhe organizatat që mund të kenë interes në ligjin e propozuar.

Pjesëmarrja e palëve të interesit: Raporti përmend pjesëmarrjen e disa palëve të interesit, si ZL-ZKM, USAID, OEK, DIC, Një Inspektor i Tregut dhe një qytetar. Pjesëmarrja e palëve të interesit është e rëndësishme për të siguruar perspektivat e ndryshme dhe për të marrë kontribute të rëndësishme në hartimin e ligjit.

Zgjerimi i pjesëmarrjes publike: Publikimi i draft ligjit në ueb faqe ose platforma elektronike, si dhe afati i dhënë për të dhënë kontribute dhe komente, mund të kenë ndihmuar në rritjen e pjesëmarrjes së publikut. Kjo mund të jetë shenjë e një përpjekjeje

për të siguruar transparencë dhe për të inkurajuar ndikimin e qytetarëve në procesin e hartimit të ligjit.

Ndarja e informacionit: Ministria ka ofruar informacione në lidhje me procesin e konsultimit, duke përfshirë datat dhe metodat e përdorura. Komentet e dhëna, dhe arsyet për pranim ose mos pranim të komentit. Kjo transparencë ndihmon në informimin e pjesëmarrësve dhe ndërton besim ndaj procesit të konsultimit.

Duke identifikuar këto anë pozitive, është e rëndësishme që Ministria të vazhdojë të përmirësojë procesin e konsultimit duke përdorur më shumë metoda të përshtatshme të konsultimit, duke rritur pjesëmarrjen dhe duke siguruar që kontributet dhe komentet të jenë objekt i analizës së hollësishme.

Të gjeturat dhe rekomandimet

Në bazë të konstatimeve të gjetura, ka disa sfida të identifikuara lidhur me përfshirjen e shoqërisë civile, publikut, ekspertëve dhe grupeve të interesit në procesin e konsultimeve publike në nivel qendror. Këto sfida përfshijnë, mosraportimin dhe publikimin e raporteve finale në kohë, mospërfshirjen e plotë të organizatave dhe publikut në konsultimet publike, mungesën e koordinimit të mirë mes organizatave të shoqërisë civile dhe mungesën e informimit të mjaftueshëm të shoqërisë civile për proceset e konsultimeve publike, dhe përdorimi i shumë pak metodave të konsultimit publik.

Për të adresuar këto sfida dhe për të krijuar një sistem më të qëndrueshëm dhe të gjatë për përfshirjen e shoqërisë civile dhe ekspertëve në hartimin e politikave dhe legjislacionit, rekomandohen hapat e mëposhtëm:

Përmirësimi i Menaxhimit dhe Konsultimit Publik:

- Angazhimi i menaxhmentit të ministrive dhe stafit për zhvillimin e konsultimeve dhe zbatimin e standardeve minimale për konsultimet publike.

- Zbatimi i rregullores për standardet minimale për moslejimin e miratimit të dokumenteve në qeveri nëse nuk plotësojnë standardet minimale.
- Sigurimi që informacioni dhe dokumentacioni në platformën online të jetë i qasshëm, i kuptueshëm, dhe në gjuhët zyrtare.

Ngritja dhe Zhvillimi i Kapaciteteve të Ministrive:

- Ngritja e kapaciteteve të stafit të ministrive dhe informimi për sistemin dhe rregullat e konsultimeve publike.
- Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në fushën e konsultimeve publike përmes trajnimeve dhe mbështetjes teknike.

Përfshirja dhe Zgjerimi i Hapësirës për Pjesëmarrjen Publike:

- Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në fazën e planifikimit të konsultimeve publike dhe hartimin e dokumenteve për t'u konsultuar.
- Zgjerimi i hapësirës dhe mundësive për pjesëmarrjen e publikut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme.

Inkurajimi dhe Partneriteti me Shoqërinë Civile:

- Inkurajimi i organizatave të shoqërisë civile për të dhënë kontribute dhe rekomandime për politikën dhe legjislacionin.
- Ndërtimi i marrëdhënieve të mira dhe partneritetit me shoqërinë civile në dialogun dhe vendimmarrjen publike.
- Sigurimi i kanaleve të hapura të komunikimit dhe informimit për organizatat e shoqërisë civile.
- Inkurajimi i përfshirjes aktive të shoqërisë civile në monitorimin e hartimit të politikave dhe legjislacionit.

Rritja e Transparencës dhe Vlerësimit të Procesit:

- Sigurimi i transparencës së plotë në procesin e konsultimeve publike, duke publikuar raporte me të shpeshta vlerësimi dhe detajet për plotësimin e standardeve minimale.

Këto rekomandime kanë si synim forcimin e konsultimeve publike në nivel qendror, dhe përfshirjen efektive të shoqërisë civile dhe ekspertëve në hartimin e politikave dhe legjislacionit. Përmes angazhimit të menaxhmentit të ministrive, ngritjes së kapaciteteve të stafit, zbatimit të rregullores për standardet minimale dhe përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në procesin e konsultimeve, mund të krijojmë një mjedis më transparent dhe të përgjegjshëm për vendimmarrjen publike. Kështu, është e mundur të rritet legjitimiteti dhe efikasiteti i procesit të hartimit të politikave dhe legjislacionit, duke marrë parasysh kontributin dhe pikëpamjet e të gjithë aktorëve të interesit dhe grupeve të tjera.

5.4. Rast studimi IV: Avancimi i pjesëmarrjes pro aktive të qytetarëve dhe palëve të interesit në politikëbërje në komunat Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj përmes zbatimit të Planit Komunal për Pjesëmarrje Qytetare

Në këtë pjesë analizohet pjesëmarrja e strukturuar të qytetarëve, shoqërisë civile dhe ekspertëve në nivel lokal, duke analizuar zbatimin e politikave për pjesëmarrje të qytetarëve në nivel lokal, me fokus në zbatimin e Planit Komunal për Pjesëmarrje Qytetare (PPQ) në komunat Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj. Kjo pjesë do të shtjellojë fillimisht mekanizmat e pjesëmarrjes, dhe më pas janë dhënë detaje konkrete mbi të cilat komunat janë zotuar për avancimin e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, përmes zbatimit të PPQ-ve.

Analiza e zbatimit është bërë duke analizuar procese zyrtare, dokumente publike dhe jopublike, përmes metodës së observimit (duke qenë pjesë e grupeve punuese dhe diskutimeve lokale), si dhe përmes intervistave me zyrtarë komunalë dhe shoqërinë civile.

Observim i përgjithshëm

Përmes ndihmës dhe facilituar nga donatorët, komuna e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderaj kanë zhvilluar dhe miratuar në Kuvendet Komunale Planet Komunale për Pjesëmarrje të Qytetarëve (PPQ-të), me qëllimin të ndihmojë dhe të udhëheqë

administratën e komunës në procesin e përfshirjes strukturore të qytetarëve në vendimmarrje. Planet sigurojnë metodologjinë dhe shërbejnë si një mjet për zbatimin praktik të teknikave për pjesëmarrjen e qytetarëve, duke nxjerrë praktikën më të mira në këtë sferë.

Struktura dhe Objektivi i Planit: Plani i Pjesëmarrjes së Qytetarëve është një dokument i cili përmban procedurat ligjore për angazhimin e qytetarëve në nivel komunal. Ai detajon protokolle që synojnë të parandalojnë zbatimin selektiv të përgjegjësive. Plani mbulon të gjitha aspektet e angazhimit qytetar, duke përfshirë konsultimet në formulimin e politikave, planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave.

Rëndësia e Planit: Plani Komunal për Pjesëmarrje Qytetare është i rëndësishëm në zhvillimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike. Plani udhëzon një platformë ku qytetarët mund të japin kontributin e tyre në vendimmarrje dhe të ndikojnë direkt në politikën dhe projektet që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme.

Roli i Planit në Demokratizimin e Vendimmarrjes: Plani ndihmon në demokratizimin e procesit të vendimmarrjes në nivel lokal. Kjo arrihet nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, e cila rrit transparencën dhe përgjegjësinë e institucioneve vendore. Gjithashtu promovon ndërtimin e besimit dhe bashkëpunimit mes qytetarëve dhe autoriteteve vendore.

Rëndësia e Pjesëmarrjes Qytetare: Pjesëmarrja qytetare është thelbësore në procesin e vendimmarrjes. Kjo sjell diversitetin e pikëpamjeve, përvojat dhe nevojat e qytetarëve në vendimmarrjen lokale. Përmes pjesëmarrjes, qytetarët ndihmojnë në krijimin e politikave dhe vendimeve që janë më afër nevojave dhe interesave të tyre.

Roli i Planit në Promovimin e Pjesëmarrjes Aktive: Plani ofron udhëzime konkrete për hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar angazhimin efektiv të qytetarëve në të gjitha fazat e hartimit të politikave. Kjo përfshin formulimin, planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave. Si rezultat, luan një rol të rëndësishëm në promovimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe në demokratizimin e procesit të vendimmarrjes në

nivel lokal (Komuna, 2020). PPQ-të janë përgatitur nga grupi punues i përbërë nga zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile (deleguar nga vetë shoqëria civile) (Kastrati B. , 2023).

Në PPQ janë të përcaktuara disa mekanizma të synuar për të rritur angazhimin e qytetarëve në procesin e formimit të politikave lokale. Efikasiteti dhe transparenca e këtyre mekanizmave, megjithatë, varet nga zbatimi i tyre konkret dhe angazhimi i përbashkët i qytetarëve dhe autoriteteve. Nëse zbatohen siç duhet, këto mekanizma mund të ndihmojnë në nxitjen e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe të garantojnë një proces vendimmarrje më të përgjegjshëm dhe demokratik, përfshirë takime dhe konsultime publike me qytetarët, përdorimin e platformave online dhe të tjera formate të komunikimit, përfshirjen e përfaqësuesve të qytetarëve dhe shoqërisë civile në komisione komunale dhe informimin për procedurat dhe temat e debatit publik.

Në nivelin praktik, PPQ propozon një varg mekanizmesh për të mundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, që përfshijnë informimin e publikut, përfaqësimin e qytetarëve nëpërmjet komiteteve të përhershme të Kuvendit Komunal, Këshillat lokale, Komitetet konsultative, dhe Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL) si një instrument për angazhimin e të rinjve në procesin e vendimmarrjes. Planifikohet gjithashtu partneriteti me qytetarët, fondet publike për OJQ-të, bashkëpunimi me KVRL dhe buxhetimi me pjesëmarrje.

Këta mekanizma janë thelbësorë për të nxitur pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në formimin e politikave vendore dhe për të garantuar një proces vendimmarrje më transparent dhe përgjegjës. Megjithatë, nëse nuk zbatohen në mënyrë korrekte dhe transparente, efektiviteti i tyre mund të jetë i kufizuar dhe nuk mund të stimulojnë pjesëmarrjen e duhur të qytetarëve. Nëse qytetarët nuk kanë besim në procesin e vendimmarrjes dhe në mekanizmat e përdorur për të nxitur pjesëmarrjen e tyre, ata mund të tregojnë pak interesim për të marrë pjesë në procesin e politikës lokale.

Plani i Veprimit për Pjesëmarrje Qytetare, si pjesë e PPQ, ofron udhëzime të detajuara për të stimuluar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen lokale. Ky plan përcakton hapat konkretë që duhet të ndërmerren nga autoritetet qeverisëse për të informuar publikun mbi procedurat dhe temat e debatit publik dhe për të garantuar pjesëmarrjen e qytetarëve në komisionet komunale. Ky plan është krijuar për të vendosur një mekanizëm efektiv për identifikimin dhe zbatimin e strategjive të komunikimit dhe informimit që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në zbatimin e politikave dhe strategjive të komunës.

5.4.1. Analiza e situatës

Analiza SUOT për PPQ tregon se ka shumë elementë pozitivë të vendosur në pikat e forta dhe mundësitë, si dhe sfida që përballen në dobësi dhe kërcënimet. Në aspektin e pikave të forta, institucioni ka një strukturë dhe kapacitet të mirë organizativ, si dhe një qasje të gatshme për të përfshirë qytetarët në proceset e vendimmarrjes. Kjo do të thotë se institucioni ka një bazë të fortë për të avancuar dhe zgjeruar më tej përfshirjen e qytetarëve në hartimin e politikave.

Megjithatë, dobësitë dhe kërcënimet tregojnë se ka sfida të rëndësishme për të përballuar. Përfshirja e qytetarëve mund të jetë e vështirë për shkak të mungesës së përparësive midis qytetarëve, mungesës së bashkëpunimit ndërmjet drejtorive të komunës dhe mungesës së përfshirjes së duhur të palëve të interesit në konsultimet publike. Kërcënimet, si situata politike e brishtë dhe mungesa e vetëdijes dhe edukimit për pjesëmarrjen e qytetarëve, mund të minojnë përpjekjet për përfshirje më të gjerë. Prandaj, është e rëndësishme që institucioni të adresojë këto sfida dhe të gjejë mënyra për t'i përballuar ato, ndërsa vazhdon të ndërtojë mbi pikat e forta dhe mundësitë.

Tabela 9. Analiza SUOT e Komunës së Mitrovicës, PPQ Mitrovicë

Pikat e forta	Dobësitë
Baza ligjore aktuale	Shmangia e sugjerimeve nga qytetarët në
Plani i transparencës	procesin e përcaktimit të buxhetit
Rregullorja e komunës për transparencë	Mungesa e përparësive midis qytetarëve
Mjetet e komunikimit (mbulimi i mediave)	Qasje jo e strukturuar e institucioneve
Anëtarë të mjaftueshëm të personelit	Gjuha e përdorur është shumë teknike
- Gatishmëria e autoriteteve për	Shoqëria civile joaktive
përfshirjen e qytetarëve	
Mundësitë	Kërcënimet
Pjesëmarrja e qytetarëve në debate	Situata e brishtë politike dhe e sigurisë
publike	Tendenca për të krijuar çështje jashtë
Të nxisë / të inkurajojë qasje pro aktive	pushtetit komunës
Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet	Dekurajimi i qytetarëve nga proceset e
komunave	vendimmarrjes
Përzgjedhja konsensuale e përfaqësuesve	Mungesa e koordinimit midis shtresave /
- Krijimi i hapësirës për vendimmarrje të	niveleve administrative
përbashkët	- Mungesa e vetëdijes dhe edukimit për
	pjesëmarrjen e qytetarëve

Sa i përket komunës së Vushtrrisë, përshkrimi i rëndësisë së pjesëmarrjes qytetare në procesin e politikës lokale dhe demokratizimin e vendimmarrjes është një aspekt kyç i PPQ-së (Komuna e Vushtrrisë, 2020). Analiza SUOT për komunën e Vushtrrisë dhe Skenderaj tregon disa sfida dhe mundësi në kontekstin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Sfidat përfshijnë nivele të ulëta të pjesëmarrjes, perceptime se sugjerimet e qytetarëve nuk merren seriozisht, dhe mungesa e ndërgjegjësimit dhe fondeve. Megjithatë, pikat e forta përfshijnë vullnetin politik për përfshirjen e qytetarëve, bashkëpunimin me shoqërinë civile, dhe transparencën e institucioneve komunale.

Mundësitë përfshijnë pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve dhe përfshirjen gjinore në vendimmarrje.

Në përgjithësi, analiza tregon se ndërsa ka sfida në pjesëmarrjen e qytetarëve, ka gjithashtu shumë mundësi për të rritur këtë pjesëmarrje dhe për të fuqizuar rolin e qytetarëve në vendimmarrje. Kjo do të kërkojë përkushtim dhe vullnet politik, si dhe bashkëpunim dhe ndërgjegjësim të rritur midis qytetarëve dhe institucioneve komunale.

Tabela 10. Analiza SUOT e komunës së Vushtrrisë dhe Skenderaj

Pikat e forta	Dobësitë
Gatishmëria / vullneti politik i institucioneve komunale për përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes; Qytetarët dhe shoqëria civile (urat) bashkëveprojnë me institucionet komunale; Qasje pro aktivë e institucioneve komunale ndaj qytetarëve / CPP; Niveli i lartë i transparencës në lidhje me dokumentet publike; Baza ligjore është mbështetëse ndaj qytetarëve në vendimmarrje; Burime të mjaftueshme njerëzore për përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes	Niveli i ulët i pjesëmarrjes së qytetarëve, me fokus të veçantë te gratë; Mungesa e stimulimit drejt këshillave të fshatit; Perceptimi që sugjerimet e qytetarëve nuk merren në konsideratë; Mungesa e ndërgjegjësimit midis qytetarëve në mënyrë që të përfshihen në proceset e vendimmarrjes dhe të vendosin përparësi për çështje publike; Mungesa e fondeve për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje; Nevoja për fuqizimin e Zyrës për Informim Publik.
Mundësitë	Kërcënimet
Qytetarët dhe shoqëria civile (urat). Pjesëmarrje më e madhe e qytetarëve, mundësi për më shumë sugjerime dhe ide;	Reflektim jokonstruktiv i grupeve të ndryshme të interesit (rrymat politike).

Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve; Nxiti / përshejtoje funksionalizimin e këshillave të fshatit (mundësia e mbështetjes financiare); Përfshirja gjinore në proceset e vendimmarrjes (këshillat e fshatit).	
---	--

Komuna e Vushtrrisë dhe Skenderaj ballafaqohen me sfida të ndryshme në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës në nivel lokal. Disa nga këto sfida përfshijnë mungesën e ndërgjegjësimit dhe informacionit të qytetarëve rreth mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare dhe mungesën e resurseve financiare dhe njerëzore për të zbatuar këto mekanizma. Këto çështje mund të ndikojnë në nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Megjithatë, ka edhe mundësi për përmirësim. Për shembull, rritja e ndërgjegjësimit dhe informacionit të qytetarëve rreth mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare dhe rritja e bashkëpunimit midis autoriteteve komunale dhe shoqërisë civile mund të ndihmojnë në rritjen e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin vendimmarrës. Sidoqoftë, ka edhe kërcënime që mund të ndikojnë në pjesëmarrjen e qytetarëve, si mungesa e besimit të qytetarëve në procesin vendimmarrës dhe mungesa e ndërgjegjësimit të autoriteteve komunale për rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve. Këto kërcënime mund të ndikojnë në nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe në efektivitetin dhe transparencën e procesit vendimmarrës.

Megjithë sfidat e diskutuara më lartë, është diktuar se Komunitat Vushtrri, Mitrovicë dhe Skenderaj kanë në dispozicion disa mekanizma për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, si takimet me publikun, takimet e kryetarit të komunës me qytetarët dhe konsultimet publike përpara miratimit të akteve. Vlerësimi i efektivitetit dhe transparencës së këtyre mekanizmave është një aspekt kyç i procesit. Por ka edhe sfida në zbatimin e këtyre mekanizmave, si mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimit të

qytetarëve dhe mungesa e resurseve dhe kapaciteteve për të inkurajuar dhe ndihmuar në pjesëmarrjen aktive të qytetarëve. Adresimi i këtyre sfidave dhe përpjekja për të përmirësuar mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare mund të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin vendimmarrës.

Më poshtë do të analizohet procesi i konsultimit dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje duke analizuar mekanizmat aktualë që komuna ka në dispozicion.

Mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikëbërje në nivel lokal

Në përputhje me legjislacionin, (UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MPL) NO. 06/2018), Komuna ka detyrimin të sigurojë konsultime publike për dokumentet e politikave komunale të përmendura më poshtë:




Figura 24. Konsultimet komunale mbi dokumentet publike

Komuna ka lirinë të këshillohet me qytetarët për çështje të ndryshme dhe zgjedh format dhe teknikat e konsultimit në bashkëveprimin mes administratës lokale dhe qytetarëve (paraqitur në fig. 25). Pavarësisht nga forma dhe teknika e zgjedhur, procedura e nevojshme për ndërveprim me qytetarët përfshin tre fazat e planifikimit, implementimit dhe komunikimit dhe shkëmbimit të komenteve të mbledhura, sugjerimeve, ideve, etj. Para aprovimit të një projekt-propozimi të politikës, organi propozues vendos të hapë procesin e konsultimit publik, dhe mund të përdorë metoda të ndryshme, si mëposhtë:




Figura 25. Teknikat e konsultimit publik në komuna

Zyra për Informim Publik

Zyra/Zyrtari për Informim Publik në çdo komunë ka përgjegjësinë për koordinimin e procesit të konsultimit publik. Zyrtari për Informim Publik duhet të përgatisë shpjegime lidhur me draft dokumentin për konsultime publike, të koordinojë konsultat publike në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për përgatitjen e draftit fillestar të dokumentit, të përgatisë njoftime për konsultime publike, të organizojë takime me publikun dhe palët e interesit në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës dhe grupin e punës që hartuan dokumentin, të mbledhë komente dhe sugjerime nga konsultimet publike dhe t'ia dërgojë ato zyrtarit përgjegjës dhe grupit të punës që hartuan dokumentin për rishikim.

Para zbatimit të teknikës së zgjedhur të këshillimit, zyrtari përgjegjës për konsultim publik informon entitetin që propozoi ose hartoi aktin/dokumentin. *“Komuna identifikon qytetarët dhe palët e interesit dhe formon dhe mban një bazë të dhënash të palëve të interesit në varësi të temave të dokumentit”* (Kastrati B. , 2023). Megjithatë, çdo person fizik ose juridik që banon në komunë ka të drejtën të marrë pjesë aktivisht në dialog, të bëjë pyetje, të japë komente, sugjerime dhe rekomandime.

“PPQ në të tri komunat ka paraparë formimin e komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve, megjithatë, vetëm një nga tri komunat” (Skenderaj) (Rushiti, 2023), ka të formuar këtë komitet i cili do të shërbente si trup këshillues për planifikim, zbatim dhe monitorim të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe grupeve të ekspertëve në proceset e vendimmarrjes lokale. Nga të tri komunat e analizuara, vetëm Skenderaj ka përmbushur këtë zotim.



Figura 26. Formimi i komiteteve konsultative për pjesëmarrje të qytetarëve

Konsultimet publike

Kur flitet për metodat e dialogut të nevojshme, format obligative të përcaktuara me Udhëzimi Administrativ (MAPL) no. 06/2018 mbi minimumin e standardeve të konsultimeve me publikun në komuna janë:

- Takimet për këshillim publik;
- Konsultimi me shkrim dhe elektronik në fazën e parë;
- Të paktën një takim me palët e interesit në fazën e dytë.

Afati i fundit për shpalljen e njoftimit për mbledhjen publike është tetë (8) dhe katërmëdhjetë (14) ditë para mbledhjes. Metoda e komunikimit të njoftimit duhet të sigurojë që informacioni të arrijë tek palët e interesit dhe publiku i gjerë. Kjo mund të bëhet përmes tabelave të njoftimeve, faqes zyrtare të komunës, platformave elektronike të komunës, rrjeteve sociale, ftesave me shkrim, etj. Ftesa për takim përgatitet nga Zyrtari i Konsultimit në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për përgatitjen e projekt-aktit. Ftesa duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme (Udhëzimi Administrativ (MAPL) no. 06/2018):


- Data, vendi dhe koha e mbledhjes publike;
- Propozimi për diskutim;
- Shpjegimi i projekt propozimit;
- Informacioni për personin përgjegjës për marrjen e komenteve (emri dhe adresa elektronike).

Në mbledhjen publike marrin pjesë zyrtari dhe grupi punues përgjegjës për hartimin e propozimit, drejtori i drejtorisë së propozuesit, drejtorët e drejtorive përkatëse, zyrtarë të tjerë të deleguar nga drejtoritë përkatëse dhe zyrtari përgjegjës për konsultim publik. Gjithashtu, në dialogun me qytetarët dhe palët e interesit, Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komiteteve përkatëse dhe komisionet e Kuvendit të Komunës mund të marrin pjesë në mbledhjen publike.

Takimet drejtohen nga zyrtari përgjegjës, i cili së bashku me zyrtarin për konsultim publik, regjistron propozimet, sugjerimet dhe rekomandimet që vijnë nga dialogu me qytetarët dhe palët e interesit.

Komuna duhet të ketë një seksion në uebfaqen e tyre, ku mund të organizohen konsulta. Komentet (sugjerimet, rekomandimet) që dalin nga procesi i konsultimit përfshihen si pjesë e raportit të konsultimit. Grupi i Punës, i cili është përgjegjës për hartimin e një akti, shqyrton komentet e mbledhura dhe vendos nëse do t'i miratojë ose do t'i refuzojë propozimet dhe rekomandimet të përfshira në to. Në bazë të këtyre vendimeve, hartohet një raport përfundimtar i konsultimit brenda pesëmbëdhjetë (15) deri në tridhjetë (30) ditë. Ky raport publikohet në faqen zyrtare të komunës brenda 5 ditëve kalendarike pas përfundimit të tij.

Më poshtë paraqitet një shembull i konsultimit publik në komunën e Mitrovicës mbi Projektplanin për Transparencë komunale 2023 - 2027. *“Përgjithësisht, komuna e Mitrovicës në takimet e konsultimi publik ka një numër të konsiderueshëm të pjesëmarrësve, dhe gjithashtu aspekti gjinor i pjesëmarrjes vihet në dukje”* (Sadiku, 2023).




*Figura 27. Konsultimet mbi projektplanin për Transparencë komunale 2023 -2027
komuna e Mitrovicës*

Megjithatë, nga observimi i bërë dhe nga intervistat e realizuara vihet re se mungon një qasje proaktive e përfshirjes së grupeve të marginalizuara, si personat me aftësi të kufizuara ose organizatave të tjera specifike të profilizuara, *“Komuna nuk i përfshin aspak grupet e cënueshme në këto procese. Së pari nuk ofron kushtet për pjesëmarrje, ka mungesë të qasjes fizike, informacionet nuk janë të kuptueshme për të gjithë, mungojnë informatat e thjeshta, komunikimi me simbole, mungojnë fushatat për sensibilizimin e grupeve për pjesëmarrje në këto fusha etj. P.sh. në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal përpos mundësisë për komente online nuk ka pasur asnjë takim direkt me përfaqësuesit e OJQ-ve që punojnë me personat me aftësi të kufizuara, duke u pyetur lidhur me infrastrukturën, objektet, etj.”* (Lahi, 2023).

Gjithashtu, edhe në Skenderaj vlen i njëjti konstatim, pra shoqëria civile thekson se *“Duke u bazuar në monitorimin që si përfaqësuese e shoqërisë civile i bëj institucioneve publike, mund të them që ky është një nga sektorët më të ndjeshëm dhe realisht me një përparim të ulët pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme. Komuna në diskutime publike i përfshin dhe i fton të gjitha këto kategori (bazuar në komunikimin me zyrën e informimit), mirëpo niveli i pjesëmarrjes së këtyre kategorive vazhdon të jetë shumë i ulët, dhe në shumë raste vetëm pjesëmarrje në numër, pa ndonjë kërkesë konkrete”* (Zeqiri, 2023).

Në figurën e mëposhtme (Fig. 28) vërehet se krahasuar më Mitrovicën, në Skenderaj numri i pjesëmarrësve në konsultime publike është më i ulët, dhe kjo për disa arsye që vetë shoqëria civile i ka potencuar gjatë intervistimit *“... në takimet publike që organizon komuna ka gjithëpërfshirje gjinore, por për shkaqe që në të gjitha objektet publike nuk ka qasje për personat me aftësi të kufizuar dhe jo çdoherë përfshihen në këto takime publike”* (Veliqi, 2023). *“Qasja e barabartë synohet të sigurohet përmes ftesave publike, mirëpo konsideroj që kjo barazi akoma nuk është arritur pasi shumë grupe të cënueshme kanë mungesë të informimit dhe nuk kanë mundësi teknike të jenë pjesë e konsultimeve publike”* (Mustafaj, 2023).



*Figura 28. Konsultimet mbi projektplanin për Transparencë komunale 2023 -2027
komuna e Skenderaj*

Megjithëse në rastin e konsultimit, procedurat për zbatimin e tij duhet të përfundojnë brenda një periudhe prej të paktën tridhjetë (30) deri në maksimumin e gjashtëdhjetë (60) ditëve kalendarike nga data e publikimit të njoftimit publik për zhvillimin e konsultimit. Në raste të veçanta, ky afat mund të zgjatet maksimalisht për tridhjetë (30) ditë, në situata të jashtëzakonshme kur:

- dialogu nuk ka sjellë një numër të mjaftueshëm komentesh për të përmbushur pikëpamjet e qytetarëve dhe palëve të interesit;
- përmbajtja e propozimit, për shkak të fushëveprimit dhe kompleksitetit të tij, kërkon zgjatjen e procedurës;
- gjatë hartimit të propozimit, ka dalë nevoja për të trajtuar çështje të reja me rëndësi për temën e propozimit, etj.

Në praktikë nuk ka informata nëse kjo dispozitë ligjore është praktikuar nga komunat e Mitrovicës, Vushtrrisë apo Skenderaj për të rritur numrin e pjesëmarrësve dhe komenteve në konsultim publik. Zyrtarët komunalë e cilësojnë se procesi i konsultimit ndodh sipas procedurave në fuqi, ndërsa zbatimin e PPQ-së si dokument që ofron më shumë mekanizma nuk e shohin si të rëndësishëm.

Qasja në dokumente publike

Qasja në dokumentet publike dhe informacionet e tyre është një e drejtë e rëndësishme civile në shoqëritë demokratike. Kjo e drejtë sigurohet nëpërmjet publikimit pro aktiv të dokumenteve nga institucionet publike dhe përmes kërkesave të individëve për të pasur qasje në to. Një zyrtar i autorizuar brenda institucionit ka përgjegjësi për të autorizuar ose refuzuar kërkesat për qasje në dokumentet publike. Një institucion publik mund të vendos kufizime në qasjen e dokumenteve vetëm në raste të veçanta, si për shembull, nëse kërkesa ndikon në funksionimin e institucionit publik ose nëse përmban informacione joproporcionale për t'u bërë publike.

Ligji për Qasje në dokumente Publike (LIGJI NR. 06/L-081 PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE, 2019) rregullon procesin publik për qasje në dokumente publike, gjithashtu edhe në kuadër të PPQ në të tri komunat e rastit studimor, qasja në dokumente publike shtjellohet dhe është po ashtu pjesë e planit të veprimit, i cili shtjellohet detajisht më poshtë.

Kërkesat për qasje në dokumente mund të paraqiten me shkrim ose në mënyrë elektronike. Nëse një dokument publik ekziston në më shumë se një gjuhë, duhet të jepet në gjuhën e preferuar të aplikantit. Kur një kërkesë për qasje në dokumente publike është pranuar, personi ka të drejtë të zgjedhë formën e dëshiruar të pranimi të dokumentit. Mundësitë e pranimi përfshijnë një kopje të shtypur të dokumentit ose forma të tjera të disponueshme, si kopjimi me pajisjet personale ose pajisjet e komunës, si dhe pranimi i përmbajtjes audio ose video nëse ka një regjistrim të takimit publik.

Institucionet publike kanë një afat prej shtatë (7) ditësh për të vendosur nëse pranojnë ose refuzojnë një kërkesë për qasje në dokumente publike. Ky afat mund të zgjatet deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë shtesë në raste kur ka nevojë për të kërkuar dokumente jashtë arkivave të institucioneve publike.

Sa i përket qasjes në dokumente publike, në komunën e Mitrovicës vërehet një ngritje e kërkesave ndër vite, e paraqitur në Fig. 24 më poshtë. Gjithashtu, është pozitiv fakti se shumica absolute e kërkesave janë të miratuara për palët.




Figura 29. Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike 2020 - 2022 komuna e Mitrovicës

Diskutimet publike – takime me qytetarë

Ligji no. 03 / L – 040 parasheh se secila komunë do të organizojë takime publike dhe seanca dëgjimore për çështje me interes të përbashkët të komunës, të cilat do të mbahen në mënyrë periodike, të paktën dy herë në vit. Këto takime janë hapur për të gjithë personat dhe organizatat e interesit për punën e komunës.

Njëra prej takimeve publike duhet të zhvillohet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, ndërsa tjetra duhet të mbahet gjatë gjysmës së dytë të vitit. Vendndodhja, data dhe ora e takimeve me qytetarët do të publikohen në media elektronike dhe të shkruara, në tabela informuese të komunës dhe në vendet më të vizituara të komunës. Informimi i publikut do të bëhet nga Zyra e Informimit Publik.

Kryetari i Komunës ka përgjegjësinë për të caktuar rendin e ditës për mbledhjen e takimit. Kërkesat dhe rekomandimet e paraqitura nga publiku gjatë seancave dëgjimore publike do të regjistrohen dhe postohen në faqen zyrtare të komunës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas dëgjimeve publike. (LIGJI NO. 03 / L – 040).

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komunë, kryetarët e komunave organizojnë takimet publike. Më poshtë do të analizojmë takimet e kryetarëve të Mitrovicës, Skenderaj dhe Vushtrri në vitet 2022-23. Duke qenë se komuna e vetme që nuk i publikon raportet nga takimet publike është Vushtrria, dhe gjithashtu ka pasur shumë pak interesim në përgjigje gjatë intervistimit, nuk mund të bëjmë analizën e takimeve të kryetarit me publikun, ndonëse nga komuna ka pretendime se *“pjesëmarrjen e palëve në diskutime publike i sigurojmë përmes ftesave fizike dhe përmes rrjeteve sociale”* (Mlinaku, 2023).

Rrjedhimisht, më poshtë paraqitet analiza për komunat Mitrovicës dhe Skenderaj.




Figura 30. Pjesëmarrja në takimin e parë publik të Kryetarit të Skenderaj (Korrik 2023)

Kryetari i Komunës së Skenderaj ka organizuar takimin e parë me publikun më datë 30 qershor 2023 (Skenderaj, 2023). Raporti pasqyron se para organizimit të takimit, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të informuar qytetarët për këtë ngjarje. Njoftimi i protokolluar është publikuar në faqen e internetit të komunës dhe në llogarinë zyrtare në Facebook. Gjithashtu, janë përdorur edhe forma të tjera të komunikimit me

qytetarët, grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile për t'i njoftuar ata për këtë takim.

Gjatë prezantimit të tij, kryetari i komunës ka informuar të pranishmit mbi punën e Ekzekutivit të Skenderajt për 6 muajt e këtij viti, duke përfshirë projektet që janë nisur për t'u realizuar gjatë këtij viti. Takimi ka përfshirë edhe një procesverbal, ku janë regjistruar kërkesat e qytetarëve. Qytetarët kanë paraqitur kërkesa për investime në zonat e tyre të banimit, të lidhura me ndërtimin e trotuareve, ndriçimin publik, trajtimin e shtratit të lumit "Klina", kanalizim dhe ujësjellës.

Mangësitë e vërejtura

Mungesa e përkufizimit të qëllimit: raporti nuk përcakton qartë qëllimin e takimit publik. Për shembull, nuk është theksuar nëse takimi synonte të konsultonte qytetarët për projekte të caktuara, të adresonte shqetësime të tyre ose të prezantonte projektet dhe planin e punës së Ekzekutivit.

Përfshirja e numrit të qytetarëve: raporti përmend numrin e qytetarëve të pranishëm në takim dhe përkatësinë e tyre gjinore, por nuk jep informacione më të thella për përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme ose pse këta individë janë zgjedhur për t'u përfshirë në konsultim.

Mungesa e përcaktimit dhe e reagimit të/ndaj kërkesave: Përveç një përmendje të përgjithshme për kërkesat e qytetarëve, raporti nuk jep detaje mbi përmbajtjen dhe natyrën e kërkesave të paraqitura gjatë takimit publik. Ky informacion mund të ishte i rëndësishëm për të kuptuar nevojat dhe shqetësimet e komunitetit. Në raport nuk ka informacion të qartë mbi se si kërkesat e qytetarëve janë trajtuar ose përgjigjur nga autoritetet lokale. Një raport i plotë duhet të përmbajë një shtjellim të përgjigjeve dhe masave që janë marrë në lidhje me kërkesat e paraqitura.

Mangësi në përshkrimin e planeve të ardhshme: Në raport nuk ka përmendje të planeve të ardhshme për të përmirësuar konsultimin publik ose si do të trajtohet feedback-u i

qytetarëve në të ardhmen. Ky informacion do të ishte i rëndësishëm për të dëshmuar ndërmarrjen e masave për përmirësimin e procesit të konsultimit publik.

Sa i përket komunës së Mitrovicës, në raportin e takimit publik të kryetarit për vitin 2022 vërehet se tubimi është organizuar si një mënyrë për të komunikuar me qytetarët dhe për të prezantuar aktivitetet, arritjet dhe sfidat e komunës gjatë këtij viti. Raporti jep informata mbi kategorizimin gjinor të pjesëmarrësve, por nuk jep informata mbi përfshirjen e grupeve të tjera të marginalizuara.

Njoftimi për këtë takim është bërë në mënyrë të mirë organizuar, përfshirë shpërndarjen e njoftimeve në uebfaqet zyrtare të komunës, rrjetet sociale dhe portalet lokale. Metodatat e konsultimit kanë përfshirë konsultime me shkrim në mënyrë elektronike për 14 ditë pune dhe publikimin në uebfaqen e komunës për të njëjtën periudhë. *“Komuna e Skenderajt njofton direkt edhe përfaqësuesit e lagjeve dhe fshatrave rreth takimit dhe konsultimit publik... Është zgjedhur forma e njoftimit të përfaqësuesve të lagjeve dhe fshatrave sepse ata do ta mbrojnë interesin e banorëve ku jetojnë”* (Zabelaj, 2023).

Në tubim, kryetari i komunës ka njoftuar pjesëmarrësit për aktivitetet komunale, realizimet, sfidat dhe synimet e vitit të kaluar. Gjatë takimit, kanë pasur një diskutim të hapur dhe ka pasur pyetje dhe propozime nga pjesëmarrësit, përfshirë përfaqësues të lagjeve, shoqërisë civile dhe qytetarë të tjerë.




Figura 31. Pjesëmarrja në takimin e parë publik të Kryetarit të Mitrovicës (Dhjetor 2022)

Kërkesat e pjesëmarrësve janë dokumentuar në tabelë, duke përfshirë temat e konsultimit, komentet dhe numrin e pyetjeve për secilën temë. Për secilën kërkesë, është shënuar përgjigja e kryetarit, qoftë plotësisht ose pjesërisht dhe arsyetimi i pranimi ose mospranimi të kërkesës. Disa prej kërkesave të pjesëmarrësve përfshijnë kërkesa për rregullimin e rrugëve, furnizimin me ujë të pijshëm dhe ndihmën sociale për familjet në nevojë.

Raporti në përgjithësi tregon se kryetari dhe komuna kanë qenë të përgatitur për tubimin, kanë pasur pjesëmarrje të konsiderueshme dhe kanë qenë të hapur ndaj pyetjeve dhe kërkesave të qytetarëve. Në të njëjtën kohë, raporti përmend që shumë prej kërkesave janë pranuar pjesërisht ose plotësisht, duke treguar një përkushtim ndaj ofrimit të shërbimeve publike dhe zhvillimit të komunitetit.

Mangësitë e vërejtura

Përgjigjet të përgjithshme: Në disa raste, përgjigjet e kryetarit ndaj kërkesave janë të përgjithshme dhe nuk ofrojnë informacion specifik ose masat e përcaktuara që do të ndërmerren për zgjidhjen e çështjeve të përmendura.

Mungesa e transparencës së plotë: Raporti përmend që pjesa e kërkesave janë pranuar pjesërisht ose plotësisht, por nuk ofron detaje të mjaftueshme për të dëshmuar këto pretendime. Një nivel më i lartë i transparencës do të siguronte që përgjigjet dhe veprimet e komunës të jenë të verifikueshme nga qytetarët.

Mungesa e përfshirjes së një game më të gjerë pjesëmarrësish: Raporti përmend pjesëmarrjen e disa përfaqësuesve të lagjeve, shoqërisë civile dhe qytetarëve në përgjithësi, por nuk jep informacion mbi përfshirjen e grupeve të tjera të interesit, të tilla si grupet minoritare, organizatat joqeveritare, dhe komunitetet e tjera të komunës *“...edhe kur këto takime mbahen janë të stërmbyshura me militant partiak, gjë që ju pamundëson shprehjen dhe fjalën e lirë shumë qytetarëve”* (Uka, 2023).

Takimet e kuvendit të komunës

Kuvendi i Komunës zhvillon një varg aktivitete të ndryshme përfshirë organizimin e seancave inauguruese, rregullta, të jashtëzakonshme, emergjente dhe formale. Kryetari i Kuvendit ka përgjegjësi për thirrjen dhe drejtimin e këtyre seancave. Kushtëzohet që të paktën dhjetë seanca të organizohen dhe zhvillohen brenda një viti.

Pjesëmarrja e publikut në këto seanca është e lejueshme, që e bën të domosdoshme informimin e publikut për të njëjtat nga Kryesuesi i Kuvendit dhe komiteti përkatës. Informimi realizohet së paku shtatë ditë pune para seancave të rregullta dhe tre ditë pune para seancave të jashtëzakonshme, dhe kjo bëhet përmes Drejtorit ose Zyrtarit të Informimit.

Kanale të ndryshme përdoren për njoftimin e publikut për mbledhjet, përfshirë faqen zyrtare të komunës, tabelën e njoftimeve të komunës, tabelat e reklamave në territorin e komunës dhe mediave të shkruara dhe elektronike. Njoftimet përfshijnë të dhënat e rëndësishme si data, koha, vendi, rendi i ditës dhe materialet për seancën. Këto njoftime dhe materialet për takimin publikohen në gjuhët zyrtare. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

ka përgjegjësinë për përgatitjen e materialeve të nevojshme për seancat dhe organizimin e hapësirave për pjesëmarrjen e publikut dhe përfaqësuesit e mediave.

Duke qenë se të gjitha këto seanca janë të hapura për publikun, ka raste kur Kuvendi Komunal ose Komitetet e Kuvendit mund të vendosin përjashtimin e publikut nga e gjithë ose një pjesë e seancës, pas hapjes së seancës. Kjo vlen në rastet kur ekziston rreziku i shqetësimeve ose dhunës, ose në rastet kur informacionet konfidenciale do të diskutohen. Këto informacione dhe dokumente mbrohen sipas Ligjit për qasjen në dokumente publike. Komuna, përmes faqes zyrtare në internet, transmeton seancat e Kuvendit të Komunës në formë video (UDHËZUESI ADMINISTRATIV (MPL) NO. 02/2015).

Takime të tjera dhe takimet publike

Përveç takimeve publike të detyrueshme, komuna organizon takime dhe tubime publike në zonat urbane dhe rurale, me tema të përbashkëta të interesit, si buxheti komunal, projektet komunale, zhvillimi ekonomik, përdorimi i pronës komunale, planifikimi hapësinor, investimet dhe çështje të tjera me interes publik. Për të zhvilluar takimet e tilla, komuna në bashkëpunim me përfaqësuesit komunalë dhe qytetarët, siguron kushtet e nevojshme.

Palët e interesit dhe publiku do të njoftohen për këto takime katërmëdhjetë (14) ditë para, në një mënyrë që të sigurohet marrja e informacionit në kohën e duhur. Komuna është e obliguar të mbajë një listë të pjesëmarrësve dhe të përgatisë një procesverbal të mbledhjes që përfshin komentet, rekomandimet dhe sugjerimet që vijnë nga takimi. Procesverbalin duhet ta publikojë brenda afateve kohore të përcaktuara për organizimin e takimeve të detyrueshme. (UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MPL) NO. 04/201), megjithatë shoqëria civile thekson faktin se “...nuk ka qenë asnjëherë dëshirë e Komunës që të nxisë pjesëmarrjen, por tani meqë obligohen me ligj ata janë duke tentuar që të kenë pjesëmarrje në grupe punuese, konsultime publike etj. Kanalet që po shfrytëzohen se fundmi janë përmes kryetarëve të lagjeve e fshatrave, por edhe kjo është pak diskutabile

nëse këta persona janë kredibilë dhe jo të anshëm politikisht” (Ferizi, 2023). Gjithashtu, përfshirja e grupeve të marginalizuara është shumë e ulët, “Sfidë kryesore mbetet numri i ulët i qytetarëve të interesuar për t’u përfshirë në këto procese. Është punë e institucioneve që të punojnë dhe të gjejnë mënyra më kreative për t’i nxitur ata të përfshihen më tepër. Një arsye e numrit të ulët është edhe mungesa e informimit; afatet e shkurtra të publikimit të datave si dhe mos marrja parasysh e rekomandimeve. Takimet të realizohen në lagje, fshatra, me përfshirjen edhe të Këshillave lokale dhe përdorimit të kapaciteteve të tjera. Komuna të bashkëpunoj më tepër me organizatat me qëllim që ato t’i përdorin mekanizmat në dispozicion për arritjen tek përfituesit direkt apo grupet e interesit, kjo do të mundësonte transparencë dhe përfshirje më të madhe; përdorimi i kanaleve të ndryshme të komunikimit, jo vetëm ato ku vetëm një numër i limituar i qytetarëve i përdorin” (Lahi, 2023).

Komitetet konsultative

Për të stimuluar dhe inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimeve, komuna krijon Komitetet Konsultative si njësi ndihmëse të Kuvendit të Komunës. Këto organe synojnë të optimizojnë efikasitetin e punës së institucioneve komunale, të forcojnë transparencën dhe të rrisin përgjegjshmërinë e tyre ndaj banorëve. Rregullat për themelimin, strukturën dhe mandatin e Komiteteve konsultative janë të përcaktuara (MAPL, Udhëzuesi Administrativ (MPL) Nr. 01/2016: mbi procedurat e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna, 2016).

Procesi për themelimin e Komiteteve Konsultative, sipas Udhëzuesit, fillon me propozimin për formimin e tyre. Propozimi mund të vijë nga Kryetari i Komunës, këshilltarët komunalë, ose organizatat joqeveritare si pjesë e shoqërisë civile. Kryetari i Kuvendit të Komunës duhet të marrë propozimin për krijimin e komitetit së bashku me arsyetimin përkatës.

Komiteti ka një strukturë që përfshin qytetarë dhe përfaqësues nga organizatat joqeveritare, të cilët duhet të kenë ekspertizë në fushat përkatëse të komitetit të veçantë. Numri i anëtarëve varion nga pesë (5) deri në shtatë (7), duke ruajtur përfaqësimin gjinor.

Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit Konsultativ bëhet përmes konkursit të organizuar nga Kuvendi i Komunës, duke përcaktuar kritere të caktuara, ku kriteri kryesor është që kandidati të jetë banor i komunës. Një panel zgjedhor, i përbërë nga përfaqësues të ndryshëm, bën përzgjedhjen dhe paraqet propozimin tek Kuvendi i Komunës. Kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi zgjidhen demokratikisht nga anëtarët e komitetit, dhe mandati i anëtarëve është 4 vjet, me një kufizim prej dy mandateve radhazi.

Komitetet mbajnë takime sipas nevojës, jo më pak se 6 herë në vit, të organizuara nga Kryetari ose të paktën 1/3 e anëtarëve. Plani i Punës përcakton kalendarin, dhe njoftimi për mbledhjet duhet të përmbajë të dhëna të qarta. Komitetet kanë të drejtë të propozojnë në fusha të ndryshme dhe ofrojnë sugjerime për zgjidhjen e problemeve specifike.

Kuvendi i Komunës duhet të marrë parasysh propozimet e Komiteteve, dhe për funksionimin e brendshëm, duhet të miratohen procedurat me shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm. Komuna duhet të sigurojë kushtet për punën e Komiteteve dhe ata duhet të paraqesin raport vjetor. Anëtarët marrin kompensim nga buxheti i komunës, i cili duhet të jetë i barabartë me komitetet e përhershme, deri në 6 mbledhje në vit.

Së fundi, Kuvendi i Komunës ka të drejtën të krijojë Komitete Konsultative ad hoc për çështje specifike, me një mandat që mbaron pas zgjidhjes së çështjeve përkatëse.

Megjithatë, ka shqetësime të dukshme se si formohen komitetet konsultative, kjo për faktin se procesi jo gjithmonë është transparent. Përfaqësues nga shoqëria civile theksojnë faktin se *“Komisionet dhe komitetet, zakonisht partia në pushtet i zgjedh në bazë të preferencave të saj, shpesh ndodh që në ato grupe punuese dhe komisione komunale të ketë edhe përfaqësues nga shoqëria civile “organizata fantome” që janë inekzistente dhe joaktive”* (Uka, 2023).

Buxhetimi me pjesëmarrje

Komuna është e detyruar të organizojë takime konsultative të përkohshme për buxhetin, investimet dhe projektet e planifikuara në vendbanimet individuale dhe fshatra në këto territore, përveç takimeve obliguese gjashtë mujore (MAPL, UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MPL) NO. 04/2018 MBI TRANSPARENCËN E KOMUNAVE, NENI 11, PARAGRAFI 1, 2018). Ndonëse janë të parapara dy takime, komuna duhet të zgjerojë më tej mënyrat e konsultimit me publikun, duke përfshirë konsultimet elektronike nëpërmjet uebfaqes së saj zyrtare. Udhëzimi Administrativ (MPL) nr. 06/2018, që përcakton standardet minimale për konsultimet me publikun në komuna, drejton procesin e konsultimeve dhe vendos mënyrat dhe parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes publike në vendimmarrjen në nivel komunal.

Sipas këtij Udhëzimi, Komuna është e detyruar të kryejë konsultime me qytetarët rreth draftit të buxhetit për vitin e ardhshëm dhe kornizës mesatare buxhetore për tre vitet pasardhëse. Për të arritur këtë, autoritetet komunale kanë në dispozicion një varg opsionesh, si takimet konsultative, konsultimet e shkruara dhe elektronike, konferencat, intervistat, sondazhet, panelet, konsultimet me grupe të ndryshme të interesit, takimet me këshilla të fshatrave ose qytetarë (nëse nuk janë të organizuara), dhe aktivitete në terren.

Është e rëndësishme që të gjitha politikat dhe praktikat e konsultimit të përfshijnë parimin e barazisë gjinore, duke siguruar që zërat dhe nevojat e të gjithë qytetarëve të jenë të dëgjuar dhe të përfshira në procesin vendimmarrës komunal (UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MPL) NO. 06/2018).

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është procesi i integritit të perspektivës gjinore në të gjitha fazat e buxhetimit. Kjo përfshin planifikimin, përshtatjen, zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve me qëllim të promovimit të mundësive të barabarta për të gjithë, si burrat dhe gratë. Zyrtarët janë të detyruar të garantojnë që buxhetimi të jetë i ndjeshëm ndaj gjinisë dhe të respektojë parimet e barazisë gjinore (LIGJI NR. 05/L-020 PËR BARAZI GJINORE).

Komuna e Mitrovicës publikon rregullisht raportet mbi dëgjimet buxhetore të realizuara. Nga raporti i prezantuar për zhvillimin e procesit buxhetor komunal për vitin 2023 dhe parashikimet për 2024-2025 (Raport për dëgjimet buxhetore me qytetarë për planifikim të buxhetit 2023 - 2025, 2022). Në figurën e mëposhtme paraqitet numri i pjesëmarrësve për lokalitet.




Figura 32. Statistikat nga dëgjimet buxhetore për planbuxhetin 2023-25 komuna e Mitrovicës

Raporti i prezantuar për zhvillimin e procesit buxhetor komunal për vitin 2023 dhe parashikimet për 2024-2025 është një dokument i rëndësishëm që tregon angazhimin e komunës së Mitrovicës për të respektuar Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe për të inkorporuar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit në procesin e përgatitjes së buxhetit komunal.

Si rezultat i detyrimit nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit nr. 03/L-48, duke siguruar se kalendarin dhe procedurat e parapara me Qarkoren Buxhetore 2023/01 për Komunitet, komuna ka ndjekur në përpikëri këtë detyrim ligjor.

Një aspekt kyç i raportit është theksimi i përfshirjes së qytetarëve dhe grupimeve të ndryshme të interesit në procesin e përgatitjes së buxhetit komunal. Ky angazhim është thelbësor për një qeverisje të mirë dhe për të siguruar që interesat e qytetarëve janë të përfaqësuara në buxhet. Për të arritur këtë, komuna e Mitrovicës ka organizuar gjithsej tetë (8) dëgjime buxhetore, duke përfshirë pothuajse strukturat dhe grupet e qytetarëve. Po ashtu, organizimi i dëgjimeve në dy modalitete (takime në terren dhe takime në Sallën e Kuvendit Komunal) ka treguar një përpjekje të mirë organizuar për të siguruar që sa më shumë qytetarë të kenë mundësi të marrin pjesë dhe të japin kontributin e tyre në planifikimin e buxhetit.

Megjithatë, raporti identifikon disa sfida dhe vështirësi në këtë proces. Në veçanti, ekipi i caktuar për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore nuk ka pasur mbështetje të mjaftueshme nga bartësit përkras dhe përgjegjës të dëgjimeve buxhetore, ndërsa njoftimet nga Sekretaria e Kuvendit për përfaqësuesit e fshatrave, lagjeve dhe lokaliteteve nuk janë bërë në mënyrë të plotë, duke rezultuar në numër të ulët pjesëmarrësish në disa takime.

Për të arritur një përfshirje më të gjerë dhe të garantuar, është e rëndësishme që të gjithë drejtorët dhe zyrat përgjegjëse të jenë të angazhuar në këtë proces dhe të ndihmojnë në informimin dhe mobilizimin e qytetarëve për pjesëmarrje aktive në dëgjime. Dëgjetet buxhetore me qytetarë kanë sjellë një numër të madh kërkesash, të cilat do të duhet të trajtohen me kujdes për të përfshirë ato që kanë bazë dhe arsyeshmëri brenda mundësive financiare të komunës. Ky aspekt tregon se procesi i dëgjimeve ka qenë produktiv dhe ka nxitur pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në planifikimin e buxhetit komunal.

5.5. Përfundime

Nga hulumtimi për rastin e studimit IV theksohet fakti se në komunat e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderaj, zbatimi i Planit Komunal për Pjesëmarrje Qytetare nuk ka arritur të korrigjojë pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes dhe nuk ka nxitur një kulturë të përfshirjes aktive të qytetarëve. Është e nevojshme për komunat në fjalë të ulin këto pengesa dhe të

inkurajojnë qytetarët dhe shoqërinë civile të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme.

Megjithatë nuk mund të thuhet se ofrohet qasje e barabartë sepse përfaqësimi i shoqërisë civile në këto instanca nuk bëhet me ndonjë përzgjedhje që përfshin kritere të caktuara, ky përfaqësues në të shumtën e rasteve përzgjidhet nga ana e pushtetarëve, pa ndonjë garë apo konkurs. P.sh. *“Komuna e Skenderajt që nga viti 2017 përfshin përfaqësues të shoqërisë civile në komisione komunale dhe grupe punuese për dokumente të ndryshme”* (Zeqiri, 2023). Edhe në Mitrovicë kemi një konfirmim të këtillë *“Komisionet dhe grupet punuese, zakonisht partia në pushtet i zgjedh në bazë të preferencave të saj, shpesh ndodh që në ato grupe punuese dhe komisione komunale të ketë edhe përfaqësues nga shoqëria civile “organizata fantome” që janë inekzistente dhe joaktive”* (Uka, 2023).

Komunat ende mbesim jotransparente në përfshirjen e qytetarëve në planifikim, zbatim dhe monitorim të politikave lokale. Komunikimi shumë herë është i njëanshëm, dhe kërkesat e qytetarëve nuk janë të trajtuara mirëfilli. Akterë të shoqërisë civile dhe ekspertë të intervistuar megjithatë theksojnë se PPQ dhe mekanizmat e pjesëmarrjes kanë ngritur nivelin e transparencës në këto komuna, shembull konkret në të cilin ka ndikuar shoqëria civile e që vlen të ceket është ndryshimi në të mirë që ka bërë komuna e Skenderajt në indeksin e transparencës komunale, *“pasi gjatë monitorimit të vitit 2021 komuna e Skenderajt kishte dalë në vendin e 16-të në mesin e 38 komunave të Kosovës. Pas publikimit të rezultateve, dërgimit të rekomandimeve dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile për të mirën e përbashkët, në indeksin e vitit 2022 komuna e Skenderajt ka arritur të dalë në vendin e parë në po të njëjtin indeks të transparencës”* (Rushiti, 2023).

Komunat duhet të zgjerojnë më tej komunikimin dhe ndërgjegjësimin mes qytetarëve dhe strukturave zyrtare për të siguruar pjesëmarrje aktive të tyre në procesin e vendimmarrjes lokale. Për ta arritur këtë, komunat duhet të prezantojnë informacione të qarta dhe lehtë të kuptueshme në mënyrë që qytetarët të kenë njohuri të mjaftueshme për të marrë pjesë në konsultimet publike. Kjo mund të realizohet përmes ueb faqeve të komunave dhe media të ndryshme.

Është e rëndësishme që komunat të kenë parasysh interesat dhe shqetësimet e të gjitha grupimeve të ndryshme të qytetarëve dhe të respektojnë ndryshimet. Përmes kësaj përfshirje të barabartë, komunat mund të sigurojnë një proces vendimmarrje të përshtatshëm dhe të drejtë për të gjithë komunitetin.

Për garantuar një pjesëmarrje aktive, është e nevojshme një vullnet politik nga ana e autoriteteve lokale. Komunat duhet të krijojnë një mjedis të lehtë për ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe për forcimin e mjedisit juridik dhe institucional që inkurajon përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes në nivel komunal.

Komunat duhet të vazhdojnë investimin në teknologji dhe infrastrukturë të nevojshme për të sjellë platformën në internet dhe aplikacionet e avancuara për të vetëdijesuar dhe inkurajuar qytetarët për të marrë pjesë në procesin vendimmarrës në nivel lokal. Kjo do të lehtësonte aksesin dhe përfshirjen e qytetarëve, veçanërisht të rinjve dhe të grupeve të ndryshme të interesit (ekspertëve, shoqërisë civile dhe personave me aftësi të kufizuara).

KAPITULLI VI: TESTIMI I HIPOTEZAVE DHE PËRFUNDIMET

Në këtë kapitull, paraqiten gjetjet dhe rekomandimet që dalin nga analiza e të dhënave dhe intervistave të kryera në kuadër të këtij studimi, të cilat janë përfshirë më detajisht gjatë procesit të analizimit të rasteve të studimit. Ky studim ka analizuar rolin dhe ndikimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe ekspertëve të fushave, grupeve të marginalizuara dhe publikut të gjerë në procesin e vendimmarrjes publike dhe zhvillimin e demokracisë. Bazuar në intervistat me aktivistë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucioneve qeveritare, kanë dalë disa gjetje të rëndësishme:

- Pjesëmarrja e shoqërisë civile është e rëndësishme për transparencën dhe legjitimitetin e procesit vendimmarrës. Nëpërmjet intervistave, është vërtetuar se pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile ka ndihmuar në rritjen e transparencës së vendimmarrjes dhe ka shtuar legjitimitetin e politikave të ndërmarra nga institucionet qeveritare. Citime dhe shembuj konkretë kanë demonstruar se me përfshirjen e shoqërisë civile, vendimet janë më të qëndrueshme dhe më të pranueshme për publikun.
- Politikat publike të hartuara me përfshirjen e shoqërisë civile kanë arritur sukses. Në disa raste të konkrete, politikat publike të zhvilluara në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile kanë pasur rezultate të dukshme dhe kanë arritur qëllimet e tyre. Kjo sugjeron se angazhimi i shoqërisë civile është i dobishëm dhe ndihmon në krijimin e politikave të suksesshme.
- Bashkëpunimi me ekspertët e fushave të ndryshme ka një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave të suksesshme dhe të përshtatshme për popullsinë. Nga intervistat është evidentuar se kur institucionet qeveritare bashkëpunojnë me ekspertët e fushave të ndryshme, politikat e ndërtuara janë më mirë të informuara, të bazuar në ekspertizë, dhe më të pranueshme nga publiku. Kjo rrit aftësinë e politikave për të adresuar nevojat dhe sfidat e popullsisë.
- Bashkëpunimi i strukturuar me shoqërinë civile, ekspertët e fushave të ndryshme dhe grupet e marginalizuara ka rritur transparencën, legjitimitetin dhe

përgjegjshmërinë në procesin vendimmarrës. Intervistat kanë treguar se kur ky bashkëpunim është organizuar dhe i strukturuar mirë, rritet transparenca e procesit vendimmarrës, krijohet një klimë më e mirë e besimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm, dhe përmirësohet përgjegjshmëria e institucioneve publike ndaj vendimeve të marra.

Hipoteza I: Pjesëmarrja e publikut dhe e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes është e rëndësishme për avancimin e demokracisë në Republikën e Kosovës.

Një nga aspektet më thelbësorë të demokracisë është pjesëmarrja e qytetarëve në procesin vendimmarrës. Pjesëmarrja është një faktor kyç që i jep legjitimitet politikave publike dhe procesit të vendimmarrjes.

Të gjeturat nga studimi mbi rastin e pjesëmarrjes së publikut në proceset e konsultimit në nivel qendror (Rasti MINT) shfaq se pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqërisë civile nuk ka qenë sa duhet e gjerë dhe kjo ka kufizuar rritjen e transparencës dhe legjitimitetit të procesit vendimmarrës. Është evidentuar se ky fakt ka penguar procesin e avancimit të demokracisë në Kosovë, duke konfirmuar hipotezën e parë, paraqitur edhe në raporte ndërkombëtare matës të Demokracisë, si Transparency Indeks dhe Raporti vjetor i Demokracisë në V-Dem. Siç dhe vërtetohet tek figura e mëposhtme, Pjesëmarrja e grave, shoqërisë civile, janë në raport të drejtë me zhvillimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe deliberale, në linjë me hipotezën e ngritur. Pra, sa më e lartë pjesëmarrja, demokracia është më e zhvilluar.




Figura 33. Zhvillimi i demokracisë, pjesëmarrja e grave dhe shoqërisë civile në Kosovë, 2010 - 2023, sipas raportit vjetor V-Dem 2023

Kësaj i shtohet dhe fakti se komunikimi me qytetarët është shpesh i njëanshëm dhe kërkesat e tyre nuk janë trajtuar në mënyrë adekuate. Kjo mungesë e komunikimit dhe pjesëmarrjes aktive ka rezultuar në mungesë të besimit të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, duke dëmtuar aspektin e demokracisë në Kosovë. Në nivel lokal, sipas raportit të Indeksit komunal 2022 (KDI, 2022), qytetarët paraqitën 1025 kërkesa për qasje në dokumente publike në 34 komuna që siguruan informacionin për vitin 2022. Nga këto, 323 ishin të lidhura me prokurimin publik. Bazuar në informatat e dhëna nga komunat, nga 745 kërkesa, vetëm 18 ishin refuzuar në bazë të dispozitave juridike për mbrojtjen e të dhënave/konfidencialitetin e informacionit. Ndër vite, nuk vërehet ndonjë ngritje e interesimit për qasje në dokumente publike, paraqitur në figurën e mëposhtme.



Figura 34. Kërkesat për qasje në dokumente, sipas KDI 2022

Për më tepër, përvoja ka treguar se investimi në teknologji dhe infrastrukturë mund të luajë një rol të rëndësishëm në nxitjen e pjesëmarrjes. Kjo do të lehtësonte aksesin dhe përfshirjen e qytetarëve, veçanërisht të rinjve dhe grupeve të ndryshme të interesit.

Për të matur transparencën e ofrimit të informatave për qytetarët që kanë të bëjnë me angazhimin civil dhe informimin, organizata të ndryshme masin nivelin e pjesëmarrjes. Nga totali i 100%, sipas matjes nga KDI, niveli mesatar i transparencës në pjesëmarrjen e publikut është 53% për vitin 2022, paraqitur më poshtë.




Figura 35. Pjesëmarrja e publikut në komuna, KDI 2022

Hipoteza II: Bashkëpunimi i strukturuar me shoqërisë civile, ekspertët e fushave të ndryshme dhe grupet e marginalizuara në procesin e vendimmarrjes dhe implementimit të politikave publike ndikon në avancimin e demokracisë në Republikën e Kosovës.

Në lidhje me hipotezën e dytë, rezultatet nga hulumtimi rreth Planit Komunal për Pjesëmarrje Qytetare tregojnë se bashkëpunimi i strukturuar me shoqërisë civile dhe ekspertët e fushave të ndryshme mund të ketë një ndikim pozitiv në rritjen e transparencës, legjitimitetit dhe përgjegjshmërisë në procesin vendimmarrës, paraqitur në Fig. 37. (sipas renditjes së komunave, vlera më e vogël d.m.th. pozicionim më i lartë).

Komunat që kanë punuar në lidhje me këtë qasje kanë pasur sukses në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe në stimulimin e pjesëmarrjes qytetare. Pra, bashkëpunimi i strukturuar me ekspertët dhe shoqërisë civile ka ndikuar pozitivisht në avancimin e demokracisë, duke konfirmuar hipotezën e dytë.

Ky bashkëpunim i strukturuar dhe i koordinuar ka ndihmuar në krijimin e një procesi vendimmarrës më të përshtatshëm dhe të drejtë për të gjithë komunitetin. Në këtë kontekst, komunat kanë pasur mundësi të trajtojnë shqetësimet dhe interesat e grupimeve të ndryshme të qytetarëve, duke rritur në këtë mënyrë legjitimitetin e procesit vendimmarrës.




Figura 36. Transparemotri komunal sipas KDI, modifikuar nga autorja (2019 - 2022)

Për të arritur këtë, komunat kanë investuar në teknologji dhe infrastrukturë, duke sjellë platformën në internet dhe aplikacione të avancuara për të nxitur dhe vetëdijesuar qytetarët për të marrë pjesë në procesin vendimmarrës në nivel lokal. Kjo ka lehtësuar qasjen dhe përfshirjen e qytetarëve, veçanërisht të rinjve dhe grupeve të ndryshme të interesit.

Gjithashtu, edhe në nivelin qendror hapja ndaj publikut ngrit transparencën dhe rrjedhimisht ndikon në demokratizim të vendit, në nivel ministrie, organizatat joqeveritare masin transparencën duke u bazuar në treguesit e publikimit të informatave për qytetarët, përmes faqeve zyrtare, kjo matje rezulton se shumica e ministrive në Kosovë janë jotransparente. Madje edhe analiza e mësipërme tek rasti i studimit të tretë, mbështet faktin se Ministrinë edhe gjatë procesit të konsultimit nuk janë shpesh të hapura në publikimin e raporteve përfundimtare të konsultimit, si rrjedhojë, transparenca e paraqitur në Figurën 38 mbështet këtë të gjetur.




Figura 37. Përmbushja e përgjithshme e treguesve nga ministrinë, D+ 2022

Përfundimisht, të dy hipotezat kanë gjetur mbështetje nga të gjeturat e studimit. Hapja e institucioneve, transparenca dhe niveli i konsultimit me publikun, rrjedhimisht avancimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe bashkëpunimi i strukturuar me ekspertët dhe grupet e ndryshme të interesit janë aspekte kyçe të avancimit të demokracisë në Republikën e Kosovës. Prandaj, është thelbësore që autoritetet të angazhohen më shumë në nxitjen e këtyre aspekteve për të arritur një avancim të qëndrueshëm të demokracisë në vend.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij studimi kanë si synim të ndihmojnë në përmirësimin e procesit të vendimmarrjes publike dhe në forcimin e demokracisë, duke përfshirë mekanizmat e pjesëmarrjes së ekspertëve dhe shoqërisë civile, përfshirë grupet e marginalizuara. Përmes pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm dhe një bashkëpunimi të hapur dhe të strukturuar, është e mundur të krijojmë politika më të përshtatshme, t'i shërbejmë interesave të popullsisë dhe të forcojmë demokracinë në vend.

6.1. Përfundim dhe rekomandime

Në këtë seksion, shqyrtohen gjetjet kryesore që dalin nga analiza e të dhënave dhe intervistave në kuadër të studimit dhe testimi i hipotezave. Gjetjet tregojnë se pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe bashkëpunimi i strukturuar me publikun në fusha të ndryshme kanë një ndikim pozitiv në procesin e vendimmarrjes publike dhe në avancimin e demokracisë në Republikën e Kosovës.

Sipas rezultateve të tezës së disertacionit, Republika e Kosovës, bazuar në Shkallët e Sh. Arnstein të pjesëmarrjes qytetare, ndodhet në nivelin e “Krijimit të imazhit të pjesëmarrjes qytetare”, duke përdorur (i) informimin, (ii) konsultimin dhe (iii) pjesëmarrjen simbolike.

Që Kosova të arrijë bashkëvendimmarrjen, bashkëqeverisjen dhe kontrollin qytetar të politikës publike, është e nevojshme ndër të tjera të avancohet dhe të përmirësojë mekanizmat e pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit me qytetarët, për të përforcuar demokracinë dhe adresuar nevojat e komunitetit në mënyrë më efektive, konkretisht:

- I. Përfitimi i ekspertizës së fushës nga organizatat e shoqërisë civile dhe akademike në proceset e konsultimit publik dhe ndërtimi i një kulture të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nëpërmjet mekanizmave të konsultimit publik.
- II. Përgjithësimi i aktiviteteve informuese rreth proceseve të politikës publike dhe konsultimeve dhe përdorimi i metodave të ndryshme për të mbledhur informata dhe për të përcjellë të dhënat e konsultimit publik në mënyrë transparente dhe të kuptueshme për qytetarët.
- III. Adresimi i mospërfshirjes dhe pakënaqësive të grupeve të shoqërisë civile dhe grupeve të marginalizuara (komunitetet pakicë, personat me aftësi të kufizuara, gratë) në proceset e vendimmarrjes, duke qenë pro aktive në marrjen e këshillave dhe mendimeve të tyre dhe duke u dhënë atyre role aktive në proceset e politikës publike.
- IV. Përmirësimi i procesit të konsultimit publik dhe përdorimi i metodave më të mira, duke vendosur kritere për përzgjedhjen e metodave të konsultimit dhe për të siguruar

pjesëmarrje të barabartë për të gjithë qytetarët, duke përfshirë dhe komunitetet e pakicave.

Përveç sfidave dhe mangësive në procesin e politikës publike në Kosovë, është vërejtur se ka disa raste të mira të praktikave që lidhen me mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikën lokale, dhe këto duhet të inkurajohen dhe të ndiqen nga organet shtetërore në mënyrë më të gjerë. Me përmirësimin e cilësisë së vendimeve dhe zvogëlimin e kostove dhe vonesave, pjesëmarrja e strukturuar në politikë publike mund të ndikojë në zhvillimin e demokracisë në Kosovë.

- I. Pjesëmarrja e ekspertëve dhe grupeve të interesit në planifikim mund të ndihmojë për të siguruar që qeveria të marrë parasysh interesat e të gjitha palëve dhe të nxjerrë vendime më të përgjegjshme dhe të mirinformuara.
